



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

**Statusi i Shërbimit Universal të
Komunikimeve Elektronike
2017**

Dokumenti Përfundimtar

Miratuar me VKD Nr.12, datë 19.04.2017

INDEKSI I PERMBAJTJES

| | | |
|-----------------|--|-----------|
| I. | Hyrje..... | 4 |
| II. | Zhvillimet kryesore ne Shqiperi per SHU pas vitit 2013..... | 6 |
| III. | Zhvillimet e kuadrit rregullator të BE për SHU | 7 |
| III.1 | Propozimi i KE per rishikimin e kuadrit rregullator | 7 |
| III.2 | Implementimi i SHU ne vendet e BEREC | 9 |
| IV. | Aksesi ne sherbimet e telefonise dhe aksesi broadband ne Internet . | 11 |
| IV.1 | Sherbimet nga rrjete fikse..... | 11 |
| IV.1.1 | Telefonia Fikse..... | 11 |
| IV.1.2 | Aksesi ne Internet me brez te gjere..... | 13 |
| IV.2 | Sherbimet nga rrjetet celulare..... | 19 |
| IV.2.1 | Telefonia celulare..... | 19 |
| IV.2.2 | Aksesi broadband ne rrjete celulare 3G/4G: | 22 |
| IV.3 | Tarifat e telefonise dhe aksesit broadband..... | 26 |
| IV.3.1 | Tarifat e telefonise fikse..... | 26 |
| IV.3.2 | Tarifat e aksesit broadband nga rrjete fikse | 29 |
| IV.3.3 | Tarifat e telefonise celulare..... | 31 |
| IV.3.4 | Tarifat e aksesit broadband nga rrjetet celulare | 33 |
| IV.3.5 | Perballueshmeria e tarifave..... | 35 |
| V. | Rishikimi i objektit te SHU..... | 39 |
| Aneks 1: | Komentet e keshillimit publik dhe qendrimi i AKEP | 44 |

INDEKSI I TABELAVE DHE FIGURAVE

| | |
|---|----|
| TABELA III.1: MASA PER PROMOVIMKIN E BROADBAND JAShte FUSHES SE SHERBIMIT UNIVERSAL..... | 10 |
| FIGURA IV.1 ECURIA E NUMRIT TË PAJTIMTARËVE TË TELEFONISE FIKSE 2000-2015 | 12 |
| FIGURA IV.2 NORMA E PENETRIMIT TE TELEFONISE FIKSE SIPAS QARQEVE DHE ZONAVE URABNE/RURALE (2016) | 12 |
| FIGURA IV.3 NORMA E PENETRIMIT TE TELEFONISE FIKSE NE SHQIPERI DHE VENDE TE TJERA | 13 |
| TABELA IV.1 ECURIA E NUMRIT TË PAJTIMTARËVE TË AKESIT BROADBAND NGA RRJETE FIKSE 2010-2016 | 14 |
| FIGURA IV.4. ECURIA E PAJTIMTAREVE TE TELEFONISE DHE TE AKSESIT BROADBAND NGA RRJETE FIKSE 2010-2016..... | 14 |
| FIGURA IV.5. PENETRIMI I AKSESIT BROADBAND NGA RRJETE FIKSE SIPAS POPULLSISES DHE FAMILJEVE (2011-2016) | 15 |
| FIGURA IV.6. PENETRIMI I AKSESIT BROADBAND NGA RRJETE FIKSE SIPAS QARQEVE (2016) | 15 |
| TABELA IV.2: NUMRI I PAJTIMTARËVE QË KANË AKSES NË SHËRBIME TË INTEGRUARA | 16 |
| TABELA IV.3: NUMRI I PAJTIMTARËVE TË ALBTELECOM ME SHËRBIME TË INTEGRUARA | 17 |
| FIGURA IV.7: LIDHJET BROADBAND FIKS SIPAS TEKNOLOGJISE SHQIPERI V BE 2015/2016..... | 17 |
| FIGURA IV.8: SHPERNDARJA E PAJTIMTAREVE ME AKSES BROADBAND FIKS SIPAS SHPEJTESISE 2014-2015 .. | 18 |
| TABELA IV.4: TREGUES KRYESORË TË VOLUMIT TË SHËRBIMEVE CELULARE 2013-2015 | 19 |
| FIGURA IV.9. ECURIA E NUMRIT TË PËRDORUESVE CELULARE SIPAS TREMUJOREVE T4 2014 - T4 2016 | 20 |
| FIGURE IV.10 ECURIA E STRUKTURËS SË TRAFIKUT DALËS CELULAR (2003-2015) | 21 |
| TABELA IV.5: NUMRI I PAJTIMTARËVE ME AKSES BROADBAND 3G/4G | 22 |
| FIGURA IV.11 NUMRI I PËRDORUESVE AKTIVE TË AKSESIT BROADBAND NGA RRJETE CELULARE | 23 |
| TABELA IV.6: PËRDORIMI MESATAR MUJOR I SHËRBIMEVE CELULARE 2010-2015 | 24 |
| TABELA IV.7: TREGUES TE MBULIMIT ME RRJET CELULARE 2016 (%) | 25 |
| TABELA IV.8: KRAHASIMI I TARIFAVE TE PAKETES STANDARDE TE ALBTELECOM ME VENDET E SEE (2013/14) | 27 |
| FIGURA IV.12: ECURIA E TARIFËS SË PAJTIMIT MUJOR FAMILJARE: SHQIPËRI DHE SEE 2006-2013/4 | 28 |
| TABELA IV.9: KRAHASIMI I TARIFAVE TE PAKETES STANDARDE TE ALBTELECOM ME VENDET E SEE (2015) .. | 28 |
| TABELA IV.10: TARIFA TE AKSESIT BROADBAND (STAND ALONE) PER SHPEJTESI 1-4MBPS | 30 |
| FIGURA IV.13: KRAHASIMI I TARIFAVE MUJORE TE AKSESIT BROADBAND (TELEFONI DHE INTERNET) | 30 |
| FIGURA IV.14: KRAHASIMI I TARIFAVE MUJORE TE AKSESIT BROADBAND (TELEFONI, INTERNET DHE TV).. | 30 |
| TABELA IV.11 ECURIA E ARPM DHE ARPU 2010-2014 | 32 |
| FIGURE IV.15 ARPM NË VENDET E BE DHE SHQIPËRI (2011/2014)..... | 32 |
| FIGURE IV.16: ARPU NË VENDET E BE DHE SHQIPËRI (2013/2014) | 33 |
| TABELA IV.12 SHEMBUJ TE PAKETA STANDARTE DITORE (TELEFONI+INTERNET)..... | 34 |
| TABELA IV.13. SHEMBUJ TE PAKETAVE STANDARTE 28/30 DITORE (TELEFONI+INTERNET) | 34 |
| TABELA IV.14. SHEMBUJ TE PAKETAVE AKSES NE INTERNET ME PARAPAGIM NGA APARATE CELULARE | 34 |
| TABELA IV.15. RENDITJA E SHQIPËRISË PËR INDEKsin E CMIMEVE TË ICT NE RAPORTET ITU 2015-2016 .. | 36 |

I. Hyrje

AKEP gjatë viteve 2012-2013, në bashkëpunim me Banken Botërore dhe konsulencën nderkombetare të zgjedhur prej saj, zhvilloi një sërë takimesh me operatorët kryesorë në lidhje me Implementimin e Shërbimit Universal (SHU) në Shqipëri dhe në Nëntor 2012 zhvilloi një konsultim publik për SHU. Konkluzionet paraprake të dokumentit të konsultimit u publikuan në faqen e internetit të AKEP-it, dhe i'u prezantuan operatorëve në një seminar në Dhjetor 2012. Pas perfundimit të keshillimit publik, dhe përgatitjes së raportit final nga konsulenti nderkombetar i BB, AKEP më 28.06.2013 me Vendimin nr.2324, miratoi dokumentin 'Statusi Aktual dhe Plani Kuadër 2013-2016 i Shërbimit Universal'. Ky dokument përmbante konkluzionet kryesore të mëposhtme:

- Aksesit në shërbimin publik telefonik nga vendndodhje fikse përfshin gjithashtu shërbimet e telefonisë fikse të ofruara nga GSM fikse; tregu plotëson në masë të konsiderueshme nevojat e përdoruesve për këtë element të detyrimit të SHU (kryesisht për shkak të mbulimit të lartë prej 99.8% të popullsisë më sinjal celular) dhe prandaj detyrimi që aksesit dhe shërbimi nga vendndodhje fikse "të jetë i disponueshëm për të gjithë përdoruesit kudo në territorin e vendit, me një çmim të përballueshëm" është i realizuar dhe nuk ka nevojë për të përcaktuar një ofrues të SHU për këtë element. AKEP do të koordinojë, inkurajojë, kërkojë një ose disa operatorëve të ofrojnë akses në vendndodhje specifike gjeografike që nuk kanë mbulim me shërbim telefonik, por jashtë skemës së SHU. AKEP do të rishikojë statusin e këtij elementi në vitin 2016.
- Aksesit broadband nuk duhet të jetë pjesë e SHU akoma, për shkak të penetrimit të ulët dhe mosplotësimit të rregullit 50/80 të rekomandimit të KE.
- Në Shqipëri nuk ka numëror telefonik apo shërbim të kërkitimit të informacionit në numëror. AKEP do të ndërmarrë masa rregullatore për të lehtësuar dhe për të promovuar një zgjidhje të tregut për këto elementë të SHU në periudhë afat-shkurtër deri afat-mesme, dhe do të rishikojë statusin e këtij elementi në vitin 2016.
- Telefonat publikë me pagesë: ky element i SHU nuk duhet të përcaktohet pasi një përcaktim i tillë nuk do të ishte proporcional për shkak të rënies së përdorimit dhe rëndësisë së tyre. Nëse është e përshtatshme, AKEP do të koordinojë, inkurajojë një ose më shumë operatorë që të ofrojnë telefona publikë me pagesë në vende të veçanta, por jashtë çdo skeme të detyrimeve të SHU. AKEP do të rishikojë statusin e këtij elementi të detyrimeve të SHU në vitin 2016.
- Përdoruesit me aftësi të kufizuara: Qeveria Shqiptare ofron subvencion mujor prej 1000 lekë për përdorues me aftësi të kufizuara dhe nga tregu ofrohen disa masa për këta përdorues. Subvencioni mujor i QSH në kombinim me iniciativat e sektorit privat aktualisht plotësojnë në masë të ndjeshme nevojat e përdoruesve për këtë element të SHU. AKEP do të rishikojë statusin e këtij elementi të detyrimeve të SHU në vitin 2016.
- Periudha e përcaktimit për ofrues të SHU duhet të jetë 5 vjet.

Ne lidhje me planin kuadër të AKEP për SHU për periudhën 2013-2016 përcaktimet kryesore ishin:

Periudhë afatshurtër (0-12 muaj)

1. AKEP të mos përcaktojë ndonjë element të detyrimeve të SHU ose ofrues të SHU, si dhe masa të tjera të lidhura me përcaktimin e Ofruesit/Ofruesve të SHU si kërkesa për kompensim, mekanizmi i financimit sektorial nëpërmjet mbledhjes së kontributeveve operatorit (FSHU).
2. AKEP të punojë për hartimin dhe përgatiten për konsultim publik të masave rregullatore për të promovuar zgjidhjet nga ana e tregut për numeratorin telefonik dhe shërbimet e kërkimit të informacionit për numrat, duke përfshirë krijimin e bazës së të dhënave të secilit operator për pajimtarët e vet dhe për akses dhe shkëmbim të këtij informacioni me palë të treta.
3. AKEP të koordinojë/inkurajojë një ose disa operatore të ofrojnë akses në vendndodhje specifike gjeografike ku nuk ka mbulim me sinjal telefonik, jashtë skemes së SHU
4. Të punohet për hartimin dhe përgatiten për konsultim publik të rregulloreve dhe akteve të tjera nën-ligjore për SHU, të cituara në Ligjin 9918. Këto rregullore/akte të SHU do të plotësojnë dispozitat përkatëse të Ligjit 9918, të amenduar, në mënyrë për të siguruar më shumë detaje dhe specifikime, duke përfshirë në lidhje me kriteret, procedurat dhe metodologjinë, çështjet administrative në rast të përcaktimit të ofruesve të SHU në të ardhmen.

Periudhë afat-mesme (13-24 muaj)

5. Të kryhet një analizë më e detajuar e masave për akses ekuivalent për përdoruesit me aftësi të kufizuara.

Periudhë afatgjatë (25-36 muaj)

6. Të kryhet rishikimi i statusit të detyrimeve dhe përcaktimeve të gjithë elementëve të SHU në vitin 2016.

Qëllimi i këtij Dokumenti është të kryejë procesin e rishikimit të statusit të SHU, duke evidentuar zhvillimet kryesore në këto vite në tregun e komunikimeve elektronike që kanë lidhje me SHU, si dhe të trajtojë një sërë çështjesh të lidhura me zhvillimin e regjimit të shërbimit universal në Shqipëri. Ky dokument është përgatitur pas procesit të këshillimit publik të kryer në Tetor-Nëntor 2016¹, si dhe takimeve të kryera nga AKEP me palët kryesore të interesuara në fillim të vitit 2017. Dokumenti i këshillimit publik u miratua me Vendimin e KD të AKEP me nr.2691, datë 13.10.2016, dhe u publikua në faqen web të AKEP për këshillim publik më 13.10-30.11.2016. Komentet kryesore dhe qëndrimi i AKEP janë paraqitur në Aneks 1 të këtij dokumenti.

¹ Dokumenti i këshillimit publik u miratua me Vendimin e KD të AKEP me nr.2691, datë 13.10.2016, dhe u publikua në faqen eeb të AKEP për këshillim publik më 13.10-30.11.2016.

II. Zhvillimet kryesore ne Shqiperi per SHU pas vitit 2013

AKEP pas miratimit te planit kuader ne vitin 2013 ka fokusuar punen e tij ne dy drejtime:

- Bashkepunimin me operatorët celularë për nxitjen e investimeve dhe mbulimit të zonave ku nuk ka sinjal telefonik, si dhe përmirësimin e tij në zonat që kanë probleme me sinjalin telefonik. Bazuar në zhvillimet teknologjike dhe investimet në rrjetet 3G/4G, rritja e mbulimit dhe përmirësimi i sinjalit të rrjeteve celularë në zonat problemetika ka përfshirë edhe sinjalin/mbulimin me rrjet 3G.
- Marrjen e masave për përgatitjen e kuadrit rregullator për shërbimet e numeratorit telefonik;

AKEP gjatë vitit 2015 realizoi një proces konsultimi me tre operatorët më të mëdhenj celularë për mbulimin me sinjal rrjeti GSM/UMTS të disa zonave të largëta si dhe për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar me rrjet UMTS në disa zona me densitet të ulët të popullsisë. Secili operator ra dakort për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në zonat e evidentuara individuale dhe të tre operatorët nënshkruan një marrëveshje kuadër bashkëpunimi më datë 5.11.2015 me tabelat përkatëse për investime të përbashkëta në 6 zona të largëta të territorit të Shqipërisë gjatë vitit 2016. Angazhimet individuale të tre operatorëve celularë dhe plani i investimeve të përbashkëta për zonat me densitet të ulët populsi u miratuan nga AKEP me Vendimet nr. 2646, 2547 dhe 2548, date 03.12.2015.

Operatorët celularë kanë përbushur detyrimet e mbulimit (territor dhe popullsi) dhe cilësisë së shërbimit sipas autorizimeve individuale, ndërkohë që këto masa (angazhimet e operatorëve dhe vendimet e AKEP) përveç rritjes së cilësisë së shërbimeve me akses broadband synojnë rritjen e mbulimit me sinjal telefonik dhe shërbime broadband duke kontribuar në këtë mënyrë në shërbimin universal në territorin e R.SH. Koordinimi/inkurajimi nga AKEP i një ose disa operatorëve që të ofrojnë akses në vendndodhje specifike gjeografike ku nuk ka mbulim me sinjal telefonik, jashtë skemës së SHU, është një prej veprimeve të parashikuara nga AKEP në Planin Kuadër 2013-2016 për Shërbimin Universal në fushën e komunikimeve elektronike.

Me 14 Korrik 2016, tre operatorët Altelecom, Vodafone Albania dhe Telekom Albania kanë nisur bashkëpunimin për ndërtimin e rrjetit të fibrës optike dhe mbulimit me sinjal telefonik GSM si dhe shërbime 3G të zonës së Kelmendit në Malsinë e Madhe. Specifikisht në këtë zonë, Altelecom do të kryejë lidhjen me fibra optike, përmes të cilave do të japin shërbim të tre operatorët celularë.

Inkurajimi dhe koordinimi nga AKEP dhe angazhimet e operatoreve celularë përfshijnë jo vetëm 6 zonat ku nuk ka sinjal por edhe përmirësimin e sinjalit të rrjetit GSM dhe 3G në një sërë zonash të tjera, individuale për secilin operator, ku sinjali nuk është në nivel të kënaqshëm.

Ne lidhje me Numeratorin Telefonik, AKEP zhvilloi keshillim me operatorët kryesore në vitin 2014 për një draft-rregullore të përgatitur, por diskutimi pati kundërshtime të mëdha nga disa operatorë. Aktualisht në shumë qytete ofrohen në mënyrë komerciale libra me numra telefoni për bizneset/profesionet e lira etj. AKEP po vazhdon punën për përgatitjen e ketyre rregullave që përfshijnë formularin për plotësim, formatin e të dhënave dhe marrdheniet midis paleve për aksesin në databazat përkatëse dhe nxjerrjen për keshillim publik të tyre së shpejti.

III. Zhvillimet e kuadrit rregullator të BE për SHU

Dokumenti i AKEP per Shërbimin Universal, i nxjerre ne keshillim publik më 29.10.2012, përmbante një kapitull të vecantë për kuadrin rregullator te BE per SHU, duke analizuar ndryshimet deri ne vitin 2012, të cilat përfshinin edhe komunikimin e KE për SHU në vitin 2011². Në këtë dokument KE vendosi ndër të tjera që fusha e SHU të mos zgjerohet për të përfshirë aksesin broadband në nivel komunitar, por duke lënë të hapur që vendet anëtare në mënyrë individuale sipas kushteve locale mund ta bënin këtë gjë. Në lidhje me aksesin funksional në Internet me shpejtësi me brez të gjerë (broadband), KE rekomandoi zbatimin e rregullit 50/80.

KE më datë 14.09.2016, publikoi propozimet për rishikimin e kuadrit aktual rregullator të komunikimeve elektronike.³ Ndër elementët kryesorë të propozimeve të KE, janë:

- Përcaktimin e objektivave jo-detyruese për Shoqërinë Gigabit (Gigabit Society) për vitin 2025 (të gjitha familjet të kenë akses broadband me shpejtësi 100 Mbps, që mund të rritet në shpejtësi me Gigabps;
- Plan veprimi për mbulimin me rrjete celulare 5G;
- Ndërmarja e masave për stimulimin e instalimit të rrjeteve me fibra optike;
- Përcaktimin e afatit minimal prej 25 vitesh për autorizimet e reja individuale për përdorimin e radiofrekuencave;
- Përfshirjen në fushën e SHU të aksesit bazik broadband me cmime të përballueshme;
- Vendosje të taveve për tarifatat e terminimit në rrjetet fikse dhe celulare;
- Zgjerimi i rolit dhe reformimi i BEREC.

BEREC në dokumentin “*BoR (17) 41 Draft BEREC update survey on the implementation and application of the universal service provisions – a synthesis of the results*”-24.02.2017, ka paraqitur një përmbledhje të rezultateve të sondazhit në lidhje me zbatimin dhe aplikimin e dispozitave të shërbimit universal në 29 vende të BEREC.

Në seksionet e mëposhtme AKEP ka dhënë propozimet kryesore më të detajuara të KE në lidhje me SHU si dhe gjetjet kryesore të dokumentit të BEREC për SHU.

III.1 Propozimi i KE për rishikimin e kuadrit rregullator

Në lidhje me SHU, propozimet më të detajuara të KE përfshijnë ndër të tjera:

- **Fusha e SHU**

Dy elementët e detyrueshëm të SHU që duhet të jenë të disponueshme për të gjithë përdoruesit fundorë, me cmime të përballueshme nga vendndodhje fikse janë:

² Komunikimi i Komisionit COM(2011) 795 i 23 Nëntor, 2011 “Shërbimi universal service komunikimet elektronike: raport mbi rezultatet e konsultimit publik dhe rishikimi i tretë periodik i fushës në përputhje me Nenin 15 të Direktivës 2002/22/EC”

³ Propozimet e KE për rishikimin e kuadrit rregullator do të jenë objekt i këshillimit me palët e interesuara dhe parashikohet që të miratohen nga Parlamenti dhe Këshilli European fundi i vitit 2017.

- **Shërbimet e komunikimit zanor**, d.m.th. shërbime që i ofrohen publikut për të kryer dhe marrë thirrje telefonike nëpërmjet një numri të planit të numeracionit, bazuar në teknologjitë e komutimit në qarqe ose me paketa (circuit sëitching ose packet sëitching) propozohet të vijonë të jenë pjesë e SHU.
- **Akses funksional në Internet**, i përkufizuar si aftësia e të gjithë përdoruesve fundorë për të patur akses në shërbimet bazë (themelore) online që përdoren nga shumica e individëve (p.sh. navigim në faqet web, akses në shërbimet e-Government etj), të dhëna në Aneks V të Direktivës:
 - (1) E-mail
 - (2) search engines enabling search and finding of all type of information
 - (3) basic training and education online tools
 - (4) online newspapers/news
 - (5) buying/ordering goods or services online
 - (6) job searching and job searching tools
 - (7) professional networking
 - (8) internet banking
 - (9) eGovernment service use
 - (10) social media and instant messaging
 - (11) calls and video calls (standard quality)
- **Detyrimet për numeratorët, shërbimet DES dhe telefonat publikë** propozohet të hiqen nga fusha e SHU si detyrime, pasi konsiderohen elementë të vjetëruar, megjithëse vendet që i kanë mund të vazhdojnë ti mbajnë këto detyrime.

- **Kufizime për teknologjinë/llojet e rrjeteve**

Propozimi i fundit i KE **nuk parashikon kufizime** se si shërbrimet (telefoni dhe akses broadband) mund të ofrohen tek përdoruesit fundor nga vendndodhje fikse, ato mund jene me rrjete me tela (ëired) ose pa tela (ëireless).

- **Sigurimi i disponueshmërisë së SHU për zona ku nuk ka shërbim/mbulim**

Vendet anëtare do të kenë të drejtë të përcaktojnë një ose disa operatorë si ofrues të SHU për të garantuar disponueshmërine e SHU, kur ajo nuk mund të sigurohet nëpërmjet praktikës normale tregtare ose nëpërmjet instrumentave të tjerë të politikave publike si fonde të ndihëms shtetërore ose fonde të BE. Komisioni shpjegon se fokusi duhet të jetë më shumë në përballueshmërinë e konkivitetit actual se san ë ndërtimin e rrjeteve të reja. Për të stimuluar investimet në rrjete duhet të përdoren instrumnta të tjerë.

- **Përballueshmëria e cmimeve të SHU**

Bazuar në analizën e tarifave me pakicë (retail) vendet anëtare mund të vendosin që operatorët të ofrojnë plane tarifore në nivel kombëtar, të ndryshme nga ato të ofruara nga praktika normale komerciale, me qëllim plotësimin e nevojave të përdoruesve me të ardhura të ulëta ose përdoruesit me nevoja specifike (të moshuarit, përdoruesit me aftësi të kufizuara, përdoruesit që jetojnë në zona të largëta). Vendet anëtare gjithashtu mund të vendosin të zgjedhin alternativën e suportit direkt të konsumatorit (p.sh. ofrimi i kuponave).

- **Refuzimi nga operatorët i ofrimit të SHU për përdorues të vecantë**

Operatorët nuk kanë të drejtë të refuzojnë ofrimin e SHU për përdoruesit fundorë, të cilët kanë të drejtë të lidhin kontratë me cilindo operator që ofron akses funksional në Internet dhe

komunikim zanor sipas përcaktimeve të SHU. Megjithatë operatorët do të kenë të drejtë të ofrojnë këto shërbime me sistemin me parapagim, me kushtin që njësitë me parapagim të jenë të përballueshme.

- **Financimi dhe fondi i SHU**

Propozimi i KE sjell ndryshim të madh në metodën e financimit të SHU. Sipas propozimit SHU duhet të financohet vetëm nëpërmjet fondeve të buxhetit të shtetit, dhe jo më nëpërmjet fondit të SHU që krijohet vetëm nga kontributet e operatorëve/sectorit të komunikimeve elektronike.

III.2 Implementimi i SHU ne vendet e BEREC

Dokumenti i BEREC, BoR (17) 41 “*BEREC update survey on the implementation and application of the universal service provisions – a synthesis of the results*” perben nje perditësim te raportit te brendshem te BEREC te vitit 2014 dhe permban një përmbledhje/sinteze te rezultateve te sondazhit ne lidhje me zbatimin dhe aplikimin e dispozitave të shërbimit universal ne 29 vende te BEREC. Dokumenti permban informacion ne lidhje me caktimin e ofruesve te SHU, vleresimin e kostove neto, mekanizmat e kompensimit, barres se padrejte financiare te OSHU, impaktin ne konkurrence dhe masat per perballueshmerine e tarifave.

Ne lidhje me caktimin e ofruesit te SHU, ne cdo vend eshte caktuar te pakten nje ofrues, pervec 6 vendeve (nga 29). Mos-caktimi i OSHU nuk nenkupton domosdoshmerisht se sherbimi universal nuk ofrohet, por qe SHU mund te sigurohet ne menyre komerciale nga tregu. Mekanizmat e caktimit te SHU kane ndryshim te madh midis vendeve.

Ne lidhje me aksesin broadband vetem **7 vende** kane deklaruar se kane perfshire ate si pjese te SHU (Spanja, Finlanda, Kroacia, Letonia, Suedia, Malta dhe Cekia):

- Letoni: aksesit broadband si pjese e SHU eshte vetem per perdoruesit me aftesi te kufizuar.
- Kroaci: OSHU ka detyrimin te ofroje akses broadband me shpejtesi minimale 1 Mbps nga 1 Janari 2015, dhe aktualisht jane 12000 perdorues te ketij sherbimi (pjese e SHU).
- Spanje dhe Suedi: shpejtesia minimale per SHU eshte 1 Mbps. Ne Ceki dhe Finlande eshte 2 Mbps, ndersa ne Malte 4 Mbps
- Austria nuk ka percaktuar shpejtesi minimale.
- UK eshte duke vleresuar perfshjen e aksesit broadband ne SHU, por nuk ka vendosur ende ne lidhje me specifikimet teknike.

Nderkohe ne lidhje me **masat e ndermarra per promovimin e aksesit broadband jashte fushes se SHU**, shumica e vendeve referojne se kane parashikuar ne Strategjite Broadband masa per zhvillimin e infrastruktures broadband dhe kryesisht me ndihme shteterore dhe/ose fonde te BE ndersa disa vende kane parashikuar per bashkefinansim per akses/rjete broadband ne zona te caktuara. Disa vende perfshijne detyrime mbulimi me broadband celular ne licencat/autorizimet e spektrit te frekuencave te MNO-ve. Tabela e meposhteme paraqet nje pershkrim te ketyre masave per promovimin e aksesit broadband ne vendet e BEREC.

TABELA III.1: MASA PER PROMOVIMKIN E BROADBAND JASHTE FUSHES SE SHERBIMIT UNIVERSAL

| EU MS | |
|-----------|--|
| AT | Austrian Broadband Strategy 2020, with government funding. |
| CZ | National Plans, consistent with the Digital Agenda for Europe, to promote broadband access. |
| DK | The Danish “Broadband Fund” is funded by the Government. End-Users with poor access to a broadband connection may apply for a better connection under this measure. |
| EL | State aid projects to finance the broadband penetration, territory coverage and usage. |
| ES | National broadband measures outside the scope of US in order to promote the investment and deployment of broadband, financed through the General State budgets and the ERDF. |
| FI | "Broadband for all" project, financed as state aid, but with one third of financing coming from the telecom network operator. |
| IE | Government initiatives, including a Rural Broadband Plan and a National Broadband Plan, with commercial and public funding. |
| LV | National Broadband Plan, promoted by the Ministry of Transport, to achieve the targets of the Digital Agenda for Europe. There is also a state aid programme “Next generation network for rural areas” (the NGN project), supported by the European Regional Development Fund (ERDF). |
| NL | Possibility to use state aid to finance broadband connections in areas that lack coverage. |
| PL | National Broadband Plan (consistent with Digital Agenda for Europe), with private, public and EU funding. |
| PT | Co-financing initiatives in five regions aiming to develop NGA networks in order to assure 40 Mbps for 50% of the population in the targeted areas |
| RO | National Broadband Strategy and two national projects supporting the deployment of broadband infrastructure in underserved areas: one major state aid project, Ro-NET, with financing from the national budget and the ERDF and other smaller scale projects with funds from the Ministry of Agriculture and Rural Development and European Agricultural Fund for Rural Development. |
| SE | Several measures in order to promote deployment of broadband throughout the country, with government funding. |
| SI | Construction of open networks, with state aid and EU funds. |
| UK | BDUK, a Government-funded roll-out programme, is a contractual relationship through which the UK Government provides gap-funding to allow BT plc to roll-out FTTC to at least 95% of the UK by the end of 2017 through the general budget. |
| Non EU MS | |
| NO | Planned scheme to promote access to good quality broadband services (download speeds of 4 Mbps). The scheme has been notified the proposals to the state aid scheme of the EFTA Surveillance Authority (ESA) and is awaiting approval. |

Burimi: BEREK BoR (17) 07

IV. Aksesit ne shërbimet e telefonisë dhe aksesit broadband ne Internet

AKEP ne vitin 2013 ne percaktimin e objektit te SHU, ne lidhje me aksesin ne shërbime telefonike nga vendndodhje fikse, konkludoi se megjithese zhvillimi rrjeteve fikse dhe aksesit ne rrjete fikse per shërbime telefonie eshte shume i kufizuar ne Shqipëri dhe shume me i ulet se ne vendet e BE dhe rajonit, aksesit ne rrjete celulare per shërbime telefonike, perfshire GSM fikse, ka pasur zhvillim shume te madh dhe 4 rrjetet celulare me mbulimin territorial dhe te popullsise me sinjal GSM, potesojne kerkesat e arsyeshme per akses ne rrjetet telefonike nga cdo vendndodhje, per pothuajse te gjithe popullsine e Shqipërisë. Njekohesisht tarifat e shërbimeve telefonike fikse dhe celulare ne vitin 2012, u konsideruan te arsyeshme dhe te perballueshme per kushtet e Shqipërisë. Ne keto kushte, perfundimi ne vitin 2012 ishte qe tregu ofron elementin e aksesit per shërbime telefonie, dhe nuk eshte e nevojshme qe AKEP te percaktojë nje apo disa ofrues te ketij elementi te SHU.

Nderkohe ne lidhje me aksesin broadband, perfundimi ishte se me nivelin nivelin e penetrimit të broadband fikse prej 5.3% në Korrik 2012, Shqipëria nuk plotëson Rregullin 50/80 të përcaktuar nga KE në Komunikatën e Nëntor 2011, dhe per kete arsye ai nuk duhet te jete element i detyrueshem i SHU.

Ne seksionet ne vijim, AKEP ka analizuar zhvillimet dhe tendencat e aksesit ne shërbimet e telefonisë dhe akses broadband ne rrjete fikse dhe rrjete celulare ne keto vite, si dhe te tarifave te ketyre shërbimeve, sidomos ne lidhje me perballueshmerine e tyre. Pjesa me e madhe e seksioneve te meposhteme jane te bazuara ne dokumenta te AKEP si Analiza Tregu dhe Raporte Vjetore.


IV.1 Shërbimet nga rrjete fikse

IV.1.1 Telefonia Fikse

Shërbimet e telefonisë fikse në Shqipëri ofrohen nga rreth 80 sipërmarrës, të cilët zotërojnë rrjetet/infrastrukturën e tyre, përfshirë rrjetin e aksesit apo të lidhjes direkte me përdoruesit fundorë. Siç vihet re edhe nga Figura IV.1 numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse ka patur një rënie të vazhdueshme në 2012-2015 ndërsa ne vitin 2016 u vu re nje rritje e numrit te linjave te telefonisë fikse. Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2015 ishte rreth 227 mijë, ndërsa ne 2016 arriti ne rreth 248 mijë. Ndryshimet në 2014 dhe 2016 të këtij treguesi kanë ardhur dhe për shkak të ndryshimit të mënyrës së raportimit dhe perkufizimit të këtij treguesi⁴ dhe për disa operatorë treguesi dhe pjeset e tregut në vitin 2016 nuk jane të krahasueshëm me vitet e mëparshme. Norma e penetrimit për telefoninë fikse (numër pajtimtarësh për 100 banorë) ne fund te vitit 2016 arriti në 8.8%, që është shumë më e ulët se në vendet e BE apo edhe të rajonit.


⁴ Në 2014 dhe 2015 treguesi i referohet numrit të përdoruesve aktivë (me përdorim në 3 muajt e fundit të telefonisë fikse për përdoruesit me parapagim) ndërsa në 2016 i referohet numrit të linjave të telefonisë fikse dhe pajtimtarëve që kanë të alokuar një numër telefoni fikse, pavarësisht përdorimit ose jo të tij.

FIGURA IV.1 ECURIA E NUMRIT TË PAJTIMTARËVE TË TELEFONISE FIKSE 2000-2015



Megjithë efektin e ndryshimit të përkufizimit apo raportimit të këtij treguesi, tendenca në rënie është e dukshme për disa vite rradhazi tashmë dhe vihet re edhe në reduktimin e përdorimit të minutave të telefonisë fikse nga pajtimtarët. Të dhënat për numrin e pajtimtarëve sipas qarqeve tregojnë se rreth 48% e të gjithë pajtimtarëve të telefonisë fikse janë në qarkun Tiranë. Diferenca në nivelin e përdorimit në zona urbane dhe rurale vihet re nga grafiku i mëposhteme, ku penetrimi mesatar për popullsi në zona urbane është 15% dhe Tirana, Gjirokastra dhe Korça kanë nivel më të lartë se kjo mesatare, ndërsa në zona rurale penetrimi mesatar është vetëm 1.4%.


FIGURA IV.2 NORMA E PENETRIMIT TË TELEFONISE FIKSE SIPAS QARQEVE DHE ZONAVE URABNE/RURALE (2016)



Rënia e përdorimit të shërbimeve të telefonisë fikse vihet re edhe në reduktimin e sasisë totale të thirrjeve të gjeneruara nga rrjetet fikse. Sasia e thirrjeve telefonike të gjeneruara nga pajtimtarët e rrjetit fiks të Altelecom në Tremujorin IV 2015 u reduktua me 19% në krahasim me Tremujorin IV 2014, ndërsa gjatë vitit 2016 një përdorues i rrjetit fiks të Altelecom gjeneroi mesatarisht 65 minuta thirrje në muaj, krahasuar me 67 minuta në 2015.

Diferencat në përdorimin e telefonisë fikse në Shqipëri me vendet tjera vihen re me mire në grafikun e mëposhtëm, i cili paraqet ecurinë e numrit të pajtimtareve për 100 banorë për Shqipërinë dhe mesataren botërore, të vendeve të zhvilluara dhe në zhvillim të kësaj tregësi. Nga të dhënat vihen re se Shqipëria me 8% përdorim të telefonisë fikse ka një nivel disa here më të ulët se vendet e zhvilluara (rreth 40%), rreth dy here të më të ulët se mesatarja botërore (15.2%), madje më të ulët edhe se mesatarja e vendeve në zhvillim (10%).

FIGURA IV.3 NORMA E PENETRIMIT TE TELEFONISE FIKSE NE SHQIPERI DHE VENDE TE TJERA



Burimi: ITU dhe AKEP

Operatorët e rrjetëve fikse kanë rritur zonat e mbulimit me shërbime të rrjetëve fikse (telefoni dhe akses broadband) duke rritur dhe cilësinë e shërbimeve të aksesit broadband, megjithatë sik mund të vihen re shërbimet e telefonisë fikse kanë pasur tendencë rënës, çka është e kundërt me tendencën e shërbimit të aksesit broadband nga rrjetet fikse, si dhe shërbimet nga rrjetet celulare.

IV.1.2 Aksesit në Internet me brez të gjërë

IV.1.2.1 Numri i pajtimtareve

Megjithëse shërbimet e telefonisë nga rrjetet fikse kanë pasur reduktim të ndjeshëm në 5 vitet e fundit, shërbimet e aksesit broadband nga rrjetet fikse kanë pasur rritje të qëndrueshme vjetore gjatë kësaj periudhe kohore. Numri i pajtimtarëve me akses broadband fikse në fund të vitit 2016 arriti në rreth 264 mijë, që përbën një rritje me rreth 9% në krahasim me vitin 2015. Norma e penetrimit për popullsinë dhe për familjet e pajtimtarëve me akses broadband fikse në fund të vitit 2015 ishte 9% dhe 33% përkatësisht. Albtelecom dhe 3 operatorët kryesorë alternativë patën rritje të numrit të pajtimtarëve me 5-18%. Pjesët e tregut të këtyre operatorëve kanë qenë të qëndrueshme dhe Albtelecom zotëron 40% të tregut.

TABELA IV.1 ECURIA E NUMRIT TË PAJTIMTARËVE TË AKESIT BROADBAND NGA RRJETE FIKSE 2010-2016

| Numri i pajtimtarëve me akses ne internet nga rrjete fikse | Albtelecom | Abcom | Abissnet | ASC | OA te tjere | Total Broadband Fiks |
|--|------------|--------|----------|--------|-------------|----------------------|
| 2010 | 70,597 | 13,575 | 7,000 | 5,666 | 23,162 | 120,000 |
| 2011 | 60,055 | 29,321 | 15,321 | 10,129 | 24,871 | 139,697 |
| 2012 | 66,757 | 35,870 | 17,719 | 11,777 | 27,965 | 160,088 |
| 2013 | 73,242 | 43,430 | 20,562 | 15,432 | 29,890 | 182,556 |
| 2014 | 82,747 | 47,480 | 23,259 | 28,489 | 25,956 | 207,931 |
| 2015 | 97,597 | 51,093 | 24,497 | 31,357 | 38,326 | 242,870 |
| 2016 | 109,851 | 52,442 | 29,497 | 37,650 | 176,923 | 263,829 |
| Ndryshimi 2016/2015 | 12.6% | 2.6% | 20.4% | 20.1% | 361.6% | 8.6% |

Tabela e mesiperme jep në mënyrë më të detajuar ecurine e numrit te pajtimtareve me akses broadband ne periudhen 2000-2016 si dhe per operatoret kryesore ne treg. Te gjithë operatorët kryesore vihet re se kane ecuri pozitive ne 3-4 vitet e fundit.

Tendencat e kunderta te zhvillimit te aksesit broadband nga rrjete fikse dhe telefonise fikse vihen me qarte ne figuren me poshte, ku vihet re se pavaresisht se ne 2010 numri i pajtimtareve me akses broadband ishte shume me i vogel se numri i pajtimtareve te telefonise fikse, ne vitet 2015 dhe 2016 numri i pajtimtareve me akses broadband nga rrjete fikse eshte me i madh se numri i pajtimtareve te telefonise fikse.

FIGURA IV.4. ECURIA E PAJTIMTAREVE TE TELEFONISE DHE TE AKSESIT BROADBAND NGA RRJETE FIKSE 2010-2016




Figura e meposhteme parqet ecurine e penetrimit te aksit broadband nga rrjete fikse per popullsi dhe familje ne periudhen 2011-2016, ku mund te vihet se te dy treguesit jane dyfishuar gjate kesaj periudhe. Ne fund te vitit 2016 rreth 33% e familjeve (1 ne 3 familje) kishin akses broadband nga rrjete fikse. Penetrimi sipas popullsise ishte 9.3% dhe Tirana dhe Durresi jane qarqet me penetrim me te madh se niveli mesatar kombetar, me rreth 17% dhe 11% respektivisht.

FIGURA IV.5. PENETRIMI I AKSESIT BROADBAND NGA RRJETE FIKSE SIPAS POPULLSISES DHE FAMILJEVE (2011-2016)





FIGURA IV.6. PENETRIMI I AKSESIT BROADBAND NGA RRJETE FIKSE SIPAS QARQEVE (2016)



IV.1.2.2 Paketat e integruara (Bundles)

Të dhënat e mesipërme tregojnë se shërbimi telefonik për disa vjet tashmë rezulton të ketë marrë rol dytësor në shërbimet nga rrjete fikse, ndërsa nxitësi kryesor i zhvillimit të këtyre rrjeteve janë shërbimet e aksesit broadband dhe sidomos shërbimet e integruara. Ofrimi i shërbimeve të rrjeteve fikse me paketa (bundles) të shërbimeve të aksesit në Internet, telefonisë fikse dhe TV (CaTV ose IPTV) rezulton të jetë forma predominuese e konkurrencës midis operatorëve të rrjeteve fikse. Numri i pajtimtarëve të rrjeteve fikse që kanë akses në shërbime të integruara dyfishe ose trefishe (kombinim Telefoni/Internet/TV) në

fund të vitit 2016 arriti në rreth 187 mijë, rreth 25 % më shumë se në vitin 2015. Në vitin 2016 pajtimtarët me paketa të integruara përbënin 70% të pajtimtarëve me akses broadband në rrjete fikse, ndërsa 35% janë me paketa trefishe (Telefoni, Internet dhe TV).

TABELA IV.2: NUMRI I PAJTIMTARËVE QË KANË AKSES NË SHËRBIME TË INTEGRUARA

| | Totali me paketa të integruara | Telefoni fikse dhe Internet | Telefoni fikse, Internet dhe TV | Internet dhe TV |
|--------------------|--------------------------------|-----------------------------|---------------------------------|-----------------|
| 2014 | 119,230 | 78,419 | 24,330 | 16,481 |
| 2015 | 149,833 | 69,755 | 71,681 | 8,397 |
| 2015 T4 | 149,833 | 69,755 | 71,681 | 8,397 |
| 2016 T1 | 158,861 | 75,230 | 73,058 | 10,453 |
| 2016 T2 | 174,589 | 82,236 | 78,262 | 14,091 |
| 2016 T3 | 177,248 | 83,432 | 80,642 | 13,174 |
| 2016 T4 | 186,983 | 76,045 | 92,932 | 18,006 |
| Ndryshimi Tremujor | 5.5% | -8.9% | 15.2% | 36.7% |
| Ndryshimi v-m-v | 24.8% | 9.0% | 29.6% | 114.4% |

Gjatë vitit 2015, numri i pajtimtarëve me shërbime të integruara në shporta triple play (Telefoni, Internet dhe TV), u rrit rreth 3 herë në krahasim me vitin 2014, ku kontributin më të madh në këtë rritje e kishte Albtelecom, që pati rritje me 3 herë të këtij treguesi në vitin 2015. Ndonëse në vitin 2016, norma e rritjes së këtyre pajtimtarëve u ngadalësua në 22% për Albtelecom (30% për të gjithë tregun), 69% e përdoruesve me akses broadband të Albtelecom ishin me paketa trefishe. Tabela e mëposhtëme paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve të Albtelecom me akses broadband dhe shërbime të integruara në periudhën 2013-2016. Ndërsa në vitin 2013 shumica e pajtimtarëve të Albtelecom ishin me paketa dyfishe (Telefoni dhe Internet) dhe nuk kishte paketa trefishe, në fund të vitit 2016 rreth 69% e pajtimtarëve me akses broadband të Albtelecom ishin pajtimtarë të shportave trefishe (Telefoni, Internet dhe IPTV).

TABELA IV.3: NUMRI I PAJTIMTARËVE TË ALBTELECOM ME SHËRBIME TË INTEGRUARA

| | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | Ndryshimi 2016/15 |
|--|--------|--------|--------|---------|----------------------|
| Numri total i pajtimtarëve me akses broadband | 73,242 | 82,747 | 97,597 | 109,851 | 13% |
| Numri i pajtimtareve që kanë akses në shërbime të integruara (TV, Internet, telefoni) | 70,961 | 76,230 | 93,873 | 109,034 | 16% |
| Telefoni fikse dhe Internet | 70,961 | 60,939 | 32,293 | 33,673 | 4% |
| Telefoni fikse, Internet dhe IPTV | | 15,291 | 61,580 | 75,361 | 22% |

IV.1.2.3 Teknologjia

Në tregun e aksesit broadband me pakicë ekzistojnë mundësi të ndryshme për realizimin e shërbimeve të aksesit nëpërmjet rrjetit telefonik tradicional (ADSL), aksesit nëpërmjet rrjeteve optike fibër (FTTH, FTTB, FTTC / FTTN), kabell koaksial (CATV) etj. Te dhenat e tregut tregojnë se teknologjia mbizoteruese është DSL e ndjekur nga kabllor koaksial. Shumica e lidhjeve DSL janë me rrjete të kombinuar fiber optike dhe bakri (FTTN/FTTC). Figura e mëposhtme parqet shpërndarjen e lidhjeve broadband fikse sipas teknologjisë në Shqipëri dhe mesataren në vendet e BE. DSL është teknologjia kryesore në Shqipëri dhe në BE. Në Shqipëri lidhjet DSL përbejnë 63% të totalit të lidhjeve broadband fikse, dhe shumica e tyre është me kombinim fiber optike + linje bakri apo FTTN/FTTC.

FIGURA IV.7: LIDHJET BROADBAND FIKS SIPAS TEKNOLOGJISË SHQIPËRI V BE 2015/2016




Burimi: AKEP dhe Digital Agenda Scoreboard KE

Lidhjet me fiber optike në Shqipëri (FTTH/B) përbejnë 11% të totalit të lidhjeve, nivel i krahasueshem me BE me 9%. Lidhjet kabllore në Shqipëri përbejnë 21%, ndërsa NGA kabllor (DOC SIS 3.0 dhe me shume) përben 66% të totalit të lidhjeve kabllore, ndërsa në vendet e BE ato përbejnë 80%. Pajtimtarët me lidhje në NGA (FTTx + NGA kabllore) në Shqipëri përbejnë 78% të të gjitha lidhjeve broadband, ku shumica e tyre janë në ADSL në FTTN/C, ndërsa në vendet e BE ky proporcion është 35% ku shumica janë VDSL, FTTH/B dhe Cable DOC SIS 3.0.

IV.1.2.4 Shpejtesia e aksesit broadband

Figura e mëposhtme tregon shpërndarjen e pajtimtarëve me akses broadband në internet në rrjetet fikse sipas shpejtësive të përdorura në 2014-2016. Siç mund të vihet re shpejtësia më e përdorur është 4-10 Mbps me 58% në 2016. Të dhënat tregojnë se proporcioni i pajtimtarëve me lidhje broadband me shpejtësi më të ulët se 4 Mbps ka ardhur në rënie ndërsa për shpejtësi mbi 4Mbps ka ardhur në rritje. Në 2016 rritjen e më të madhe e kishte pjesa e pajtimtarëve me lidhje broadband me shpejtësi 10-30Mbps: nga 12 mijë në 2015 në 40 mijë në 2016.

FIGURA IV.8: SHPËRNDARJA E PAJTIMTARËVE ME AKSES BROADBAND FIKS SIPAS SHPEJTËSISE 2014-2015



Te dhënat e mësipërme tregojnë se rreth 93% e pajtimtarëve me akses broadband nga rrjetet fikse kanë akses me shpejtësi 2Mbps ose më të lartë. Megjithatë pjesa e pajtimtarëve me shpejtësi më të ulët se 2 Mbps është rritur nga 5% në 2015 në 7% në 2016, ajo është një pjesë shumë e vogël e totalit të lidhjeve broadband fikse. Të dhënat më të detajuara tregojnë se në intervalin 4-10 Mbps, pjesa më e madhe e përdoruesve janë me shpejtësi 4-6Mbps, ndërsa sipas ofertave të operatorëve kryesorë shpejtësia mbizotëruese në intervalin “256 kbps deri në < 2 Mbps” rezultoi të jetë 1 Mbps.

Per aksesin broadband nga rrjetet fikse, rezultoi se shpejtësia më e përdorur është 2-6Mbps dhe teknologjia mbizotëruese është ADSL.

IV.2 Sherbimet nga rrjetet celulare

Tabela e mëposhtëme paraqet disa tregues kryesorë të volumit të shërbimeve celulare për vitet 2013-2016 dhe normën e ndryshimit vjetor të tyre.

TABELA IV.4: TREGUES KRYESORË TË VOLUMIT TË SHËRBIMEVE CELULARE 2013-2015

| | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | Ndryshimi 2016/2015 | Ndryshimi 2016/2013 |
|---|---------------|----------------------|---------------|---------------|------------------------|------------------------|
| Numri i perdoruesve te telefonise celulare: | | | | | | |
| - sipas kartave SIM | 5,282,350 | 4,928,784 | 4,777,885 | 5,160,060 | 8% | -2% |
| - perdorues active | 3,685,983 | 3,406,772 | 3,442,665 | 3,360,888 | -2% | -9% |
| Numri perdoruesve me akses broadband 3G/4G: | | | | | | |
| - Totali | 1,231,259 | 1,576,877 | 2,049,072 | 2,739,550 | 34% | 122% |
| - Perdorues aktive | 1,231,259 | 907,975 ⁵ | 1,297,281 | 1,686,354 | 30% | 37% |
| Thirrje telefonike dalese te perdoruesve celulare (minuta) | 6,769,300,966 | 7,301,024,035 | 7,381,147,348 | 6,793,769,155 | -8% | 0% |
| Numri mesazheve SMS te derguara nga perdoruesit | 1,689,200,882 | 1,826,346,190 | 1,598,702,865 | 1,610,322,977 | 1% | -5% |
| Volumi total i te dhenave te transmetuara ne rrjete celulare (GB) | 2,529,549 | 6,269,940 | 12,740,073 | 26,753,639 | 110% | 958% |

Nga të dhënat e tabelës vihet re se numri i përdoruesve të shërbimeve tradicionale telefonike celulare dhe sasia e thirrjeve dhe SMS-ve të gjeneruara nga përdoruesit celularë ka pasur luhatje gjate periudhes 2013-2016 dhe keta tregues jane kryesisht me tendence renese. Nderkohe perdorimi i sherbimeve te aksesit broadband nga rrjete celulare ka rritje te ndjeshme ne 2016 krahasur me vitin 2013, si dhe me vitin 2015. Numri i perdoruesve active ka rritje vetem me 37% ne 2013-2016 por volume i te dhenave eshte rritur me shume se 10 here gjate kesaj periudhe. Rritje te ndjeshme keta tregues kane psur edhe ne vitin 2016 krahasuar me vitin 2015, ku numri i perdoruesve te sherbimeve 3G/4G eshte rritur me 30-34%, ndersa volume i te dhenave eshte dyfishuar.


IV.2.1 Telefonia celulare

Numri i pajtimtarëve të shërbimeve celulare sipas kartave SIM (përshirë kartat e dedikuara për të dhëna) në fund të vitit 2016 ishte rreth 5.3 milionë që përbën rritje me 7.8% në krahasim me vitin 2015. Ndërkohë numri i përdoruesve aktivë (përdorim në 3 muajt e fundit të vitit) të telefonisë celulare ne vitin 2016 arriti në rreth 3.4 milionë që përbën një rënie me

⁵ Ndryshimi i madh ne 2014 ne krahasim me 2015 dhe 2013 vjen edhe per shkak te ndryshimit te menyres se rpoartimit te ketij treguesi.

2.1% në krahasim me vitin 2015. Numri total i përdoruesve të rrjeteve celulare që kanë përdorur aksesin broadband në Internet të paktën një herë gjatë vitit 2016 ishte rreth 2.7 milion, ndërsa numri i përdoruesve aktivë (përdorim të Internetit në tre muajt e fundit) ishte rreth 1.7 milionë, që përbën rritje vjetore me 34% dhe 30% respektivisht.

FIGURA IV.9. ECURIA E NUMRIT TË PËRDORUESVE CELULARË SIPAS TREMUJOREVE T4 2014 - T4 2016



Nga të dhënat e ecurisë së numrit të përdoruesve celularë sipas tremujorëve të paraqitur në figurën e mësipërme vihet re se:


- Numri i pajtimtarëve të shërbimeve celulare sipas kartave SIM në fund të T4 2016 ishte rreth 5.3 milionë që përbën një rënie me 2.5% në krahasim me tremujorin e mëparshëm, por rritje me 7.8% në krahasim me T4 2015;
- Numri i përdoruesve aktivë të telefonisë celulare gjatë T4 2016 arriti në rreth 3.4 milionë që përbën një rënie me 14.2% me T3 2016 dhe rënie me 2.1% në krahasim me T4 2015;
- Numri i përdoruesve aktivë të aksesit broadband në Internet nga rrjetet celulare në T4 2016 ishte rreth 1.7 milionë që përbën reduktim me 8% me tremujorin e mëparshëm, por rritje më të ndjeshme me 30% në krahasim me Tremujorin e katërt 2015.
- Të dhënat tregojnë se Tremujori i tretë i vitit ka zakonisht rritje më të madhe se tremujorët e tjerë, dhe kjo shpjegohet me efektin sezonal të muajve Korrik-Gusht që përkon me sezonin turistik dhe kthimin e emigrantëve në Shqipëri.
- Rënia në tremujorin e katërt 2016 shpjegohet pasi vjen pas rritjes së madhe në T3 2016. Ndërsa numri i përdoruesve të telefonisë ka luhatje rreth niveleve tashmë të maturuara, numri i përdoruesve të aksesit broadband ka trend rritës.

Proporcioni i përdoruesve aktivë ndaj kartave SIM aktive në 2016 ishte 66% në krahasim me 72% në vitin 2015. Ky proporcion varion nga 59% për Altelecom në 79% për Plus. Në fund të vitit 2016 numri përdoruesve me parapagim përbënte 92% të numrit total të përdoruesve aktivë celularë, duke mos pasur ndryshim nga viti 2015. Pëseja e përdoruesve me parapagim në totalin e përdoruesve aktivë celularë varion nga 83% për Plus në 96% për Vodafone.

Sasia totale e thirrjeve telefonike të gjeneruara nga përdoruesit celularë gjatë vitit 2016 u reduktua me 8% në krahasim me vitin 2015, ndërkohë numri i mesazheve SMS të dërguara nga përdoruesit celularë rezultoi me një rritje modeste prej 1%. Pesha e thirrjeve brenda rrjetit ndaj totalit të thirrjeve dalëse në vitin 2016 u reduktua në 60% nga 69% në 2015 (84% në 2014), ndërsa pesha e thirrjeve off-net u dyfishua duke arritur në 37% krahasuar me 18% në 2015 (8% në 2014). Rritjet e ndjeshme të nivelit dhe peshës së thirrjeve off-net në totalin e thirrjeve celulare në vitet 2015-2016 dhe reduktimet në thirrjet on-net kanë ndodhur në vijim të zbatimit të detyrimeve operatorëve celularë për mos-diskriminim në tarifatat e thirrjeve brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare.

Reduktimi i ndjeshëm i thirrjeve ndërkombëtare çoi në reduktim edhe të peshës së këtyre thirrjeve në 2% nga 11% në vitin 2015. Rënia e madhe e trafikut të thirrjeve dalëse ndërkombëtare në vitin 2016 ka ardhur pas rritjeve të ndjeshme të këtyre thirrjeve në vitet 2014-2015. Këto luajtje shpjegohen me ndryshimet ofertat/paketat e operatorëve celularë për thirrjet ndërkombëtare gjatë kësaj periudhe për shkak të ndryshimeve në tarifatat e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetet celulare në vendet e BE-se të cilat përbëjnë pjesë të kostove të thirrjeve dalëse ndërkombëtare për operatorët shqiptarë. Reduktimi i minutave/ofertave për këto thirrje nga operatorët celularë Shqiptarë në vitin 2016 ka ardhur për shkak të rritjes së tarifave të terminimit në një sërë vendesh të BE-së për thirrjet ndërkombëtare të origjinuara jashtë vendeve anëtare të BE.

FIGURE IV.10 ECURIA E STRUKTURËS SË TRAFIKUT DALËS CELULAR (2003-2015)



Trendi rënies së nivelit dhe/ose ritmeve të rritjes së përdorimit të thirrjeve dhe SMS-ve dhe trendi rritës i aksesit broadband celular në 2-3 vitet e fundit janë tregues të efektit të zëvendësimit të thirrjeve telefonike/mesazheve SMS me thirrje/mesazhe nga aplikacionet OTT (Over The Top) në Internet në aparat celular si Skype, WhatsApp, Viber etj.

IV.2.2 Aksesit broadband ne rrjete celulare 3G/4G:

Shërbimet e aksesit broadband nga rrjete celulare jane sherbime relativisht te reja ne Shqiperi. Keto sherbime filluan te ofrohen ne standardin 3G ne vitin 2011, pas pajisjes se Vodafone (Dhjetor 2010) dhe Telekom Albania (Shtator 2011) me autorizime individuale per brezat 1900/2100 MHz. Albtelecom (EM) u pajis me autorizim individual per brezin 1900/2100 MHz ne Dhjetor 2012, ndersa Plus Communication ne vitin 2016. Sherbimet ne standardin 4G filluan te ofrohen ne Tremujorin III 2015, pas heqjes se kufizimeve te perdorimit te frekuencave per operatoret celulare dhe dhenies se autorizimeve ne brezin 2500/2600 MHz.


Numri i pajtimtarëve⁶ me akses broadband celular në fund të vitit 2016 arriti në rreth 2.7 milion nga rreth 2 milion në fund të 2016, që përbën rritje të konsiderueshme të numrit apo rritje me 34%. Numri i përdoruesve aktivë (përdorim 3 muajt e fundit) të shërbimeve me akses broadband nga rrjetet celulare (3G/4G nga aparateve celulare dhe me karta USB/modem) në vitin 2016 ishte rreth 1.7 milion apo 30% më shumë se në vitin 2015. Përdorimi i aksesit broadband nga rrjetet 3G/4G nepermjet aparateve celulare perben rreth 93% te totalit te perdoruesve te ketij sherbimi dhe rritjet e ndjeshme te ketij treguesi rezultojne nga kjo kategori, ndersa numi i perdoruesve nepermjet kartave USB/modem ne tre vitet e fundit eshte pothuajse i pandryshuar ne nivel rreth 120 mije perdorues. Penetrimi per popullsi i perdoruesve aktive celulare te aksesit broadband nga rrjetet 3G dhe 4G ne vitin 2016 arriti në 60% krahasuar me 46% ne vitin. Të katërt operatorët me rrjete 3G/4G kanë pasur rritje të numrit të përdoruesve aktive të shërbimeve akses broadband nëpërmjet aparatave celulare.

TABELA IV.5: NUMRI I PAJTIMTARËVE ME AKSES BROADBAND 3G/4G

| | Telekom Albania | | Vodafone | | Albtelecom (EM) | | Plus | Total | |
|---------------------|-----------------|-----------|----------------|-----------|-----------------|-----------|---------------------------|----------------|-----------|
| | Aparat celular | USB/Modem | Aparat celular | USB/Modem | Aparat celular | USB/Modem | Aparat celular+ USB/Modem | Aparat celular | USB/Modem |
| 2011 | 46,000 | 9,000 | 202,756 | 25,493 | | | | 248,756 | 34,493 |
| 2012 | 222,882 | 17,833 | 371,426 | 37,572 | | | | 594,308 | 55,405 |
| 2013 | 279,428 | 32,138 | 568,207 | 66,086 | 272,257 | 13,143 | | 1,119,892 | 111,367 |
| 2014 | 163,797 | 61,549 | 503,855 | 46,341 | 119,998 | 12,435 | | 787,650 | 120,325 |
| 2015 | 278,886 | 97,087 | 686,805 | 20,075 | 209,650 | 4,778 | | 1,175,341 | 121,940 |
| 2016 | 360,415 | 99,806 | 903,317 | 18,537 | 228,734 | 2,587 | 72,958 | 1,565,424 | 120,930 |
| Ndryshimi 2016/2015 | 29% | 3% | 32% | -8% | 9% | -46% | | 33% | -1% |

⁶Numri i pajtimtareve (aktive ose jo) qe kane perdorur aksesin broadband(3G/4G) ne Internet te pakten nje here gjate vitit.

FIGURA IV.11 NUMRI I PËRDORUESVE AKTIVE TË AKSESIT BROADBAND NGA RRJETE CELULARE



Rritja e përdorimit të aksesit broadband nga rrjetet celulare 3G/4G në vitet e fundit vihet re sidomos në rritjen e volumit të të dhënave të transmetuara në rrjetet celulare. Në vitin 2014 rritja vjetore e trafikut të të dhënave në rrjetet celulare ishte 148% dhe ky trend vijoi edhe në vitet 2015 dhe 2016 ku rritja vjetore ishte 103% dhe 110% respektivisht. Në periudhën 2013-2016 volumi i të dhënave të aksesit në Internet në rrjetet celulare është rritur më shumë se 10 herë.

Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare:

Në vijim është dhënë një tabelë me të dhëna për përdorimin mesatar mujor të thirrjeve telefonike dhe mesazheve SMS për përdorues celularë në 2011 deri në 2016, sipas dy treguesve të përdoruesve: përdorues aktiv dhe karta SIM. Përdorimi mesatar mujor për përdorues është llogaritur sipas thirrjeve dalëse (thirrje që gjenerohen nga një përdorues) dhe thirrjeve hyrëse (thirrjet e marra nga një përdorues), të matura në minuta. Njekohesisht tabela përmban dhe përdorimin mesatar mujor për të dhëna për të gjithë përdoruesit e aksesit broadband celulare (të paktën një herë përdorim gjatë vitit).

TABELA IV.6: PËRDORIMI MESATAR MUJOR I SHËRBIMEVE CELULARE 2010-2015⁷

| | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | Ndryshimi 2016/2013 |
|----------------------------|------|------|------|------|------|------|------------------------|
| Përdorues Aktivë | | | | | | | |
| Thirrje dalëse | 130 | 152 | 156 | 173 | 182 | 166 | 6% |
| Thirrje të marra (hyrëse) | 147 | 168 | 167 | 168 | 171 | 169 | 1% |
| MOU* | 277 | 319 | 324 | 341 | 353 | 335 | 3% |
| SMS (dalëse) | 19 | 35 | 39 | 43 | 39 | 39 | 0% |
| Trafik Data (GB) | | | | 0.55 | 0.89 | 1.49 | 171% (2016/2013) |
| Përdorues Karta SIM | | | | | | | |
| Thirrje dalëse | 83 | 93 | 103 | 120 | 128 | 114 | 11% |
| Thirrje të marra (hyrëse) | 94 | 103 | 111 | 117 | 120 | 116 | 5% |
| MOU* | 177 | 195 | 214 | 237 | 248 | 230 | 7% |
| SMS (dalëse) | 12 | 21 | 26 | 30 | 28 | 27 | 4% |
| Trafik Data (MB) | 102 | 146 | 230 | 357 | 541 | 954 | 315% |

Burimi: Perlllogaritje te stafit te AKEP bazuar ne te dhenat periodike te raportuara nga operoret

Gjatë vitit 2016, një përdorues celular aktiv (që ka kryer komunikim në 3 muajt e fundit) ka kryer mesatarisht **166 minuta thirrje dalëse**, ka dërguar **39 mesazhe SMS** në muaj dhe ka konsumuar **1.48 GB në Internet broadband**. Këto vlera përdorimi janë më të vogla nëse si numër përdoruesish celular i referohemi numrit total të përdoruesve sipas kartave SIM: 114 minuta dalëse, 27 SMS dhe 954 MB në muaj. Treguesit e përdorimit mestar të thirrjeve dhe SMS-ve janë me tendencë rënëse në 2016, me 1-11%, ndërsa përdorimi mesatar i të dhënave ka rritje të ndjeshme me 68% - 76%. Gjatë vitit 2016 një përdorues celular ka përdorur mestarisht 954 MB në muaj krahasuar me 541 MB në vitin 2015. Krahasimi me vitin 2013 tregon rritje te moderuar te perdorimit te thirrjeve dhe SMS-ve por rritje te ndjeshme te perdorimit te aksesit broadband.

IV.2.2.1 Mbulimi dhe treguesit e shpejtesises se aksesit broadband ne rrjete celulare

Tabela e meposhteme paraqet mbulimin territorial dhe te popullsise me rrjete celulare GSM, UMTS (3G) dhe LTE (4G) deri ne fund te vitit 2016.

⁷Të dhënat e plota për këtë llogaritjen e këtyre treguesve për vitin 2015 janë të disponueshem vetëm pas datës 10 Prill 2016.

TABELA IV.7: TREGUES TE MBULIMIT ME RRJET CELULARE 2016 (%)

| | Telekom(AMC) | Vodafone | Albtelecom | PLUS |
|---|--------------|----------|------------|------|
| Mbulimi i territorit me rrjet GSM | 92.5 | 95.0 | 93.8 | 90.0 |
| Mbulimi i territorit me rrjet UMTS (3G) | 87.8 | 88.0 | 86.8 | 39.0 |
| Mbulim i territorit me rrjet LTE(4G) | 46.1 | 20.0 | 20.0 | - |
| Mbulimi i popullsisë me rrjet GSM | 99.8 | 99.8 | 99.4 | 98.9 |
| Mbulimi i popullsisë me rrjet UMTS (3G) | 96.4 | 99.0 | 90.4 | 77.7 |
| Mbulimi i popullsisë me rrjet LTE(4G) | 80.2 | 68.0 | 60.0 | - |

Burimi: Raportimet e operatoreve celulare

Nga te dhenat e tabelës se mesiperme vihet re se mbulimi me rrjet/sinjal GSM qe garanton akses ne shërbimet e telefonisë celulare dhe akses ne Internet GPRS arrin deri ne 95% te territorit dhe deri ne 99.8% te popullsisë. Te kater operatoret celulare kane nivele te ngjashme mbulimi territorial dhe te popullsisë me rrjet GSM. Per rrjetet UMTS qe ofrojne shërbime te gjënerates se trete (3G) mbulimi territorial arrin deri ne 88% ndërsa per popullsi deri ne 99%. Vodafone, Telekom Albania dhe Albtelecom kane niele te ngjashem mbulimi, ndërsa Plus filloi ofrimin e shërbimeve 3G me vone se tre operatoret e tjere (ne vitin 2016) ka arritur ne 39% mbulim territorial dhe rreth 78% mbulim te popullsisë. Zhvillimi i rrjeteve LTE (4G) filloi vetem ne vitin 2015 dhe mbulimi me keto rrjete eshte ne nivele me te uleta duke aritur ne 20-46% te territorit dhe 60-80% te popullsisë per Vodafone, Albtelecom dhe Telekom Albania, ku vihet re se Telekom Albania ka nivele me te larta mbulimi se dy opertaoret e tjere celulare.

Rrjetet UMTS garantojne ofrimin e shërbimit te aksesit broadband ne Internet nga rrjet celular dhe mbulimi i 99% te popullsisë me rrjet 3G eshte nje nivel shume i shume i mire per te mundesuar aksesin broadband ne internet per te gjithë popullsinë. Megjithate, mbulimi territorial me rrjet 3G arrin deri ne 88% ndërsa me rrjet 4G deri ne 46%, dhe AKEP sic eshte theksuar ne hyrje te dokumnetit ka evidentuar zona ne te cilat operatoret celulare duhet te permiresojne mbulimin me rrjet GSM dhe 3G. AKEP ka perfshire si pjese te autorizimeve individuale te T-Albania, Vodafone dhe Albtelecom angazhimet e tre operatoreve per investime te perbashkete dhe te vecanta ne zonat e identifikuara me probleme mbulimi.

Për sa i përket shpejtësisë së Internetit celular, sipas matjeve të kryera nga AKEP shpejtësia mesatare e doënload për teknologjitë UMTS dhe LTE (3G/4G) në zona të plazheve dhe qyteteve varion nga rreth 2 Mbps në 7-9 Mbps për rrjete 3G dhe nga rreth 8 Mbps në 20 Mbps për rrjetet 4G.

IV.3 Tarifat e telefonise dhe aksesit broadband

IV.3.1 Tarifat e telefonise fikse

Tendence e viteve të fundit të operatorëve të telefonisë fikse ka qene promovimi i paketave tarifore me përfshirje minutash thirrje telefonike në pajtim mujor (bundles of minutes) si dhe kombinim të shërbimeve të telefonisë dhe aksesit në Internet (bundles of services). Operatorët më të mëdhenj alternative si Abcom dhe ASC tradicionalisht janë ofrues të shërbimeve akses në internet, telefoni dhe transmetim të shërbimeve televizive, dhe ofrojnë dhe paketa të integruara më të tre shërbimet në një shportë dhe me tarifë mujore të përbashkët. Gjatë vitit 2014 edhe Albtelcom filloi ofrimin e paketave trefishe, Telefoni, Internet dhe IPTV, madje edhe paketa me kater sherbime (telefoni fikse, Internet, TV dhe telefoni celulare). Deri në fund të 2014 rreth 20% e pajtimtarëve familjarë me akses broadband të Albtelcom ishin përdorues të paketave 3-fishe (telefoni, Internet dhe IPTV).

AKEP nepermjet analizes se tregut ne 2013 dhe me VKD nr.2337, date 30.07.2013, vendosi qe Albtelcom ka status me FNT ne tregun me pakice te aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse, por bazuar ne nje sere faktoresh vendosi per heqjen e detyrimit te kontrollit te tarifave me pakice te pajtimtareve, duke filluar nga data 1.01.2014.

Albtelcom gjatë vitit 2014 kreu rritje të tarifave të disa lloje të thirrjeve telefonike dhe tarifës së pajtimit mujor për kategorinë familjare nga 530 lekë/muaj (me TVSH) në 700 lekë/muaj (me TVSH). Rritja e pajtimit mujor u shoqërua me përfshirje të 60 minutave ndërkombëtare dhe minutave brenda rrjetit Albtelcom në kohën off-peak, në pagesën fikse të pajtimit mujor, heqje të tarifës fikse për thirrje si dhe përfshirje të akses në Internet me shpejtesi 1 Mbps dhe kapacitet 1GB doëload. Rritja e pajtimit mujor dhe përfshirja e minutave falas në pajtim mujor rezultojne te jenë në linjë me mënyrën e tarifimit në vende të tjera të telefonisë fikse dhe që synojnë njëkohësisht të nxisin konsumin e thirrjeve telefonike fikse.

Tabela e meposhteme paraqet nivelin e tarifave te pajtimit mujor per perdoruesit familjare te paketes standard, cfare perfshihet ne pagesen e pajtimit mujor dhe nese ka paketa te tjera opsionale per perdorim te ulet dhe detaje mbi keto paketa. Te dhenat jane per vitin 2013/2014 per vendet e rajonit dhe per Shqiperine eshte perditesuar me ndryshimet e kryera nga Albtelcom ne Qershor 2014 dhe qe jane ende ne fuqi.

TABELA IV.8: KRAHASIM I TARIFAVE TE PAKETES STANDARDE TE ALBTELECOM ME VENDET E SEE (2013/14)

| Shteti | Tarifa standard e pajtimit mujor me TVSH (€) | Vlera e njesive te thirrjeve telefonike te perfshira ne Pajtim mujor | | A ka pakete me perdorim te ulet? | Kufizime per paketen me perdorim te ulet | Tarifa mujore e paketes me perdorim te ulet me TVSH (€) | Vlera e njesive te thirrjeve telefonike te perfshira ne Pajtim mujor | |
|---|--|--|--|--|---|---|--|---|
| | | Sasia e thirrjeve | Vlera nominale per cdo njesi thirrje (€) | Baza e ofrimit? | | | Sasia e thirrjeve | Vlera nominale per cdo njesi thirrje (€) |
| Croatia | 9.92 | 60 minutes | 0.039 per minute | Super 30 | Vetem per perdores qe marrin asistence sociale | 4.96 | - | - |
| Iceland | 12.44 | - | - | Nuk ka | - | - | - | - |
| FYR Macedonia | 7.65 | - | - | Pjese e sherbimit universal me 4 plane tarifore: 1. Tarife minimale 2. Tarife per persona me aftesi te kufizuara 3. Model me tarifa sociale me parapagim 4. Tarifa per pensioniste | - | 4.96 | 0 | 2.439 |
| Montenegro | 6.07 | 100 minutes of local off-peak calls | 0.022 (19-07h) | Yes (mini package) | Residential users only | 3.094 | 0 | - |
| Serbia | 4.51 | 300 pulses | 0.004 | Yes. Commercial offer | Fully disabled customers | 50% off the regular price | 300 pulses | 0.004 |
| Turkey | 6.44 | 3,000 minutes of on-net call | - | Yes. Commercial offer | - | 5.548 | 3,000 minutes of on-net call | - |
| Albania | 5.00 | Unlimited on-net off-peak calls + 60 international minutes + Internet 1 Mbps | -0.036-0.050 (on-net) (20.00-08.00) - 0.132 Interenaltioanl | None | - | - | - | - |
| Bosnia & Herzegovina BH Telecom Telekom Srpske HT Mostar | • 5.85 • 6.55 • 7.78 | 100 minutes of local calls in peak time | • 0.020/min • 0.018/min • 0.016/min | Yes | families of soldiers died in the ear, disabled veterans, people with disabilities | 2.512 | 100 minutes of local calls in peak time | • 0.020/min • 0.018/min • 0.016/min |
| Kosovo* | 9.36 | 2,500 | 0.046 | Yes | - | 5.788 | 75 | 0.046 |

Burimi: AKEP dhe Cullen International Report 4, April 2014


Nga tabela mund te vihet re se:

- Tarifa e pajtimit mujor standard e Albtelecom ne nivelin 5 Euro/muaj eshte me uleta ne rajon, pervec Serbise qe e ka 4.5 Euro (aktualisht eshte 5.47 euro)
- Vendet qe kane pasur Pajtim mujor te ulet si Serbia, Mali i Zi, Maqedonia kane levizur drejt rritjes se tarifes se pajtimit mujor dhe ndryshimet ne Shqiperi te kesaj tarife duken te ngjashme me keto vende (Figura III.6);
- Sasia dhe vlera monetare e thirrjeve te perfshira ne tarifen mujore te Albtelecom jane me te lartat ne rajon (pozitive per perdoresin). Njekohesisht ne tarifen mujore te

Albtelecom perfshihet dhe akses ne Internet 1Mbps, qe perben perfitim shtese per perdoruesit e kesaj pakete;

- Vlera e tarifes se pajtimit mujor te paketes standarde te Albtelecom eshte ne nivel te ngjashem me tarifen e pajtimit mujor te paketave me perdorim te ulet ne Kroaci, Maqedoni, Turqi dhe Kosove dhe me perfitime ekstra (njesite te thirrjeve dhe aksesit ne Internet) me te medha se ne keto vende.

FIGURA IV.12: ECURIA E TARIFËS SË PAJTIMIT MUJOR FAMILJARE: SHQIPËRI DHE SEE 2006-2013/4



Burimi: Cullen International Report 4, April 2014 dhe AKEP.

Nga informacioni me i perditësuar i vitit 2015 i tarifave te operatoreve incumbent ne vendet e rajonit per paketat standard tregon se perseri paketa e Albtelecom eshte nga paketat me Pajtim mujor me te ulet, madje edhe se Serbia qe duket se ka rritur pajtimin mujor krahasuar me vitin 2013.

TABELA IV.9: KRAHASIM I TARIFAVE TE PAKETES STANDARDE TE ALBTELECOM ME VENDET E SEE (2015)

| Shteti | Programi | Tarifa (Euro) | Minuta brenda rrjetit | Minuta kombetare |
|--------------------|-----------------------|---------------|-----------------------|------------------|
| Shqiperia | Paketa baze familjare | 5.00 | pa limit (off-peak) | 60 |
| Serbia | Paketa standarte | 5.47 | N / A | 150 |
| Rumania | Paketa Small | 7.26 | pa limit | 100 |
| | Paketa Medium | 10.34 | pa limit | 200 |
| | Paketa Large | 12.54 | pa limit | 400 |
| Kroacia | Super 60 | 9.75 | 60 | N / A |
| | Halo non stop | 14.95 | pa limit | N / A |
| | Halo non stop+ | 16.90 | pa limit | N / A |
| Bosnje Hercegovina | Paketa baze | 7.65 | 150 | N / A |
| | Paketa sociale | 2.50 | 100 | N / A |
| | Phone 15 | 8.95 | 200 | N / A |
| | Phone 25 | 14.92 | 400 | N / A |
| | Flat BiH | 29.84 | 3000 | 300 |
| | Senior plus | 8.95 | 150 | N / A |

| | | | | |
|-----------|----------------|-------|-------|-------|
| Mali i Zi | Tarifne opcije | 5 | N / A | 50* |
| | Tarifne opcije | 9.9 | N / A | 120* |
| | Tarifne opcije | 19.9 | N / A | 250* |
| Kosova | TiKtel 0 | 3.99 | 0 | N / A |
| | TiKtel 300 | 5.49 | 30 | N / A |
| | TiKtel 1000 | 7.99 | 120 | N / A |
| | TiKtel NS | 15.99 | 180 | N / A |

(*)Shtuar ketyre minuta edhe minuta nderkombetare

Burimi: Kerkimi i AKEP (Qershor 2015)

Paketat standarde të operatorëve alternativë kanë tarifë pajtimi mujor shumë të ulët, madje ASC dhe Telekom Albania ofrojnë dhe paketa tarifore me parapagim (Pajtim mujor zero). Karakteristikë tjetër e operatorëve Alternativë është ofrimi falas i thirrjeve brenda rrjetit (të përfshira në pagesën mujore).

IV.3.2 Tarifat e aksesit broadband nga rrjete fikse

Sherbimi i aksesit broadband mund të tarifohet si shërbim me vehte (stand alone) ose si pjesë e paketave me disa shërbime të tjera si Telefoni dhe/ose TV, të integruara në një paketë dhe me një tarifë të vetme mujore (bundles). Ecuria e numrit të pajtimtareve dhe politikat tarifore të operatorëve tregojnë për një rritje të ndjeshme të tarifimit me paketa të integruara në vitet e fundit. Me poshtë paraqiten krahasime të tarifave të paketave të ndryshme të aksesit broadband të Albtelecom dhe operatorëve të tjerë alternativë fikse në Shqipëri si dhe disa krahasime të tarifave të Albtelecom me vendet e BEREC. Tarifat për krahasimin me vendet e BEREC janë në Euro me TVSH dhe të axhustuara me kursin e këmbimit për fuqinë blerëse (PPP) dhe për Shqipërinë është përdorur kursi 1 Euro=62 lek. Pra në terma nominale me kursin e këmbimit të tregut tarifat e paraqitura në figurat e mëposhteme janë me shumë se dy here më të lira, por për krahasueshmëri me fuqinë blerëse të njëjtte me vendet e BEREC përdoret kursi i cituar PPP.

Aksesi broadband (stand alone)

Megjithatë tendenca e viteve të fundit tregon për rritje të ndjeshme të përdorimit të paketave të integruar (telefoni, Internet dhe TV), disa operatorë kryesorë ofrojnë paketa me vehte për Internetin. Në kuadër të përballueshmërisë së tarifave të aksesit broadband tabela e mëposhteme paraqet disa paketa të aksesit broadband si shërbime me vehte për shpejtësi 1-4 Mbps.

TABELA IV.10: TARIFA TE AKSESIT BROADBAND (STAND ALONE) PER SHPEJTESI 1-4MBPS

| Operatori | Abcom | Abissnet | | Albtelecom |
|------------------------------------|---------------------------|----------|----------|---------------|
| Paketa | Internet me volum trafiku | ADSL 1 | ADSL 2 | ADSL me limit |
| Shpejtësia Download | 4 Mbps | 1 Mbps | 2 Mbps | 2 Mbps |
| Limiti Download | 5GB | Pa limit | Pa limit | 4GB |
| Tarifa Mujore (Lek me TVSH) | 300 | 890 | 1,290 | 1,199 |

Sic mund te vihet re nga te dhenat e tabelës operatorët ofrojnë paketa Interneti duke filluar nga 300 lek/muaj me TVSH (Abcom) per shpejtësi 4 Mbps dhe me limit 5GB. Aksesit ne internet me shpejtësi 1 Mbps mund te perfihet nga Abissnet per 890 lek ne muaj me TVSH nga Abissnet (pa limit) si dhe nga Albtelecom nepermjet paketes Familjare (telefoni dhe Internet) per 700 lek/muja dhe me 1 GB limit.

Paketa te integruara Internet dhe telefoni

FIGURA IV.13: KRAHASIMI I TARIFAVE MUJORE TE AKSESIT BROADBAND (TELEFONI DHE INTERNET)






FIGURA IV.14: KRAHASIMI I TARIFAVE MUJORE TE AKSESIT BROADBAND (TELEFONI, INTERNET DHE TV)



Nga krahasimi i tarifave te mesiperme te axhustuara per fuqine blerese vihet re se tarifat per sherbime te integruara (me 2 dhe 3 sherbime) te Albtelecom jane te krahasueshme me nivelin mesatar te BE.

IV.3.3 Tarifat e telefonise celulare

Tregues të tarifave celulare apo të shpenzimeve të përdoruesve celularë përfshijnë treguesit e ARPU⁸ dhe ARPM⁹, që masin të ardhurën mesatare të operatorëve (shpenzimin mesatar të përdoruesve) për përdorues dhe për minutë. ARPM apo e ardhura mesatare për minutë tregon cmimin që një përdorues celular paguan mesatarisht për një minutë thirrje telefonike, ndërsa ARPU tregon sa lek shpenzon mesatarisht një përdorues celular për shërbime celulare në vit apo në muaj. Vlerat e këtyre treguesve për periudhën 2010-2015 janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

⁸ARPU (Average Revenue Per Users-E Ardhura Mesatare Për Përdorues): E ardhura mesatare për përdorues e matur si raporti i të ardhurave në retail të operatorëve me numrin mesatar të përdoruesve (aktivë) gjatë një viti.

⁹ARPM (Average Revenue Per Minute-E Ardhura Mesatare Për Minutë): Treguesi i ARPM llogaritet nga AKEP në bazë të të dhënave që dërgojnë operatorët për të ardhurat dhe thirrjet telefonike. Për shkak të ofertave/shportave që kanë një pagesë fikse dhe përfshijnë përveç thirrjeve edhe SMS dhe kapacitet Internet, vlerat e këtij treguesi mund të mos pasqyrojnë saktë të ardhurën mesatare retail për një minutë thirrje, megjithatë ai është një tregues i përafërt dhe mund të konsiderohet vlera maksimale kur si të ardhura përdoren të ardhurat totale retail

TABELA IV.11 ECURIA E ARPM DHE ARPU 2010-2014


| | ARPM (Lekë/minutë) | ARPU (Lekë/vit) | ARPM Ndryshimi vjetor (%) | ARPU Ndryshimi Vjetor (%) |
|------|-----------------------|--------------------|------------------------------|------------------------------|
| 2010 | 6.49 | 8,594 | | |
| 2011 | 5.35 | 8,319 | -18% | -3% |
| 2012 | 3.92 | 7,132 | -27% | -14% |
| 2013 | 3.13 | 5,863 | -20% | -18% |
| 2014 | 2.63 | 5,447 | -16% | -7% |
| 2015 | 2.36 | 5,125 | -10% | -6% |

Shënim: Vlerat pa TVSH

Nga tabela vihet re se ARPM dhe ARPU kanë tendencë rënëse dhe për vitin 2015 vlerat e tyre janë reduktuar me 10% dhe 6% respektivisht. Në vitin 2015 një përdorues celular ka paguar mesatarisht 2.83 lekë/minutë (me TVSH) për thirrjet telefonike dhe ka shpenzuar mesatarisht 512 lekë/muaj (me TVSH) për shërbime celulare (182 minuta thirrje dalese dhe 39 SMS).

Niveli i këtyre treguesve në Shqipëri është shumë më i ulët se niveli mesatar në vendet e BE dhe ndër më të ulët në rajon. ARPM për Shqipërinë ishte në nivelin 1.9 eurocent në 2014. Nga krahasimi duket se Shqipëria ka ARPM të njëjtë me vlerat më të ulëtat të ARPM në vendet e BE në 2011, Lituania me 1.9 eurocent dhe Rumania me 2.2 eurocent. Ndërkohë mesatarja e BE në 2011 ishte 9.1 eurocent, apo rreth 5 herë më e lartë se ARPM e Shqipërisë në 2014.

FIGURE IV.15 ARPM NË VENDET E BE DHE SHQIPERI (2011/2014)




Burimi: KE, Digital Agenda Scoreboard dhe AKEP

ARPU tregon tendencë të ngjashme me ARPM, të vendeve të BE me njëra-tjetrën dhe të Shqipërisë në krahasim me vendet e BE. ARPU në vitin 2014 në Shqipëri ishte 39 euro/vit, që është 17% më e ulët se Latvia me nivelin më të ulët në BE me 47 euro. Niveli mesatar i

ARPU në BE në 2013 ishte 168 euro apo rreth 4.3 herë më e lartë se ARPU e Shqipërisë në 2014.

FIGURE IV.16: ARPU NË VENDET E BE DHE SHQIPËRI (2013/2014)



Burimi: KE, Digital Agenda Scoreboard dhe AKEP

AKEP nëpërmjet procesit të analizës së tregut në vitin 2014, vendosi nder të tjera detyrime për katër operatorët celularë për mos-diskriminim në tarifën me pakicë brenda rrjetit (on-net) dhe drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare (off-net). Këto detyrime filluan të implementohen me datë 1.07.2015 dhe zbatimi i tyre ka sjellë ndryshime të rëndësishme në planet tarifore të operatorëve celularë:

- përfshirjen e sasive të barabarta të minutave brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve celulare apo të thirrjeve brenda dhe jashtë rrjetit (pa dallim destinacioni) në pagesat fikse të planeve tarifore me kontratë dhe me parapagim,
- reduktim të ndjeshëm të numrit të ofertave të përkohshme promovionale dhe rritje të numrit të paketave standarde me përfitime më të mëdha për përdoruesit celularë.

Këto ndryshime nga të katër operatorët celularë kanë çuar në rritje të përfitimeve të përdoruesve fundorë, pasi sasia e minutave të përfshira në pagesat fikse është e mjaftueshme dhe duke filluar nga pagesa shumë të ulëta fikse. Ofertat/paketat tarifore mund të mos kenë më thirrje ‘pa limit’ brenda rrjetit/grupit, por ato kanë sasi të konsiderueshme thirrjesh (qindra deri në mijëra minuta brenda dhe jashtë rrjetit) sa që praktikisht në shumë raste mund të konsiderohen pa limit. Pra përdoruesit celularë me të njëjtën kosto (pagesë) kanë përfituar sasi të konsiderueshme thirrjesh jashtë rrjetit celular (drejt rrjeteve të tjera celulare). Efektet e këtyre ndryshimeve janë vënë re në sasinë e thirrjeve dhe strukturën e thirrjeve të përdoruesve të katër operatorëve celularë.

IV.3.4 Tarifat e aksesit broadband nga rrjetet celulare

Konsolidimi i rrjeteve 3G dhe fillimi i ofrimit të shërbimeve në rrjetet celulare 4G ka çuar në rritje të ndjeshme të përdorimit të aksesit në Internet nga rrjete celulare. Ofrimi i aksesit në Internet në rrjet celulare mund të përfitohet nepermjet paketave të perbashketa me shërbimet standarde telefonike ose nepermjet paketave të vecanta për të dhëna. Programet tarifore të këtyre operatorëve celulare tregojnë se shumica e paketave janë të integruara: telefoni/SMS dhe akses në Internet 3G/4G. Këto paketa janë të shumëllojshme dhe mund të blihen nga përdoruesit me parapagim për konsum ditor, javor apo 4-javor/Mujor. Tabelat e mëposhteme paraqesin disa nga paketat tarifore standarde të operatorëve për konsum ditor dhe 28/30 ditor për shërbime të integruara (telefoni dhe Internet) dhe paketa ditore, javore dhe 4 javore/mujore për paketa të vecanta Interneti për parapagim nga aparate celulare. Paketat ilat janë lehtësisht të krahasueshme në bazë të cmimit dhe njesive të konsumit të përfshira në paketa.

TABELA IV.12 SHEMBUJ TË PAKETA STANDARTE DITORE (TELEFONI+INTERNET)

| | Albtelecom | Telekom Albania | Vodafone |
|------------------------------------|---------------|-----------------|---------------|
| | Paketa Ditore | Paketa Ditore | Club Ditore |
| Ditë - përdorimi | 1 | 1 | 1 |
| Cmimi (leke) | 100 | 70 | 70 |
| Minuta drejt rrjetit fiks kombëtar | 100 | - | - |
| Minuta kombëtare | 100 | 100 | 100 |
| SMS brenda rrjetit | - | 100 | 100 |
| SMS kombëtare | 100 | - | - |
| Volumi Internet | 250 MB | 100 MB | 100 MB |

TABELA IV.13. SHEMBUJ TË PAKETAVE STANDARTE 28/30 DITORE (TELEFONI+INTERNET)

| | Albtelecom | | Plus | Telekom Albania | Vodafone |
|---------------------------|-------------|-------------|-------------|-----------------|-------------|
| | Kupid | Mujore 800 | Plus 800 | Vitamina | Club Xtreme |
| Ditë - përdorimi | 28 | 28 | 30 | 28 | 28 |
| Cmimi (leke) | 800 | 800 | 800 | 790 | 800 |
| Minuta on-net | - | 300 | - | 150 | - |
| Minuta off-net | - | 300 | - | 150 | - |
| Minuta drejt rrjetit fiks | 1000 | 1000 | - | - | - |
| Minuta kombëtare | 200 | - | 500 | - | 200 |
| Minuta nderkombëtare | - | - | 20 | - | - |
| SMS on-net | - | - | 600 | - | - |
| SMS kombëtare | 400 | 200 | 200 | 150 | 200 |
| Volumi Internet | 4 GB | 1 GB | 3 GB | 3 GB | 3 GB |

Tabela të tilla krahasimore janë të publikuara në faqen web të AKEP, ku publikohet periodikisht informacion krahasues për tarifën e operatorëve celulare, dhe siç është theksuar më sipër, tashmë është shumë më e lehtë krahasimi i tarifave midis operatorëve.

TABELA IV.14. SHEMBUJ TË PAKETAVE AKSES NË INTERNET ME PARAPAGIM NGA APARATE CELULARE

| | Paketa Ditore | | Paketa Javore | | Paketa Mujore* | |
|-------------------|----------------------------|-----------------------------------|----------------------------|-----------------------------------|----------------------------|-----------------------------------|
| | Tarifa (Lek me TVSH) | Volumi i Internetit (MB/GB) | Tarifa (Lek me TVSH) | Volumi i Internetit (MB/GB) | Tarifa (Lek me TVSH) | Volumi i Internetit (MB/GB) |
| Vodafone | 60 | 100 MB | 300 | 1GB | 550 | 1GB |
| T-Albania | 60 | 100 MB | 300 | 500 MB | 500 | 1 GB |
| Albtelecom | 100 | 1 GB | 300 | 1 GB | 400 | 2 GB |
| Plus | 60 | 150 MB | 200 | 500 MB | 300 | 1 GB |

*Vlefshmeria e paketave te Vodafone dhe Telekom Albania eshte 28 dite, ndersa per Albtelecom dhe Plus 30 dite

Nga sa me siper si dhe paketa/oferta te tjera te disponueshme nga operatorët celularë vihet re se se perdoruesit me parapagim celularë (qe perbejne mbi 93% te perdoruesve te sherbimeve celularë ne Shqiperi) kane mundesi zgjedhjeje per te perfituar aksesin ne Internet celular se bashku me sherbime telefonike/apo si sherbime me vehte duke filluar nga 60 lek/dite dhe 300/400 lek/muaj, dhe me kapacitete download te mjaftueshme per akses funksional ne Internet. Tendencat e tregut celular ne Shqiperi per perdoruesit me parapagim ku paketat (bundles-telefoni dhe Internet dhe/ose Internet only) jane shume me te lira se pay-as-you-go duken te ngjashme me tendencat boterore te ketyre sherbimeve.

AKEP ne analizen e tregut celular 2016 (Keshillim Publik) ka evidentuar diferencen e madhe midis tarifave te shportave celularë (bundles-telefoni dhe Internet dhe/ose Internet only) dhe tarifave standarde te Internetit celular (tarifim sipas konsumit KB/MB), ku keto te fundit jane shume te larta dhe mund te rezultojne ne probleme me perballueshmerine dhe mbrojtjen e peroduesit fundor. Gjithsesi nga te dhenat e vitit 2016 dhe praktikat e MNO-ve ne Shqiperi vihet re se:

- MNO reklamojne Internet 'pa limit' ne shume paketa por me shenimin se pas konsumit te X MB/GB (pra tarifim standard pay as you go) shpejtesia e aksesit ne Internet celular reduktohet ndjeshme ne 128-256 Kbps, dhe kjo redukton ndjeshem efektin negative te tarifave te larta standard te internetit celular;
- Sasia e te dhenave (data) te Internetit celular te tarifuar me tarifat standard ne 2016 eshte vetem +++%, cka perben nje tregues se tarifimi standard pay as you go per aksesin ne Internet celular eshte praktike shume e kufizuar ne rrjetet celularë.
- Tendencat e tregut Shqiptar per menyren e tarifimit per aksesin broandand celular (paketa, limit ne download he shpejtesi) jane te ngjashme me vendet e BE dhe me gjere, dhe tarifat ne Shqiperi.
- Pavaresisht vonesave ne fillimin e ofrimit te sherbimeve 3G/4G ne Shqiperi (te pavaruara nga MNO ne Shqiperi), ne vetem disa vite perdorimi i ketyre sherbime ka njohur rritje te ndjeshme dhe tarifat jane shume konkurruese dhe te perballueshme (shiko seskionin me poshte dhe raportin e ITU).

IV.3.5 Perballueshmeria e tarifave

Nje burim i mire per krahasimin e tarifave për shërbimet e telefonisë fikse dhe celulare dhe aksesit broadband nga rrjet fiks dhe celular dhe perballueshmeries se tyre jane raportet periodike te ITU *Measuring the Information Society Report*. Keto raporte permbajne te dhena per zhvillimin e ICT, duke perdorur nder te tjera tregues te numrit te perdoruesve te sherbimeve te telefonise dhe aksesit broadband (rrjete fikse dhe celulare) dhe perballueshmërisë së çmimeve te ketyre sherbimeve, duke bere dhe renditje ne baze te indekseve te llogarituar nga ITU. Ne dokumentin e nxjerre ne keshillim public, AKEP publikoi te dhenat e raportit te vitit 2015 te ITU si dhe nje vleresim te AKEP per ecurine e ketyre treguesve ne vitin 2016. Gjate kesaj periudhe ITU ka publikuar raportin e vitit 2016, dhe AKEP me poshte ka perfshire te dhena dhe informacion nga ky raport ne lidhje me Shqiperine.

TABELA IV.15. RENDITJA E SHQIPËRISË PËR INDEKSIN E CMIMEVE TË ICT NE RAPORTET ITU 2015-2016¹⁰

| | Renditja 2014 | | Renditja 2015 | |
|-------------------|---------------|--------------|---------------|----------|
| | % GNI | Renditja ITU | % GNI | Renditja |
| IPB ¹¹ | 3.9 | 106 | N/A | N/A |
| Telefoni Fikse | 1.77 | 91 | N/A | N/A |
| Broadband Fiks | 1.77 | 58 | 2.57 | 83 |
| Telefoni celulare | 8.03 | 138 | 1.71 | 84 |
| Broadband celular | 1.26-2.53 | 58-79 | 1.18 | 63-74 |

Ne raportin e vitit 2015 Shqipëria renditej ne vende të mira përse i përket tarifave të aksesit broadband por në vende më të ulëta për telefoninë, sidomos telefoninë celulare. Situata ka ndryshuar ne vitin 2015 per telefonine celulare per shkak te ndryshimit te metodologjise se ITU ne raportin 2016 dhe ndryshimeve te tarifave te operatoreve celulare ne 2015 ne Shqiperi pas fillimit te zbatimit te detyrimeve per mos-diskriminimin ne tarifat e thirrjeve on-net/off-net dhe masave te tjera rregulluese per ofertat/promocionet e operatoreve celulare. Ne raportin 2016 ITU nuk ka matur indeksin total IPB si dhe nuk ka perfshire te dhena per tarifat e telefonise fikse.

Për raportin e vitit 2015 per telefoninë fikse është përdorur paketa Familjare e Albtelecom (700 lek/muaj me TVSH) dhe Shqipëria renditet në vendin 91. Për Shqipërinë, shpenzimet për këtë nën-shportë të shprehura në USD janë më të ulëtat në rajon, megjithatë sipas peshës ndaj GNI për frymë Shqipëria renditet pas Kroacisë, Malit të Zi dhe Serbisë në rajon, për shkak të GNI p.c më të ulët në rajon. Per aksesin broadband nga rrjete fikse per vitin 2015 eshte perdorur paketa Familjare e Albtelecom (700 lek/muaj) e cila perfshin dhe akses broadband 1 Mbps dhe Shqiperia renditej ne vendin 58, ndersa per raportin e vitt 2016 eshte perdorur paketa ADSL me shpejtesi 2 Mbps dhe 4GB limit (1199 lek/muaj me TVSH), dhe

¹⁰ Raportet i referohen te dhenave te nje viti me pare.

¹¹ IPB (ICT Price Basket) matet si mesatarja e peshave ndaj GNI të telefonisë fikse, broadband fiks dhe telefoni celulare. Shpenzimet për çdo shportë maten sipas metodologjise së ITU. GNI për frymë për Shqipërinë në 2014 ishte 4505USD ndersa per 2015 eshte 4450USD. Renditja kryhet sipas % ndaj GNI nga vlera më ulët në më të madhen për rreth 180 vende.

Shqipëria ka rënë në renditje në vendin 83. Gjithsesi paketa Familjare e ALbtelecom është ende e disponueshme dhe aksesit broadband me shpejtësi 1 Mbps është pjesë e kësaj pakete me çmim 800 lek/muaj me TVSH.

Për telefoninë celulare, megjithëse tarifat efektive të paguara nga përdoruesit edhe në vitin 2014 ishin shumë të lira (ARPM dhe ARPU më të ulëta në Evropë), Shqipëria në raportin e ITU 2015 renditej në vende shumë të ulëta (138) për shkak se metodologjia e ITU merrte në konsideratë vetëm tarifat standarde të thirrjeve (pay as you go) për përdoruesit me parapagim. Shpenzimet e llogaritura nga ITU për këtë nën-shportë (rreth 50 minuta kombëtare dhe 100 SMS kombëtare në muaj) me tarifat standarde të Vodafone Albania për paketën Vodafone Club, ishin në nivelin 30USD dhe 8% e GNI për frymë në 2014. ITU në raportin e vitit 2016, ka marrë në konsideratë tendencën tashme globale të ofrimit të paketave bundle me parapagim për përdoruesit celulare dhe bazuar dhe në ndryshimet e tarifave të ndodhura gjatë vitit 2015 në Shqipëri,¹² renditja e Shqipërisë për nën-shporten celulare është përmirësuar ndjeshëm duke arritur në vendin 84 nga vendi 138 një vit më parë. Shpenzimet mesatare për frymë tashme zënë 1.71% të të ardhurave mesatare për frymë (GNI) dhe ky nivel konsiderohet i përballueshëm dhe përmirësimi i renditjes së Shqipërisë për shkak të paketave bundle celulare është cituar edhe nga ITU në raportin e vitit 2016.¹³ Pozicioni i mirë i Shqipërisë për shërbimet celulare konfirmohet edhe nga renditja e vendeve sipas përdorimit mesatar të thirrjeve celulare, ku Shqipëria me 166 minuta thirrje/muaj për përdorues renditet në vendin e 26-të nga rreth 190 vende.

Për shpenzimet për aksesin broadband nga rrjetet celulare (me parapagim nga aparate celulare dhe paspagim me USB) renditja e Shqipërisë nuk ka ndryshime të ndjeshme dhe në raportin e vitit 2016 është në pozicione të mira në vende 63-74. Raporti i ITU i konsideron tarifat e aksesit broadband nga rrjetet celulare në Shqipëri në nivel të përballueshëm (1.18% të GNI) për shkak të nivelit të ulët të tyre¹⁴.

ITU në raportin 2016 i ka kushtuar një vend të veçantë Shqipërisë (Kutia 2.7 në Raportin 2016) për zhvillimet positive në komunikimet elektronike në vitet e fundit, ku ndër të tjera vihet në dukje:

- Shqipëria renditet e 91^{ta} në IDI për vitin 2016 dhe ka një përmirësim të vlerës së saj nga 4.62 pikë për vitin 2015 në 4.92 pikë për 2016.

¹² Prepaid packages with a significantly lower cost than pay-per-use plans are driving down prices in developed countries such as Albania, Bulgaria, Croatia, Greece, Italy, Latvia, New Zealand, Romania, the Russian Federation, Slovenia and Sweden.

¹³ When the GNI p.c. of each country is taken into account in order to assess the affordability of mobile-cellular services, the average price in terms of GNI p.c. in Europe is the lowest of all regions. Most European countries have mobile-cellular prices corresponding to less than 1 per cent of GNI p.c., and all of them are below the 5 per cent of GNI p.c. threshold. Albania and Bulgaria were the last European countries to reach this milestone thanks to the price reductions achieved through prepaid bundled packages.

¹⁴ Mobile-broadband services are affordable in Europe not only because of the high income levels in the region, but also because of the low price of the service. Indeed, in countries such as Estonia, Lithuania, Poland, Serbia and Albania prepaid mobile-broadband plans were offered at prices below USD 4 per month in 2015.

- Progresi më i rëndësishëm në vend është bërë në aksesin e internetit dhe rritjen e familjeve me një kompjuter nga 4.9% në vitin 2006 në 25.7% në vitin 2015. Shkalla e penetrimit fiks-broadband ka pësuar një rritje të lehtë nga 6.5% në vitin 2014 në 7.6% në vitin 2015.
- Shpenzimet per shportën e aksesit broadband fiks kane rënë nga 29.79 USD në muaj për vitin 2008, në 9.52 USD për vitin 2015.
- Shpenzimet per shportën e aksesit broadband celular kane pësuar ulje nga 32.13 USD në vitin 2008 në vetëm 6.35 USD në vitin 2015. Ulje te ketyre shpenzimeve jane vene re edhe në periudhën 2012 – 2015.
- Rritja e penetrimit të mobile-broadband, nga 30.9% në vitin 2014 në 40.6% në vitin 2015, është ndikuar nga hedhja në treg e shërbimeve LTE dhe LTE-A, te mundesuar nga ndryshimet ligjore/rregullatore te AKEP per procesin e re-farming te spektrit te frekuancave për shërbimet LTE.
- Zhvillimi i shpejte i rrjeteve LTE ka cuar ne dyfishim te trafikut te te dhenave ne rrjetet celulare.

Duke marre ne konsiderate tarifat aktuale te shportave te integruara (telefoni/SMS dhe Internet) ne rrjetet celulare per perdoruesit me parapagim rezulton se me 800-1000 lek/muaj (me TVSH) nje perdorues mund te perfitoje rreth 2000 minuta kombetare, qindra SMS dhe 1-2 GB Internet 3G/4G. Ky nivel konsumi është shumë më i lartë se konsumi i referuar nga ITU si benchmark për krahasimin midis vendeve për përballueshmërinë e tarifave. Ne terma të përballueshmerisë **shpenzimi 800-1000 lek/muaj për akses në telefoni dhe Internet celular është 1.75-2.15% e GNI për fryme të Shqipërisë ne 2014 (4505 USD).**

Për nivelin mesatar të të ardhurave, ky nivel shpenzimesh (per konsumin e cituar) vlerësohet te jete i perballueshem.

V. Rishikimi i objektit te SHU

- Perfundim per anen e ofertes per SHU

Nga analiza e kryer ne kapitujt e mesiperm ne lidhje me anen e ofertes se sherbimeve, AKEP arrin ne perfundimin se:

- Aksesit ne sherbimet e telefonise nga vendndodhje fikse nepermjet rrjeteve fikse ka ardhur ne renie, ne terma te numrit te perdoruesve si dhe te perdorimit mesatar te thirrjeve telefonike. Kjo renie nuk rezulton te kete ardhur per shkak te tarifave, pasi ato konsiderohen te perballueshme, apo te zvogelimit te zonave te mbulimit me rrjete fikse, pasi ato gjykohet te jene rritur (rritje e qendrueshme e aksesit broadband nga rrjete fikse). Renia rezulton te jete rezultat kryesisht i efektit te zevendesimit me akses dhe perdorim te rrjeteve celulare. Ky efekt zevendesimi eshte evidentuar dhe analizuar ne menyre me te detajuar ne Analizen e tregut te telefonise fikse ne vitin 2015 nga AKEP.
- Aksesit broadband nga rrjete fikse eshte zhvilluar me ritme te kenaqshme dhe eshte shoqeruar me rritje te zonave te mbulimit, shpejtesise se aksesit broadband dhe prezantimin e sherbimeve te reja si IPTV, e cila vleresohet te jete shtytesi kryesor i rritjes se aksesit broadband ne vitin 2015 dhe pritet te vijoje kete ndikim edhe ne vitet ne vijim.
- Sherbimet nga rrjetet celulare kane pasur zhvillim te qendrueshem dhe investimet ne rrjetet 3G/4G kane rritur ndjeshem perdorimin e aksesit ne Internet nga rrjetet celulare si ne terma te numrit te perdoruesve dhe ne terma te perdorimit mesatar te te dhenave. Megjithese mbulimi me rrjet GSM eshte ne nivele shume te mira, sic eshte konkluduar edhe ne vitin 2012, mbulimi me sinjal rrjeti celular 3G/4G per te mundesuar akses broadband ne zona me popullsi te vogel dhe pa interes komercial ka nevojte te permiresohet, dhe AKEP ka marre tashme masa ne bashkepunim me operatoret celulare per permiresimin e mbulimit dhe cilesise se sinjalit ne zona te caktuara gjeografike, nga secili operator dhe/ose ne bashkepunim me njeri tjetrin.
- Bazuar ne pervojat nderkombetare, rritja e mbulimit dhe cilesise se sherbimeve te aksesit broadband (4G) celular permiresohet ndjeshem me perdorimin e brezit 800 MHz (sidomos ne zona rurale) dhe venia ne dispozicion e ketij brezi per MNO-te ne Shqiperi vleresohet se do kete impact shume pozitiv per permiresimin e ketij sherbimi.
- Tarifate e sherbimeve telefonike dhe aksesit broadband ne Internet nga rrjete fikse dhe rrjete celulare jane ne nivel te perballueshem per familjet me nivel mesatar te te ardhurave, madje ka dhe oferta/plane tarifore me tarifa shume te uleta qe jane te arsyeshme edhe per familjet me te ardhura te uleta.

Per sa me siper rezulton se ne anen e ofertes, operatoret celulare dhe fikse ofrojne shume mundesi zgjedhjeje per shume kategori te perdoruesve: me perdorim te ulet deri ne perdorim te larte, me menyra pagese me parapagim dhe me paspagim, me shpejtesi te uleta dhe te larta, etj. Mbi 93% e perdoruesve te sherbimeve celulare jane ne paketa tarifore me parapagim, duke krijuar mundesine e kontrollit te shpenzimeve midis te tjerave. Kjo metode pagese me parapagim aktualisht ofrohet edhe nga disa prej operatorëve kryesore te rrjeteve fikse, qe tradicionalisht ofrojne sherbime me paspagim. Tarifate per paketa te ndryshme te sherbimeve te telefonise dhe aksesit ne Internet (rrjete fikse dhe sidomos celulare) me parapagim dhe me paspagim rezultojne te jene te arsyeshme dhe te perballueshme, dhe kjo vihet re dhe ne raportet e insitucioneve nderkombetare.

- **Ana e kerkeses (Pajisjet fundore)**

Nje element i rendesishem ne perdorimin e sherbimeve te komunikimeve elektronike eshte edhe pajisja fundore: aparat telefonik (fikse dhe/ose celular) per thirrjet telefonike dhe Komjuter (PC ose laptop) per aksesin ne Internet. Per aksesin ne rrjetet e telefonise fikse dhe/ose celulare cmimet e aparateve telefonike gjykohet se jane te jane te perballueshme. Nderkohe per aksesin ne Internet, pajisja baze eshte nje kompjuter (PC ose laptop) dhe me zhvillimet e fundit mund te konsiderohen edhe tabletat dhe aparate celulare smart. Cmimet e ketyre aparateve perbejne nje kosto te konsiderueshme per shtresat e popullsisë me te ardhura te uleta. Megjithese sherbimi i aksesit ne Internet (fiks dhe celular) mund te jete i perballueshem, kostot e larta te aparateve fundore per perdorimin e ketij sherbimi (qe nuk varen nga oferta e sherbimit) per shtresat e popullsisë me te ardhura te uleta cojne ne perdorim me te ulet te sherbimit. Megjithe zhvillimet positive ne rrjetet dhe sherbimet celulare, ofrimi i aparateve celulare smart si pjese e paketave te sherbimeve celulare ne Shqiperi eshte ende shume prapa vendeve te tjera te BE dhe rajonit madje, ku operatoret celulare ofrojne aparate te tilla me skonto te konsiderueshme per perdoruesit me kontrate (pjese e pageses mujore). Kjo mungese ne anen e ofertes per aparate smart (oferta te arsyeshme dhe te krahasueshme te pakten me rajonin) nga operatoret celulare ne Shqiperi faktikisht rezulton se eshte e lidhur me strukturen e perdorueseve celulare (mbi 90% me parapagim) si dhe me riskun e mospagimit dhe krijimin e borxheve te keqija nga perdoruesit me kontrate, e varur dhe nga shume faktore ekzogjene (jashte kontrollit nga operatoret celulare).

Si edhe ne dokumentin e nxjerre ne keshillim public, AKEP vlereson se krahas masave ne anen e ofertes per promovimin e aksesit broadband, eshte e nevojshme marrja e masave nga ana e kerkeses, per gjetjen e alternativave per pajisje me aparate fundore te pershtatshme per perdorimin e aksesit ne Internet te shtresave te popullsisë me te ardhura te uleta. Pajisja e kesaj shtrese te shoqerise me lap top ose tablet do te conte ne nje rritje te kerkeses per akses broadband nga rrjete fikse dhe celulare, e cila e shoqeruar me ofertat e perballueshme per kete sherbim nga operatoret e rrjeteve fikse dhe celulare do te conte ne nje rritje me te madhe te perdorimit te aksesit broadband dhe gjithë perfitimeve te tjera te njohura tashme ekonomike dhe sociale te perdorimit te Internetit. Masa të tilla mund të merren nga Qeveria, por edhe vet operatorët celularë mund të ndikojnë pozitivisht në këtë drejtim nëpërmjet ofrimit të aparatave celulare smart në paketat tarifore me pagesa të arsyeshme mujore, sic është edhe praktika në shumë vende evropiane, përfshirë vendet e rajonit.

- **Financimi i SHU**

Sic eshte theksuar me larte, AKEP vlereson se sherbimet e SHU ofrohen ne menyre komerciale nga operatoret ne treg, dhe nuk ka nevoje per krijim fondi te SHU dhe perdorim te tij. Krijimi i fondit mund te jete i nevojshem ne rastin e masave ne anen e kerkeses, per financimin e blerjes se aparatave terminale (lap top/tablet) per familjet me te ardhura te uleta. Gjithsesi kjo mase e mundshem do kete nevoje per keshillim te vecante me te gjitha palet e interesuara.

- **Dividenti dixhital (800 MHz) dhe rrjetet 5G**

KE po leviz me shpejtesi drejt shoqerise Gigabit duke i kushtuar nje rendesi procesit te zhvillimit te rrjeteve celulare 5G ne propozimin per rishikimin e kuadrit rregullator te komunikimeve elektronike. Plani i propozuar i veprimit te KE per 5G, parashikon qe brezi 700 MHz te jete i disponueshem per operatoret celulare ne vitin 2020.

Shqiperia eshte shume prapa ne kete process, pasi ende nuk eshte liruar brezi 800 MHz per rrjetet 4G. Ky brez eshte shume i rendesishem per operatoret celulare per rritjen e zonave te mbulimit, por njekohesisht ajo merr rendesi te vecante per SHU. Brezi 800 MHz do te mundesonte operatoret celulare mbulimin ne zonat rurale, pra dhe ne ofrimin e SHU per ketop zona qe nuk mund te mbulohej me rrjete fikse. Pra eshte shume e rendesishme qe procesi i lirimit te brezit 800 MHz per t'u alokuar operatoreve celulare te pershpejtohet, psi kjo do te rrise ne menyre te ndjeshme mbulimin e zonave rurale dhe konektivitetin e tyre me Internetin, duke kontribuar ne universalizimin e aksesit ne Internet edhe per keto zona ne Shqiperi.

Procesi per lirimin brezit 800 MHz rezulton se ka filluar dhe pritshmerite jane qe ne periudhe afatshkurter-afatmesme operatoret celulare te fillojne ofrimin e sherbimeve 4G edhe ne kete brez.

- **Analizat e tregut**

AKEP do te vijoje marrjen e masave rregulluese per tregjet qe kane nevojte per nderhyrje ex-ante, duke u fokusuar ne sherbimet e aksesit broadband. AKEP ka nxjerre se fundi Anlizen e tregut broadband per keshillim public. Masat rregullatore te AKEP, te ndermarra apo qe do ndermerren, fokusohen ne rritjen e konkurrences ne treg dhe stimulimin e investimeve ne rrjetet broadband, me objektivin e rritjes se perfitimeve te perdoruesit fundore. Keto masa kontribujne ne rritjen e pedorimit te sherbimeve te komunikimeve elektronike, pra dhe ne ofrimin e SHU. Metoda e preferuar do jete mundisimi i ofrimit te SHU nga vet tregu dhe me pas nese ka nevojte per caktimi i nje apo disa ofruesve te SHU.

- **Mbulimi i zonave/disponibiliteti gjeografik**

Sic eshte theksuar me lart, AKEP vlereson se edhe rrjetet fikse dhe rrjetet e tjera pa tela (celulare) te jene pjese e ofrimit te SHU. Ne vijim te perfundimeve te Planit Kuader te SHU 2013-2016, si dhe te procesit te koordinimit me tre operatoret me te medhenj celulare ne vitin 2015 per mbulimin me sinjal rrjeti GSM/UMTS te disa zonave te largeta si dhe per permiresimin e cilësisë së shërbimit të ofruar me rrjet UMTS në disa zona me densitet të ulët të popullsisë, AKEP vlereson te vazhdoje kete proces stimulimit te bashkinvestimeve dhe permiresimit te mbulimit dhe cilesise me sinjal te rrjeteve celulare, jashte skemes se SHU. Ne ndryshim nga plani kuader i SHU 2013-2016 ku fokusi ishte mbulimi dhe sinjali me rrjet GSM, ne vitet ne vijim **AKEP vlereson se fokusi kryesor duhet te jete permiresimi i mbulimit dhe sinjalit per rrjetet 3G/4G qe mundesojne aksesin broadband nga rrjete celulare.**

- **Perfundim per objektin e SHU (aksesi broadband)**

Nje nga qellimet kryesore te AKEP ne nxjerrjen ne keshillim public te dokumentit per SHU ishte marrja e opinioneneve te paleve te interesuara nese ne vitin 2016 e ne vijim, a vleresohet e arsyeshme ose jo perfshirja e aksesit broadband ne Internet ne fushen e SHU?

Perfshirja e aksesit broadband ne Internet (rrjete celulare dhe fikse) ne objektin e SHU, do te thote universalizimi i ketij sherbimi, pra cdo person/familje ne RSH te kete mundesine qe pavaresisht vendodhjes gjeografike dhe nivelit te fuqise blerese, te kete mundesine per akses ne Internet me tarifa te perballueshme dhe me cilesi si pjesa mbizoteruese e perdoruesve aktuale te ketij sherbimi. Pra universalizimi aksesit broadband ne Internet do te thote qe ne kushtet kur ky sherbim perdoret nga shumica dermuese e popullsisë/familjeve dhe per qellime te interesave publike dhe mos-perjashtimit grupeve te caktuara vulnerabel te shoqerise dhe/ose qe jetojane ne zona te largeta, nga institucionet shtetore te ndermerren masa qe edhe keto grupe te kene mundesine e aksesit ne keto sherbime. Ne dokumentin e nxjerre ne keshillim public AKEP propozoi per perfshirjen e ketij elementi ne fushen e SHU, per shkak te zhvillimeve ne vitet e fundit ne komunikimet e elektronike, sidomos ne aksesin broadband nga rrjetet celulare.

Ne vijim te analizes se kryer ne 2012-2013 per SHU ne Shqiperi, zhvillimeve ne keto vite, pervesojes se implementimit te SHU ne vendet e BEREC, si dhe komenteve te paleve te ineteresuara per dokumentin e nxjerre ne keshillim public, AKEP vlereson se:

- Akesi nga vendndodhje fikse per SHU mund te realizohet nepermjet rrjeteve me tela dhe rrjeteve pa tela (pra perfshire rrjetet celulare dhe wifi).
- Objekti i SHU të përfshijë shërbimet e komunikimit zanor ndersa per aksesin broadband ne Internet AKEP te vijoje me masa te tjera promovuese te aksesit broadband jashte fushes se SHU, si nepermjet monitorimit te permiresimit te mbulimit dhe sinjalit nga rrjete celulare (3G dhe 4G) dhe proceseve te analizave te tregut. Promovimi ne anen e kerkeses rekomandohet te perqendrohet sidomos ne shtresat vulnerabel dhe ne subvencionim te mundshem te terminaleve per akses ne Internet (laptop ose tablet) per keto shtresa te popullsisë si edhe menyra e ndjekur per dixhitalizimin e sherbimeve te transmetimeve televizive (aparartet decoder falas per familjet qe perfitijne asistence sociale).
- Pavaresisht mbulimit te kufizuar me rrjete fikse, rritja e mbulimit me rrjete celulare 3G/4G dhe mbulimi i pothuajse te gjithë popullsisë me rrjete GSM, tregon se akese ne sherbime telefonike dhe madje dhe broadband ne Internet mund te perfitohet nga 99% e popullsisë dhe me tarifa te arsyeshme dhe te perballueshme te cilat ofrohen komercialisht nga operatorët e rrjeteve celulare dhe fikse, pa qene e nevojshme mandatimi i ketyre elementeve te SHU.
- Ne lidhje numeratorin dhe shërbimet DES te publikohet nje rregullore që të përcaktoje detyrimet e operatorëve për krijimin dhe perditimin e bazave te te dhenave per pajtimtaret që deshirojne te jene pjese e numeratorit gjithperfshires, rregullat per perdorimin e ketyre databazave nga pale te treat si dhe afate kohore per krijimin e tyre nga te gjithë operatorët.

AKEP vlereson se akese ne Internet tashme ka arritur zhvillime te ndjeshme, dhe akese ne rrjetet 3G/4G ka pasur zhvillim shume te madh, krahasuar me vleresimin qe AKEP kreu ne vitin 2012, ku rrjetet operatorët celulare sapo kishin filluar ofrimin e sherbimeve ne rrjete 3G, ndersa 4G ishte ende larg, dhe keto sherbime filluan te ofrohen vetem ne vitin 2015.

Njekohesisht edhe aksesit ne rrjetet fikse ka pasur permiresim te dukshem ne krahasim me vitin 2012, si ne terma te numrit te pajtimtareve dhe ne cilesi, zona mbulimi dhe inovacion. Megjithate Shqiperia eshte ende larg nivelit mesatar te BE te perdorimit te aksesit broadband nga rrjete fikse si dhe megjithe permiresimin e aksesit broadband ne rrjete celulare 3G/4G, niveli i mbulimit dhe perdorimit eshte ende me i ulet se ne vendet e BE. AKEP duke marre ne konsiderate te gjitha faktoret e lidhur me SHU, vlereson se perfshirja e aksesit broadband si detyrim per SHU ne Shqiperi eshte e parakohshme, sidomos ne kushtet kur kjo aktualisht eshte kryer vetem ne pak vende te BE dhe e kufizuar per shtresa te caktuara te popullsisë. Ne vijim te perfundimeve te mesiperme AKEP vlereson se per periudhen ne vijim jane te nevojshme dhe rekomandohen masa si ne anen e ofertes dhe kerkeses:

- **Ne anen e ofertes**, AKEP krahas masave te tjera per promovimin e aksesit broadband dhe konkurrances ne kete treg, te vijoje me masat per rritjen e mbulimit te rrjeteve celulare 3G/4G dhe cilesise se ketyre sherbimeve nga MNO-te;
- **Ne anen e kerkeses** rekomandohen te gjenden alternativa per pajisjen me terminale (lap top/tablet) te familjeve me te ardhura te uleta, e cila do te rrise ndjeshem kerkesen per sherbimin e aksesit broadband dhe ICT ne teresi.

Bazuar ne analizen e kryer nepermjet ketij dokumenti, ku jane marre ne konsiderate zhvillimet e viteve te fundit ne tregun e komunikimeve elektronike ne Shqiperi, ne kuadrin rregullator te KE per SHU, pervojen e vendeve te BE/BEREC per SHU, dhe zhvillimet e pritshme per SHU, AKEP vlereson se perfshirja e aksesit broadband ne Internet (fikse dhe cellular) ne objektin e SHU eshte ende e parakohshme. Nderkohë aksesit funksional ne Internet (per sherbimet e cituara nga KE) eshte i plotësuar tashme nga vetë tregu nepermjet aksesit ne rrjetet 2G që kanë mbulim mbi 99.8% e popullsisë dhe 95% e territorit me rrjet celular, si dhe ne shumicen e territorit dhe shumica e popullsisë kanë akses edhe ne rrjete 3G/4G me shpejtësi shumë të lartë aksesit ne Internet. Per sherbimet e numeratorit dhe telefonave publikë me pagesë, AKEP ne vijim te propozimeve te fundit te KE, do te konsiderojë ne kohë te mevonshme nese ka nevojë te merren masa per ofrimin/permirësimin e këtyre sherbimeve që tashme konsiderohen nga KE si të vjetëruara (outdated).

Ne këto kushte fokusi kryesor ne anen e ofertes te sherbimeve dhe rrjeteve te komunikimeve elektronike per te garantuar SHU ne Shqiperi duhet te perqendrohet ne promovimin e aksesit broadband ne rrjete celulare dhe fikse, ndër të tjera nepermjet:

- Masave të ndermarra tashme me Vendimet nr. 2646, 2547 dhe 2548, date 03.12.2015 per permiresimin e mbulimit dhe cilesise se sinjalit me sherbime te rrjeteve 3G/4G dhe monitorimin e angazhimeve te MNO-ve per plotesimin e ketyre kushteve qe jane bere dhe pjese e AI te tyre, si dhe permiresimin e sinjalit ne zona te tjera problematike qe mund te evdntohen kohe pas kohe nga AKEP;
- Promovimit per permiresimin e mbulimit dhe cilesise se sinjalit me sherbime te rrjeteve 4G pas liritimit te brezit 800 MHz (dividenti dixhital);
- Masa promovuese te zhvillimit te mbulimit me rrjete fikse dhe konkurrances ne tregun me pakice te aksesit broadband.

Aneks 1: Komentet e keshillimit publik dhe qendrimi i AKEP

AKEP me VKD nr.2691, datë 13.10.2016 miratoi publikimin për këshillim publik të dokumentit “Statusi i Shërbimit Universal të komunikimeve elektronike”, proces ky i ndërmarrë edhe në kuadër të Vendimit të AKEP nr. 2324 dt. 28.06.2013 për miratimin e Planit Kuadër për SHU për vitin 2013-2016, për rishikimin e statusit të detyrimeve dhe përcaktimeve të elementëve të Shërbimit Universal gjatë vitit 2016. Periudha e këshillimit publik ka qënë 14.10.2016-30.11.2016. Në këtë dokument të publikuar në faqen zyrtare eëë.akep.al, AKEP kërkoi mendimin e palëve të interesuara për gjetjet dhe propozimet e SHU në Shqipëri. .

Albtelecom Telekom Albania Vodafone Albania, Plus Communication, dhe MIAP kanë depozituar komentet e tyre në formë shkresore. AKEP i falenderon të gjithë pjesëmarrsit për kontributet e dhëna gjatë këtij procesi të këshillimit publik.

Më poshtë AKEP ka dhënë përmbledhje të komenteve të operatorëve dhe qëndrimin e AKEP për këto komente.

1. A mendoni se janë pasqyruar drejt zhvillimet e aksesit broadband në rrjete fikse dhe celulare në Shqipëri?

Albtelecom

Sipas Albtelecom janë pasqyruar përgjithësisht qartë dhe në mënyrë të detajuar të dhënat në lidhje me zhvillimet e aksesit broadband në rrjete fikse dhe celulare në Shqipëri duke vënë në dukje trendin në rritje të përdoruesve të internetit broadband nga rrjete fikse nga viti 2011 e në vazhdim, duke arritur së fundmi të kalojnë dhe numrin e përdoruesve të telefonisë fikse. Duke qënë që interesi për përdorimin e telefonisë fikse është modest, gjithë fokusi i biznesit të operatorëve është drejt ofrimit të shërbimeve të internetit, vecanërisht paketave/bundle-ve me shërbime të integruara, .

Vetë Albtelecom, që prej vitit 2014, ka lancuar në treg paketat trefishe (triple-play) që ofrojnë shërbime telefonie, internet dhe TV të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e numrit të përdoruesve të internetit broadband dhe në ndryshimin e zgjedhjes së konsumatorit nga paketat dyfishe në paketat trefishe, duke cuar në uljen e kësaj kategorie përdoruesish (përdoruesve të paketave 2-fishe). Është pikërisht kjo zgjidhje e re teknologjike e ofruar nga Albtelecom (IPTV) që ka bërë të mundur mbajtjen e pjesës të tregut të tij konstante në 40% përsa i takon numrit të përdoruesve të aksesit broadband në tregun me pakicë, si dhe ka ndikuar në rritjen e përqindjes së pajtimtarëve që përdorin shpejtësi interneti 4 Mbps -10 Mbps.

Ndërkohë vërejmë se megjithë pasqyrimin e normës së penetrimit sipas rajoneve për Q4/2015, në seksionin (IV.1.2), mungon informacioni i përditësuar lidhur me ecurinë e penetrimit të internetit broadband për popullsi dhe për familje në vite, informacioni i cili do të shërbente për një pamje më të plotë dhe të qartë të zhvillimeve në këtë treg vit pas viti.

Përsa i takon zhvillimeve të aksesit broadband nga rrjetet celulare, mendojmë se informacioni i dhënë në seksionin IV.2.2 Aksesit broadband në rrjete celulare 3G/4G lidhur me numrin e pajtimtarëve aktivë në vite, normën e penetrimit për vitet 2014-2015/Q4, si dhe mbi mbulimin dhe treguesit e shpejtësisë së aksesit broadband në rrjete celulare pasqyrojnë përgjithësisht drejt zhvillimet e aksesit broadband në rrjetet celulare.

Ndërkohë Albtelecom çmon se, përveç informacionit mbi numrin e pajtimtarëve me akses broadband nga rrjete celulare do të ishte me interes edhe informacioni mbi volumin e trafikut të të

dhënave të transmetuara nga operatorët celularë në 2 vitet e fundit 2014-2015 (përveç ndryshimeve në % nga viti në vit të përmendura në dokument), për të bërë qartësisht të evidentueshëm rritjen e interesit të tyre për të përdorur/konsumuar këto shërbime.

Në konkluzion të gjithë përshkrimeve që edhe vetë AKEP ka dhënë, është më se e qartë se konkurrenca është mjaft efektive në treg, numri i abonentëve që marrin shërbime broadband është gjithnjë e në rritje dhe teknologjia për ofrimin e shërbimeve broadband avancohet gjithmonë në favor të zgjedhjeve të disponueshme për konsumatorin në treg. Ndaj, nuk ka vend për asnjë formë rregullatore dhe për më tepër në formën e çfarëdo lloji skeme të shërbimit universal për përcaktimin e paketave të rregulluara nga ana e AKEP në treg

Telekom Albania

Zhvillimet në tregun e aksesit broadband në rrjetet fikse në Shqipëri të trajtuara dhe gjatë procesit të konsultimit publik për tregjet me shumicë të aksesit broadband në Internet, ku të dhënat e paraqitura për shërbimet e aksesit broadband në rrjetet fikse janë të ngjashme me ato të evidentuara dhe në këtë dokument të konsultimit publik për statusin e Shërbimit Universal, Telekom Albania, gjykon se këto zhvillime në rrjetet fikse janë pasqyruar në mënyrë korrekte.

Gjithashtu, në lidhje me zhvillimet e aksesit broadband në rrjetet celulare Telekom Albania nuk ka ndonjë objeksion për të bërë apo për të shtuar ndonjë element tjetër. Në rrjetet celulare ky zhvillim ka qënë mjaft dinamik dhe pozitiv si një indikator mjaft domethënës i nivelit të lartë të konkurrencës në treg edhe si rezultat i futjes në treg të shërbimeve 4G dhe investimeve të konsiderueshme në teknologjinë 4G.

Plus Communication :

Plus mendon se janë shprehur drejt zhvillimet e aksesit broadband në rrjetet fikse dhe celulare në Shqipëri.

Vodafone Albania

Vodafone Albania është përgjithësisht dakord me analizën e AKEP lidhur me zhvillimet e aksesit broadband në rrjetet fikse dhe celulare në Shqipëri.

Sa i përket konkluzioneve në Dokumentin për këshillim publik, Vodafone është e mendimit se tregu aktual i komunikimeve elektronike i plotëson në mënyrë të mjaftueshme nevojat e popullsisë për akses në shërbime me tarifa të përballueshme dhe për rrjedhojë nuk ka nevojë për identifikimin dhe ofrimin e rregulluar të ndonjë elementi të Shërbimit Universal (SHU).

Nëse ka ndonjë aspekt që AKEP duhet të fokusohet është promovimi i aksesit në broadband nga rrjetet fikse, në vend që të shtyjë detyrimet rregullatore drejt operatorëve celularë se bashku me kostot përkatëse. Operatorët celularë kanë qënë gjithmonë në pararojë të zhvillimit, investimit dhe bartjes së rreziqeve të tregut.

Qëndrimi i AKEP

AKEP në versionin final të dokumentit ka marrë në konsideratë sugjerimet e operatorëve për përfshirjen e treguesve të tjerë të tregut si penetrimi i aksesit broadband dhe sasia e të dhënave doëload e të dhënave. Gjithashtu AKEP ka përditësuar dokumentin me të dhënat më të fundit të tregut për fundvitin 2016 dhe tremujorin e katërt 2016.

2. Çfarë mendoni për propozimin e AKEP për përfshirjen e aksesit broadband në objektin e shërbimit universal?

Albtelecom

Komisioni European nuk ka miratuar ende propozimin për përfshirjen e aksesit broadband në fushën e Shërbimit Universal dhe pritet ta miratojë atë jo më herët se fundi i vitit 2017, ndërkohë që nga vendet anëtare të BE, vetëm 7 prej tyre kanë përfshirë aksesin broadband në fushën e shërbimit universal në legjislacionin e tyre vendas si zgjedhje e tyre e lirë dhe jo si detyrim nga Direktiva e BE. Ndaj Albtelecom, e sheh shumë të parakohshme marrjen e iniciativave nga AKEP të cilat jo vetëm nuk kanë marrë formë përfundimtare në nivel European po as praktika mbi përfshirjen e këtij elementi nuk është maturuar në një nivel të tillë që të justifikojë disi këtë iniciativë. Për më tepër, kur tregu shqiptar demonstron për një rritje të kërkesës dhe ofrimit të shërbimeve broadband dhe konkurrenca në treg është mjaft e fortë në këtë drejtim, çka tregon se ofertat dhe paketat në treg kënaqin kërkesat e abonentëve dhe rritja e numrit të abonentëve në total tregon po ashtu përballueshmërinë e çmimeve për këtë element.

Telekom Albania

Gjatë viteve të fundit konkurrenca midis operatorëve në sektorin e komunikimeve elektronike është zhvendosur në ofrimin e shërbimeve të aksesit broadband në internet, i cili është kthyer në një shërbim të rëndësishëm komunikimi për përdoruesin fundor si dhe ka gjetur një aplikim të gjerë sot në një sërë fushash si: arsimi, shëndeti publik, siguria, etj.

Dhe janë pikërisht këto disa nga faktorët që dhe Komisioni Evropian në draftin e tij për rishikimin e kuadrit rregullator në Shtator 2016 të propozojë shërbimin e aksesit në internetin funksional të disponueshëm nga një vendndodhje fikse të përfshihet në objektin e Shërbimit Universal (Neni 79 i Draft Direktives).

Por ka diferenca të mëdha në lidhje me penetrimin e broadband nga vendndodhje fikse midis vendeve të ndryshme të BE-së dhe Shqipërisë. Në Shqipëri niveli i penetrimit është akoma i ulët megjithë zhvillimin sinjifikativ dhe investimet në rrjet nga ana e operatorëve të telefonise fikse, të përqëndruara kryesisht në zonat më të mëdha urbane.

Shpesh, kërkesat bazike që bëjnë të mundur përdorimin e shërbimeve të Internetit nuk përmbushen. Disponueshmëria e broadband-it (p.sh. shtrirja e rrjetit dhe mbulimi i tij) si dhe teknologjia/shpejtësia e broadband varet shumë nga niveli i PBB-së të çdo vendi, që nga ana tjetër, varet nga zhvillimet globale dhe ato historike. Zhvillimet e broadband në Shqipëri kohëve të fundit nuk kanë evidentuar ndonjë interes të lartë dhe të veçantë nga ana e publikut, sidomos në zonat më të largëta rurale, duke mos e parë atë si një shërbim të domosdoshëm për plotësimin e nevojave të tyre bazike. Penetrimi i broadband është i lidhur me të ardhurat për frymë të përdoruesve ndaj ky penetrim është më i ulët në Shqipëri.

Telekom Albania mendon se një ndërhyrje rregullatore në këtë rast do të shkaktojë një barrë të tepërt për operatorët, duke përfshirë shërbimet e aksesit broadband nga vendndodhje fikse në objektin e shërbimit universal, për shkak të kostove të larta që lldhen me investimet që duhen kryer ende për ofrimin e këtij shërbimi në shumta zona të vendit.

Plus Communication

Në lidhje me pyetjet 2/3 aksesi broadband ofrohet nga operatorët e shërbimeve të telekomunikacioneve në gjithë territorin , duke ezauruar kërkesat e SHU.

Vodafone Albania

Vodafone Albania beson se tregjet konkurruese janë më të përshtatshme për zgjerimin e tregut broadband dhe se Qeveria për çdo ndërhyrje që ka për qëllim zgjerimin e disponueshmërisë/mbulimit dhe përballueshmërisë së aksesit broadband në Shqipëri duhet të mbajë parasysh në çdo rast ruajtjen e një tregu konkurrues dhe të jetë e kujdesshme në mënyrë të tillë që çdo ndërhyrje nga shteti të mos shtrembërojë konkurrencën në treg.

Penetrimi i aksesit broadband në popullsinë shqiptare që nga viti 2012 është rritur ndjeshëm, pa pasur ndërhyrje detyruese nëpërmjet SHU ku rolin kryesor e kanë luajtur operatorët celularë duke investuar rregullisht e duke zhvilluar e zgjeruar infrastrukturën e tyre.

Tashmë rreth 100% e popullsisë mbulohet me akses GPRS internet dhe 99 % e popullsisë me akses UMTS Internet ndërsa norma e penetritimit për popullsi me akses broadband celular në vitin 2015 shënoi 72.36%. Tregu pra rezultoi konkurrues lidhur me aksesin broadband celular dhe plotëson nevojat e të gjithë konsumatorëve lidhur me disponueshmërinë e aksesit broadband dhe përballueshmërinë e tarifave, pa pasur nevojë për ndërhyrje të mëtejshme, ndryshe nga sa ndodh me tregun e telefonisë fikse që nuk është ende konkurrues, pjesërisht prej pozitës dominuese të operatorit inkumbent dhe pjesërisht prej mungesës së investimeve afatgjata në infrastrukturë dhe modernizimin e saj.

Nga ana tjetër operatorët celularë, ndryshe nga ata të telefonisë fikse, ofrojnë paketa shumë konkurruese në treg lidhur me shërbimin e aksesit në internet të cilat janë fleksibël sa i përket kohëzgjatjes së përdorimit dhe me çmime të përballueshme dhe shumë të favorshme edhe për përdoruesit me të ardhura të ulëta.

Vodafone Albania beson në avantazhet e një tregu konkurrues për të patur efikasitet nga ana ekonomike pa ndërhyrje të forcuara rregullatore. Këto avantazhe vërehen konkretisht me përmirësimin e cilësisë së rrjetit celular, uljen e theksuar të tarifave, si dhe mbulimin e gjerë të popullsisë me akses internet broadband. Prandaj, mbështesim parimin se mekanizmat e tregut konkurrues duhet të jenë mënyra e preferuar për të arritur objektivat e shërbimit universal, pa qenë nevoja për ndërhyrje specifike rregullatore të kësaj natyre siç propozohet.

Përfshirja e aksesit broadband si element i SHU nuk është detyrim sipas Direktivës për SHU dhe vetëm në 14.09.2016 KE ka publikuar propozimin që edhe aksesi broadband bazik të përfshihet në fushën e SHU. Për rrjedhojë konsiderohet tejet premature dhe jo e arsyeshme përfshirja e aksesit broadband. Aktualisht në BE përfshirja e aksesit broadband në objektin e SHU nuk është një praktikë e aplikuar gjerësisht, (vetëm në 7 vende) dhe niveli minimal i aksesit është përcaktuar që të këtë shpejtësinë prej 1 Mbps, jo 2 MBps siç AKEP kërkon.

Përsa më sipër, duke pasur parasysh karakteristikat e tregut shqiptar; gjykohet se aksesi broadband nuk duhet përfshirë në objektin e shërbimit universal pasi 1) nevojat ekzistuese janë

plotësuar nga tregu konkurrues qoftë në mbulim, shpërndarje apo çmim dhe 2) çdo iniciativë prematurë që nuk respekton fazat e zhvillimit dhe nevojat aktuale ka premisa të çojë fondet e investimit në drejtime të gabuara dhe për rrjedhojë të sjellë dështim në rikthimin e investimit dhe veshtrësi financiare në të ardhmen.

Qëndrimi i AKEP

AKEP në versionin final të dokumentit ka marrë në konsideratë komentet e operatorëve për mos-përfshirjen e aksesit broadband në objektin e SHU dhe si të parakohshëm në kushte e Shqipërisë si dhe në linjë me shumicën e vendeve të BE.

3. Cili është opinioni juaj për përfshirjen në objektin e SHU edhe të aksesit (telefoni/broadband) nga rrjete celulare?

Albtelecom

Bazuar në përgjigjen e pyetjes 2, si dhe duke marrë në konsideratë rritjen sinjifikative të penetrimit të aksesit broadband nga rrjete celulare në 46% për vitin 2015, normën e penetrimit të aksesit të telefonisë nga rrjetet celulare për përdorues aktivë prej 120% për vitin 2015 dhe mbulimin e popullsisë më shumë se 90% me rrjet 3G, Albtelecom shprehet edhe njëherë se indikatorët e tregut tregojnë më së miri se përfshirja e aksesit broadband në fushën e shërbimit universal nuk do të merrte kuptim dhe do të ishte e pajustificuar nëse nuk do të përfshihej aksesit broadband nga rrjetet celulare.

Telekom Albania

Përfshirja e një shërbimi në objektin e Shërbimit Universal duhet të marrë në konsideratë zhvillimet teknologjike, sociale dhe ato në treg për të konkluduar nëse është apo jo e nevojshme kjo përfshirje, bazuar dhe në Aneksin e Direktivës së Shërbimit Universal, sipas së cilës elementet që duhet të merren në shqyrtim nga autoriteti rregullator janë:

- disponueshmëria e shërbimit nga pjesa më e madhe e përdoruesve dhe nëse ka përjashtim social nga mungesa e saj;
- nga disponueshmëria e këtij shërbimi përfitojnë të gjithë përdoruesit në mënyrë të tillë që ndërhyrja është e nevojshme vetëm nëse ky shërbim nuk i ofrohet publikut në kushtet normale të tregut.

Nga të dhënat e paraqitura në këtë dokument për konsultim publik për shërbimin e aksesit Broadband nga rrjetet celulare, vihet re qartësisht mjedisi tepër konkurrues për ofrimin e këtij shërbimi nga operatorët celularë i karakterizuar nga rritja e nivelit të penetrimit të përdoruesve aktivë celularë të aksesit broadband në 3G/4G, mbulimi i të gjithë territorit dhe i popullsisë me rrjetin UMTS në mënyrë që këto shërbime të jenë të arritshme nga të gjithë përdoruesit, rritja e volumit të të dhënave të trasmetuara, gama e gjerë e paketave bundle që përfshin aksesin në 3G/4G me çmime mjaft të arsyeshme për abonentin, siç evidentohet dhe nga analiza dhe nga konkluzionet në dokumentin për konsultim publik në lidhje me përbalueshmërinë e tarifave për aksesin broadband nga rrjetet celulare:

Duke marrë në konsideratë tarifatat aktuale të shportave të integruara (telefoni/SMS dhe Internet) në rrjetet celulare për përdoruesit me parapagim rezultojnë se konsumi 800-1000 lek/muaj (me 7VSH) është shumë më/i lartë se konsumi i referuar nga ITU si benchmark për krahasimin midis vendeve për përballueshmërinë e tanfave. Në terma të përballueshmërisë shpenzimi 800-1000 lek/muaj për akses në telefoni dhe Internet celular është 1.75-2.15% e GNI për frymë të Shqipërisë në 2014(4505 USD).

“Për nivelin mesatar të të ardhurave ky nivel shpenzimesh për konsumin e cituar vlerësohet të jetë i përballueshëm.”

Mbulimi në nivel popullsisë dhe territor me rrjetet celulare nga ana e operatorëve të telefonisë së lëvizshme është mbi 85% duke garantuar që shërbimet e aksesit në broadband mobile të jenë të arritshme për pjesën më të madhe të përdoruesve deri dhe në zonat më të largëta rurale, pra shërbimet e aksesit të telefonisë mobile dhe broadband nga rrjetet celulare ofrohen në kushte normale tregu duke i bërë të përballueshme dhe të arritshme dhe për shtresat më në nevojë të popullsisë dhe me të ardhura më të ulëta apo në zonat e largëta, dhe në rrethana të tilla.

Nuk është e nevojshme një ndërhyrje rregullatore për përfshirjen e këtij shërbimi në objektin e Shërbimit Universal, kur ka një treg me nivel të lartë konkurrence i karakterizuar nga progresi teknologjik dhe nga rënia e vazhdueshme e çmimeve për përdoruesin fundor, fokusi duhet të jetë i drejtuar më shumë drejt forcave të tregut sesa drejt përfshirjes së shërbimeve në objektin e shërbimit universal.

Për sa më sipër, Telekom Albania shprehet kundër përfshirjes në objektin e Shërbimit Universal të aksesit (telefoni/broadband) nga rrjetet celulare, dhe gjykon që këto shërbime të vazhdojnë të ofrohen në kushtet normale të tregut, duke qenë se janë të arritshme dhe të përballueshme nga të gjitha kategoritë e përdoruesve.

Plus Communication

Në lidhje me pyetjet 2/3 aksesi broadband ofrohet nga operatorët e shërbimeve të telekomunikacioneve në gjithë territorin, duke ezauruar kërkesat e SHU.

Vodafone Albania

Vodafone me keqardhje vëren se dokumenti adreson përfshirjen në skemën e ofrimit të aksesit broadband vetëm për operatorët celulare, duke përjashtuar kështu në mënyrë indirekte operatorët fiks dhe atë inkumbent. Kjo është plotësisht e kundërt me qëndrimin e të gjithë rregullatorëve në BE e më gjerë që kanë përzgjedhur të aplikojnë SHU. Ligji 9918/2008 përcakton qartësisht detyrimin për zbatimin e parimit të neutralitetit të teknologjisë, prandaj Vodafone Albania kërkon që AKEP të mbajë në vëmendje këtë aspekt. Nëse detyrimet e SHU do t'i vendoseshin vetëm operatorëve të telefonisë celulare kjo do të ishte një sjellje diskriminuese e cila shtrembëron konkurrencën në treg.

Së dyti Vodafone kërkon nga AKEP të adresojë sa më shpejt shpërndarjen e barabartë të investimit duke bërë pjesë të skemës së përbashkët të investimit edhe operatorin Plus Communication, meqenëse është plotësuar kushti i autorizimit individual 3G, që kishte munguar.

Vodafone mbetet në pritje që AKEP të përcaktojë sa më shpejt zonat që Plus do të investojë me ndërtimin e stacioneve bazë, ku të gjithë operatorët e tjerë të mund të shkojnë dhe të bashkëvendosen, siç edhe është vepruar me tre operatorët e tjerë celularë.

Për sa i takon mbulimit me shërbim siç është theksuar edhe në përgjigjen e pyetjes së dytë më sipër, nëse marrim parasysh një kombinim të shërbimeve të aksesit broadband nëpërmjet mbulimit të

Albtelecom, Operatorëve të tjerë Alternative dhe mbulimin me rrjet të telefonisë celulare në nivelin e 100%, rezulton se aksesit telefoni/broadband është i disponueshëm në mënyrë universale në Shqipëri dhe se tregu ptohtëson në mënyrë të arsyeshme nevojat e përdoruesve

fundorë sa i takon disponueshmërisë, pa qenë nevoja për caktimin e këtij elementi të SHU në Shqipëri.

Gjithashtu, qasja drejt aksesit në broadband si pjesë e SHU mbi operatorët celularë siç propozohet, çka është e paprecedentë në vendet e BE, sjell dhe një konflikt me detyrimet për mbulim që kanë operatorët në autorizimet individuale të frekuencave për shërbimet 3G dhe 4G, si masa e mbulimit të territorit dhe popullsisë me broadband, ku secili operator është angazhuar ligjërisht dhe financiarisht për të respektuar ato, ndaj dhe ato nuk mund të ndryshojnë në këtë formë.

Për sa më lart, Vodafone sugjeron që aksesit në broadband nuk duhet të jetë pjesë e SHU. Në çdo rast trajtimi rregullator duhet të jetë jo-diskriminues: a) mes operatorëve celularë dhe b) operatorëve të telefonisë fikse.

Qëndrimi i AKEP

Në vijim edhe të qëndrimit për pyetjen 2, AKEP në versionin final të dokumentit ka marrë në konsideratë sugjerimet e operatorëve duke bërë ndryshimet përkatëse në document. Në lidhje me komentin e Vodafone për mos-përfshirje të operatoreve të rrjeteve fikse, AKEP sqaron se propozimi në këshillim public përfshinte rrjetet fikse dhe celulare, jo vetëm celulare.

4. A mendoni se paketat e propozuara nga AKEP për SHU janë të arsyeshme (shpejtësi, minuta, kapacitet doëload-1 apo 2GB/muaj?) për tregun dhe konsumatorët si dhe të përballueshme nga këta të fundit për sa i përket çmimit?

Albtelecom

Lidhur me këtë pyetje, komentet dhe sugjerimet e Albtelecom për paketat e propozuara nga AKEP dhe benefitet e përfshira në to, jepen si më poshtë:

a. Lidhur me *përfshirjen në paketat e SHU të 200 minutave pa pagesë*, Albtelecom mendon se kjo sasi është e tejkaluar dhe shumë më tepër se plotësimi i nevojave bazike për komunikim për një përdorues të kësaj kategorie specifike, pasi përdorimi mesatar mujor për abonentët e Albtelecom Fiks dhe për abonentët e rrjeteve celulare për më tepër në kushtet e ofertave komerciale apo dhe promocionale është shumë më i vogël se 200 minuta, ilustruar me tabelë përmbledhëse, duke bërë që përdoruesi i paketës së SHU që mendohet të përmbushë nevojat bazike të tij do të përfitojë shumë më tepër minuta se sa thirrjet dalëse mesatare të kryera nga një abonent i telefonisë fikse të Albtelecom (60 min/muaj për Q3/2016), dhe gjithashtu më shumë minuta se sa thirrjet dalëse mesatare të kryera nga abonenti i telefonisë celulare (130 minuta/muaj përdoruesi i Albtelecom mobile për Q3/2016). Këto tregues i referohen thirrjeve dalëse në total të kryera nga përdoruesi i rrjetit celular apo fiks, pavarësisht destinacionit të thirrjes kombëtare apo ndërkombëtare.

Theksohet se, për abonentin e telefonisë mobile, dhe vecanërisht për abonentët e regjistruar në ofertat me çmim më të ulët, përdoruesit e të cilave mund të jenë target i paketave të SHU, bazuar në të dhënat tona minutat për përdorues janë jo më shumë se 120 minuta/muaj. Ç'ka do të thotë se, përfshirja e sasisë 200 minuta në paketat e SHU

dukshëm tejkalon komunikimin mesatar mujor të kryer si nga përdoruesit e rrjeteve fikse ashtu dhe ato të rrjeteve celulare, që do të thotë se shkon përtej qëllimit të ofrimit të paketave të SHU për plotësimin e nevojave bazike për komunikim.

Për sa i takon përfshirjes së 50 SMS-ve në paketat me minuta dhe paketat e integruara të propozuara për operatorët celularë, duke u nisur nga përdorimi mesatar i SMS-ve për abonentët celularë rreth 35 SMS/muaj dhe koston relativisht të ulët të interkoneksionit me operatorët, Albtelcom nuk shpreh kundërshtime.

Në përfundim, Albtelcom sjell në vëmendje se, të gjithë analizat dhe vlerësimet e bëra për benefitet e propozuara nga Albtelcom për tu përfshirë në paketat e SHU, janë të bazuara në tarifa terminimi simetrike për të gjithë operatorët celularë (1.48 lek/min), dhe për operatorët e rrjeteve fikse (1.29 lek/min), duke kërkuar kështu fillimin e implementimit të paketave të SHU kur koston e interkoneksionit të operatorëve të jenë të njëjta, pra të kenë tarifa terminimi simetrike, përfshirë Operatorin Plus.

Kështu, duke konsideruar sa më sipër mbi përdorimin mesatar mujor të përdoruesve të rrjetit celular dhe të përdoruesve të rrjetit fiks, si dhe kryerjen pa pagesë të thirrjeve drejt numrave të emergjencës, Albtelcom propozon që maksimumi i mundshëm i kohës së bisedës në minuta që duhet të përfshihet në paketat e shërbimit universal është 100 minuta.

- b.* Sa i takon propozimit për ***‘përfshirjen në paketat e integruara të aksesit broadband nga rrjeti fiks të internetit me shpejtësi 2 Mbps’*** apo për ***‘paketat vetëm internet me shpejtësi 2 Mbps’*** dhe kapacitet 1-2 GB, Albtelcom sqaron se shpejtësia e propozuar e internetit duhet të jetë maksimumi *deri në 1 Mbps* dhe e pasankcionuar si “mandatory” për shkak të specifikave të shërbimit ADSL dhe natyrës dinamike të konektivitetit të shërbimit apo të vetë karakteristikave të konektivitetit 2G/3G/4G në rastin mobile që nuk mund të “mandatohet” një shpejtësi fikse pasi ajo është variabël varësisht vendodhjes apo mbulimit konkret të përdoruesit të shërbimit dhe ngarkesës që ka në një moment të caktuar rrjeti. Ndërsa në lidhje me kapacitetin, Albtelcom vlerëson se kapaciteti 1 GB si për paketat e integruara ashtu edhe për paketat vetëm internet të telefonisë fikse dhe mobile përmbush nevojat bazike të abonentit, duke tejkeluar edhe mesataren e përdorimit të internetit për telefoninë e lëvizshme që nuk i kalon 0.66 GB, që do të thotë se për kryerjen e shërbimeve bazike të tij të tilla si broësor të ndryshëm, email, apo kryerjen e shërbimeve online në portalet qeveritare të shërbimit online, etj, një përdorues i rrjetit celular e ka më se të mjaftueshëm internetin me kapacitet 1 GB.

(AKEP mund të nxjerrë lehtësisht këtë tregues edhe për operatorët e tjerë celularë për të gjykuar qartë mbi përdorimin mesatar të internetit nga përdoruesi i rrjetit celular).

- c.* Lidhur me ***Çmimin e propozuar për paketat e integruara të aksesit broadband nga rrjeti Fiks, dhe paketat vetëm me minuta***, Albtelcom mendon se çmimi 800 Lek për paketën e integruar dhe 500 Lek për paketën vetëm me minuta për ofrimin nga operatorët e telefonisë fikse të paketave të shërbimit universal do të ishin të pranueshëm vetëm nëse AKEP do të konsideronte dhe reflektonte propozimet tona në lidhje me përmbajtjen e paketës, ku koha e bisedës nuk mund të jetë më shumë se 100 minuta, shpejtësia deri në 1 Mbps dhe kapaciteti maksimumi 1GB.

Në *rastin e çmimit 500 lek për paketën me minuta*, duke konsideruar vetëm koston e terminimit e të origjinimit të thirrjes, kostoja për ofrimin e 200 minutave tejkalon ndjeshëm cmimin e propozuar, pa marrë në konsideratë koston e mirëmbajtjes mujore, konsiderimi apo shtimi i së cilës e bën totalisht të pamundur ofrimin e kësaj pakete.

Sa më sipër, qoftë për arsye të përmbushjes së nevojave të abonentit për shërbime bazike të komunikimeve elektronike, qoftë për arsye të kostove që i shkaktohen operatorëve të tregut të komunikimeve elektronike, Albtelecom do mund të ofrojë paketën me çmim 500 lek vetëm nëse përfshihen vetëm 100 minutave kohë bisede.

Në *rastin e çmimit 800 lek paketën e integruar*, Albtelecom thekson se do mund të ofrojë këtë paketë me çmimin 800 lek, vetëm nëse përmbajta e kësaj pakete do të kufizohej me 100 minuta kohë bisede, shpejtësi deri në 1Mbps për aksesin në internet dhe kapacitet 1G.

Në përfundim, në mënyrë të përmbledhur propozimi i Albtelecom dhe i AKEP për paketat e SHU të telefonisë fikse është paraqitur më poshtë:

| Paketat e Shërbimit Universal te telefonise fikse | Propozimi i AKEP | Propozimi i Albtelecom | Cmimi ne Lek (me TVSH) |
|--|---|--|-------------------------------|
| Paketa me minuta | 200 min | 100 min | 500 Lek |
| Paketa e Internetit | 2 Mbps / 1GB-2GB | deri në 1 Mbps / 1GB | 500 Lek |
| Paketa e Integruar | 200 min 2 Mbps / 1GB -2GB | 100 min deri në 1 Mbps / 1 GB | 800 Lek |

- Lidhur me *Cmimin e propozuar për paketat vetëm me minuta, paketat vetëm Internet dhe paketat e integruara të ofruara nga operatorët celularë*, Albtelecom do mund të ofronte me cmimin 500 lek paketën me minuta e SMS dhe për paketën vetëm internet, vetëm nëse merret në konsideratë propozimi i Albtelecom për përfshirjen në këto paketa të 100 minutave kohë bisede (sikurse dhe është analizuar dhe është propozuar më sipër nga Albtelecom në përgjigje të pyetjes 4)

Kështu, në *rastin e çmimit 500 lek për paketën me minuta e SMS* duke konsideruar koston e terminimit e të origjinimit të thirrjes dhe koston e terminimit të SMS-ve, ofrimi i 200 minutave të propozuara nga AKEP tejkalon ndjeshëm cmimin e propozuar, duke e bërë totalisht të pamundur ofrimin e kësaj pakete.

Sa më sipër, qoftë për arsye të përmbushjes së nevojave të abonentit për shërbime bazike të komunikimeve elektronike (argumentuar më lart), qoftë për arsye të kostove që i shkaktohen operatorëve të tregut të komunikimeve elektronike, Albtelecom do të mund të jepte dakortësinë me cmimin 500 lek të propozuar nga AKEP, vetëm nëse Autoriteti përcakton përfshirjen e vetëm 100 minutave kohë bisede në këtë paketë.

Në *rastin e çmimit 500 lek për paketën vetëm internet* duke konsideruar paketat aktuale që operatorët kanë në treg dhe treguesin e përdorimit mesatar të aksesit broadband më të

ulët se 1 GB/përdorues/muaj, Albtelecom vlerëson se ky cmim do të ishte i justifikuar vetëm në rast të ofrimit të 1GB kapacitet për paketë

Në mënyrë të përmbledhur propozimi i Albtelecom dhe i AKEP për paketat e SHU të telefonisë celulare është paraqitur më poshtë:

| Paketat e Shërbimit Universal në telefoninë celulare | Propozim i AKEP | Propozim i Albtelecom | Cmimi në Lek (me TVSH) |
|---|--|---|-------------------------------|
| Paketa me minuta | 200 min 50 SMS | 100 min 50 SMS | 500 Lek |
| Paketa e Internetit | 1GB - 2GB | 1 GB | 500 Lek |
| Paketa e Integruar | 200 min 50 SMS 1GB - 2GB | 100 min 50 SMS 1GB | 1000 Lek |

Në përfundim, Albtelecom thekson edhe njëherë se dakortësia jonë për cmimet e paketave të SHU të telefonisë fikse dhe të telefonisë celulare, do të qëndronte vetëm nëse do të merrej në konsideratë propozimi ynë për përfshirjen e 100 minutave kohë bisede në këto paketa, shpejtësi deri në 1Mbps dhe jo më shumë se 1GB kapacitet. Element kryesor në këtë vlerësim nga ana e Albtelecom është konsideruar tarifa simetrike e terminimit si për operatorët e telefonisë fikse (1.29 lek/min nga 01.01.2017), ashtu dhe për operatorët e telefonisë celulare (1.48 lek/min), përfshirë operatorin Plus. Sa më sipër, Albtelecom i kërkon AKEP të garantojë operimin në kushte të njëjta dhe me tarifa terminimi simetrike për të gjithë operatorët celularë, ndaj pa u garantuar ky kusht nuk mund të implementohet detyrimi për ofrimin e këtyre paketave në treg.

Telekom Albania

Në bazë të Direktivës në fuqi për Shërbimin Universal, Aneksi V, dy janë elementët kryesorë që një shërbim të përfshihet ose jo në objektin e SHU: shërbimi i arritshëm nga pjesa më e madhe e përdoruesve dhe përballueshmëria e tarifave nga përdoruesit {në kushte normale të tregut}.

Sipas informacionit të paraqitur në këtë dokument operatorët celularë ofrojnë një mbulim të pjesës më të madhe të territorit dhe të popullsisë me shërbim të aksesit broadband nga rrjetet celulare.(Telekom Albania mbulon 86% të territorit dhe 96% të popullsisë) me rrjetin UMTS, duke bërë që këto shërbime të jenë të arritshme dhe të disponueshme për pjesën më të madhe të përdoruesve deri dhe në zonat rurale të largëta me dendësi të vogël të popullsisë.

Pra, elementi i parë evidenton faktin që nuk ka përjashtime sociale për ndonjë kategori të caktuar përdoruesish, pasi pothuaj për pjesën më të madhe të tyre këto shërbime janë bërë të aksesueshme.

Element tjetër janë tarifatat me të cilat ofrohen këto shërbime. Nga evidentimi i bërë nga konkluzionet e AKEP, çmimet që ofrojnë operatorët celularë në paketat e tyre të integruara (Telefoni, Internet) janë mëse të përballueshme dhe të arsyeshme për të gjitha kategoritë e përdoruesve, duke plotësuar nevojat më bazike të tyre për të pasur akses në këto shërbime, të cilat ofrohen në kushte normale tregu me një konkurrencë të lartë midis operatorëve.

Gjithashtu, pothuajse të gjithë operatorët celularë ofrojnë për përdoruesit me parapagim oferta mujore të integruara për zërin dhe Internet në kushte normale tregu, të arsyeshme për përdoruesit.

Prandaj, duke marrë parasysh sa më sipër Telekom Albania shprehet kundër propozimit të AKEP që paketat e ofruara nëpërmjet rrjeteve celulare të jenë të përfshira në objektin e SHU, duke qenë se këto paketa janë të arritshme për përdoruesit fundorë në kushte normale tregu dhe me çmime më se të arsyeshme të njëjta me ato të propozuara nga AKEP, dhe si e tillë nuk është e nevojshme një ndërhyrje rregullatore për të përcaktuar këto paketa si masë detyruese për operatorët në kuadrin e SHU, për më tepër volumet e përcaktuara në këto paketa janë mjaft të larta për qëllimin e ofrimit të shërbimeve për nevojat bazike nëpërmjet Shërbimit Universal.

Përsa i përket shërbimeve të aksesit broadband nga rrjetet fikse, operatorët e telefonisë fikse kanë bërë investime të konsiderueshme në rrjetet e tyre duke rritur më tej zonat e mbulimit në nivel popullsie dhe territorial, dhe në ato zona urbane dhe rurale të pambuluara, një gjë e tillë është bërë tashmë e mundur nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të telefonisë fikse nëpërmjet teknologjisë GSM si një shërbim komplementar dhe mëse zëvendësues nga ana e perspektivës së konsumatorit, duke bërë të mundur që shërbimet e aksesit broadband në internet të jenë të arritshme për përdoruesit me çmime të arsyeshme për ta.

Edhe në rastin e telefonisë fikse, nuk është i nevojshëm inkuadrimi i paketave të propozuara nga AKEP si një detyrim për operatorët në objektin e Shërbimit Universal, për shkak të tarifave të ulëta dhe mëse të përballueshme për përdoruesit, siç është konstatuar në këtë dokument.

Vendosja e çmimive dhe volumeve të përcaktuara nga ana e AKEP si pjesë e shërbimit universal është e tepërt duke marrë parasysh që tregu i lëvizshëm i telekomunikacionit është aktualisht i rregulluar në tregun me pakicë dhe ofron shërbime me çmime shumë më të lira se vendet e BE (treguar edhe në dokument).

Çmimet në tregun me pakicë kanë ardhur gjithnjë në ulje nga viti në vit, siç dhe evidentohet nga ulja e ARPU gjatë viteve 2010-2015 [xqI"IV.3.3 Tarifatat e telefonisë celulare, Tabela IV.9' e dokumentit për konsultim), gjë e cila përkthehet në shërbime të telefonisë celulare gjithnjë e më konkurruese dhe më të përballueshme për përdoruesin final, duke bërë që të mos ketë asnjë lloj rrisje të përjashtimit social në aksesimin e këtyre shërbimeve,

Telekom Albania e vlerëson sa më sipër si një tjetër masë rregullatore e panevojshme në kushtet aktuale të tregut. TAL teston përpara hedhjes në treg të produkteve dhe paketave të komunikimit, gatishmërinë e konsumatorit për të paguar nisur edhe nga të dhënat e sjelljes për çdo element të shërbimit.

Ndaj, kriteret për përfshirjen e shërbimeve dhe paketave celulare në objektin e Shërbimit Universal nuk permbushen pasi nuk ekziston asnjë mundësi që të krijohen përjashtime sociale

për kategori të caktuara përdoruesish (me të ardhura të ulëta, njerëz të moshuar, etj) në aksesin dhe përdorimin e këtyre shërbimeve.

TAL e gjykon gjithashtu si të tepërt që shpejtësia e propozuar për të pasur akses funksional në internet të jetë 2 MBps si nga një vendndodhje fikse ashtu dhe për broadband nga rrjetet celulare, pasi siç evidentohet dhe nga praktika rregullatore referuar raportit të KB "Implementation of the EU regulatory framework for electronic communication - 2015, EC Staff Working document, në disa vende të BE-së si; Suedi, Spanjë, Belgjikë, Kroaci, Hungari, Finlandë, apo dhe në rajon (Mali i Zi), shpejtësi për të garantuar një akses funksional në internet është deri në 1Mbps për rrjetet fikse.

Propozimi i AKEP për ofrimin e shërbimit të aksesit broadband në Internet me një shpejtësi minimale prej 2 Mbps në kuadrin e SHU-së ka implikime në kushtet e Autorizimit Individual për shërbimet 3G, duke detyruar operatorët që të ofrojnë këtë lloj shpejtësie në të gjithë territorin e vendit, dhe në këtë mënyrë duke rritur më tej kostot rregullatore për operatorët celularë.

Një detyrim i tillë si praktikë rregullatore nuk gjendet në vendet e rajonit apo ato anëtare të BE-së për rrjetet celulare.

Dëshirojmë të sjellim në vëmendjen e AKEP se arritja e shpejtësisë 2 Mbps varet nga shumë faktorëve edhe nga nr. i përdoruesve në një qelizë.

Plus Communication

Shprehet se paketat e propozuara nga AKEP për SHU janë të arsyeshme (shpejtësi, minuta, kapacitet download-1 apo 2GB/muaj) për tregun dhe konsumatorët si dhe të përballueshme nga këta të fundit për sa i përket çmimit.

Vodafone Albania

Vodafone gjykon se propozimi i AKEP është një ndërhyrje indirekte në tregun e pakicës dhe si e tillë ajo përbën një rregullim të paarsyeshëm të këtij tregu ndaj dhe nuk jemi dakord. Por edhe sikur të zbatohet, çka nuk duhet, sasia e minutave/SMS/data nuk reflekton konsumin mesatar por e tejkalon atë e për rrjedhojë paketa është jo e justifikuar.

Me uljen e konsiderueshme të çmimeve të telefonisë celulare, uljen në vijim të tarifave të telefonisë fikse, ofrimin e paketave e ofertave të ndryshme që përfshijnë dhe thirrje, SMS, Internet, me çmim të ulët ose pa pagesë, ose pa limit përballueshmëria e shërbimeve të telefonisë celulare dhe atyre fikse nuk është më një barrier për aksesin për grupet e popullsisë me të ardhura të ulëta. Kjo dëshmohet edhe nga analiza e AKEP në dokumentin për këshillim publik (fq 27,28, 30,31,32) lidhur me krahasimin e tarifave të Altelecom me rajonin dhe vendet e BE, si dhe ARPU e telefonisë celulare në Shqipëri në krahasim me vendet e BE.

Ashtu sikurse analizon AKEP, paketat e propozuara aktualisht ofrohen në treg dhe i plotësojnë nevojat e përdoruesve me të ardhura të ulëta, pa qenë nevoja për caktimin e tyre si element i SHU.

Gjithashtu, familjet me të ardhura të ulëta preferojnë paketat me parapagim, duke qenë se e kanë më të lehtë të kontrollojnë shpenzimet e tyre krahasuar me telefoninë fikse. Këtë e vërteton edhe rritja e mbulimit të popullsisë në shërbimet e telefonisë celulare (100% e popullsisë).

Në këtë kontekst Vodafone Albania mendon se AKEP nuk duhet të ndërhyjë duke rregulluar çmimet e paketave me pakicë në mënyrë të veçantë sa i përket paketave të operatorëve të telefonisë celulare, pasi mbulimi i gjërë i popullsisë me shërbime telefonie tregon se tregu i plotëson nevojat e përdoruesit fundor. Ndërhyrjet në tregun me pakicë nuk duhet të shtrembërojnë konkurrencën por duhet të adresojnë nevojat e përdoruesve nëse këto nevoja nuk janë adresuar tashmë nga tregu konkurrues. Siç provohet nga vetë analiza e AKEP në dokumentin për këshillim publik, dhe siç argumentojmë në komentet tona këtu, ky nuk është rasti. Përkundrazi, me një penetrim celular shumë të gjerë në Shqipëri, do të ishte jo efiçente të caktoheshin paketa specifike me tarifa sociale të shërbimit universal për familjet e përcaktuara me të ardhura të ulëta, që gjithësesi mund të përballojnë tarifa shumë të ulëta të ofruara tashmë nga operatorët celularë përmes paketave e ofertave të ndryshme të njoftuara rregullisht konsumatorëve dhe AKEP.

Për më tepër, edhe Gjykata Europiane e Drejtësisë në vendimin e saj të datës 11 June 2015, Case C 1/14, lidhur me detyrimin e operatorëve të telefonisë celulare për të financuar tarifat sociale të SHU, ka vendosur si vijon: "Direktiva për Shërbimin Universal 2002/22/EC. e amenduar, duhet të interpretohet në mënyrë që tarifat speciale dhe mekanizmat financues të përcaktuar në nenin 9 dhe 13 (1) (b) të kësaj Directive aplikohen respektivisht për regjistrimet e shërbimeve të internetit nga një vendndodhje fikse, por jo për regjistrimet në shërbimet e telefonisë celulare, përfshirë shërbimin e regjistrimit në internet që ofrohen prej operatorëve celularë. Nëse këto shërbime (të telefonisë celulare) janë bërë publikisht të disponueshme brenda territorit si "shërbime shtesë të detyrueshme – elementë të shërbimit universal" për qëllimin e nenit 52 të Direktivës 2002/22, e amenduar, ato nuk mund të financohen sipas legjislacionit lokal nga një mekanizëm që përfshin operatorët e telefonisë celulare."

Gjithësesi, në rast se AKEP do të vendoste të përfshinte këto paketa me tarifa sociale si element i SHU (paketa SHU) dhe të përfshinte edhe operatorët e telefonisë celulare për ofrimin e tyre, çka nuk duhet bërë, Vodafone mendon se paketat e propozuara nga AKEP nuk janë të arsyeshme madje e tejkalojnë qëllimin për të cilin ofrohen dhe përbëjnë rrezik për deformimin e konkurrencës duke i shkaktuar humbje operatorëve të telefonisë celulare. Me qëllim garantimin e sigurisë ligjore të operatorëve të telefonisë celulare dhe adresimin e nevojave vetëm për përdoruesit që legjitimohen për të përfituar nga shërbimi universal. AKEP duhet të përcaktojë e dakordojë me operatorët elementët e mëposhtëm:

1. Është e pasqaruar nga AKEP se si është arritur në përfundimin nëse një tarifë e caktuar konsiderohet e përballueshme/ dhe çfarë metodologjie është zbatuar për të arritur në këtë përfundim; ndaj duhet përcaktuar se çfarë konsiderohet nga AKEP tariffë/kosto e përballueshme nga përdoruesi fundor me të ardhura të ulta dhe cila është metodologjia e përdorur për përcaktimin e këtyre tarifave dhe paketave SHU. Metodologjia duhet të marrë parasysh përveç elementeve financiare të kostos së operatorëve edhe dinamikat e tregut dhe trendet e ndryshimit të këtyre dinamikave në të ardhmen;

2. Është e paqartë se mbi çfarë kriteresh do të përfitohet aksesi në paketën e SHU: ndaj duhen përcaktuar kriteret dhe udhëzimet specifike lidhur me kategoritë e popullsisë/përdoruesve që do të përfitojnë këto paketa SHU, si dhe dokumentacioni provues që këta përdorues duhet t'i paraqesin operatorit në mënyrë që të përfitojnë paketat SHU; psh në UK tarifa sociale u ofrohet vetëm atyre konsumatorëve të cilët përfitojnë disa benefite të caktuara nga shteti.

3. Në rastin e ofrimit të këtyre paketave SHU edhe nga operatorët e telefonisë celulare, ekziston mundësia për abuzim dhe përfitim të padrejtë nga ana e personave që do të legjitimohen për të përfituar këto paketa, pasi një person mund të blejë praktikisht një paketë SHU nga çdo operator i telefonisë celulare, edhe t'jua japë për përdorim personave të tjerë që nuk janë të legjitimuar për të përfituar paketat SHU. Në këtë rast qëllimi i aksesit në paketën

SHU humbet funksionin e tij dhe deformon praktikën tregtare në treg. Me qëllim shmangien e këtij risku, i cili bie i gjithi në barrë të operatorëve celularë dhe e bën procesin inefficent e dëmton tregun, sugjerojmë që:

- Paketa e SHU duhet të jetë relativisht pak më e shtrenjtë sesa paketat normale më të lira me pakicë, me qëllim evitimin e efektit negativ në konkurrencën në nivel pakice. Në çdo rast duhet hequr propozimi për paketë SHU në vlerën 500 Lek dhe aio të jetë 800 Lekë sipër. Synimi duhet të jetë që edhe pas prezantimit të paketave SHU, dinamikat e tregut të mbeten të tilla që shumë përdorues të preferojnë paketat celulare normale si një alternative konkurruese ndaj këtyre paketave me tarifa sociale si element i SHU, e mos të abuzojnë duke blerë vetëm paketën SHU;
- Periudha e vlefshmërisë së paketës SHU të jetë në përputhje me periudhën e vlefshmërisë së çdo oferte/paketë tjetër të operatorit (psh. nëse periudha e vlefshmërisë së paketave normale të operatorit është 28 ditë, atëherë duhet të jetë edhe vlefshmeria e paketës SHU, etj.);
- Paketa e SHU duhet të ofrojë një nivel bazik/të ulët të shërbimit sa i përket cilësisë së shërbimit (shpejtësi e ulët, etj...) në mënyrë që përdoruesi të mund të përfitojë shërbimin bazë të aksesit në internet sië e përcakton ligji, por të mos shtrembërohet konkurrenca e dëmtohen operatorët e telefonisë celulare. Psh. Të gjitha shërbimet e aksesit në internet të propozuara nga AKEP në dokumentin për këshillim publik mundësohen praktikisht nga aksesit GPRS në internet (pra me shpejtësi më të vogël nga sa ka propozuar AKEP - 2Mbps). Siç përmendëm më lart, kjo është praktika edhe në ato vende të BE të cilët e kanë përfshirë aksesin broadband si element të SHU. Për më tepër aksesit GPRS Internet ka edhe shpërndarjen më të madhe aktualisht në popullsi dhe nivel territori (përkatesisht 100% të popullsisë dhe 95% të territorit të Republikës së Shqipërisë), celularët që suportojnë aksesin GPRS të internetit janë më të lirë, shumë të përhapur në treg, e për rrjedhojë përdoren më shumë nga personat me të ardhura të ulta duke adresuar plotësisht nevojat e tyre për akses në data në kuadër të shërbimit bazik me çmim të përballueshëm.
- Mesatarja e konsumit data doëload në rrjetin Vodafone është më pak se IGB/muaj, pra kapaciteti doëload prej 2 GB/muaj gjykojmë se nuk është aspak i arsyeshëm për paketat SHU, pasi tejkalon disa herë nevojat lidhur me aktivitetet e përcaktuara për shërbimin bazik të aksesit në internet. Vodafone sugjeron që paketa SHU duhet të ofrojë max 500 MB.

Qëndrimi i AKEP

AKEP vlerëson komnetet e operatorëve si të arsyeshme në lidhje me paketat e propozuara, pasi ato mund të jenë në kundërshtim me parimin e SHU që të mos ketë shtremberim të konkurrencës në treg. Gjithsesi, kjo pyetje është e lidhur me qëndrimin ndaj pyetjeve 2 dhe 3, dhe AKEP në versionin final të dokumentit ka bërë ndryshimet përkatëse, duke mos-përfshirë paketat e propozuara në objektin e SHU.

5. Cili është opinionin jua për shërbimet e numëratorit dhe telefonave publikë me pagesë? A duhet që AKEP të krijojë rregulla për mbajtjen e të dhënave të numëratorëve nga operatorët e rrjeteve fikse dhe celulare dhe aksesin në to nga ofruesit e mundshëm të këtyre shërbimeve?

Albtelecom

Për shërbimet e numërorit:

Albtelecom mendon se ky element i shërbimit universal, pra shërbimi i kërkimit në numëror praktikisht nuk kërkohet nga nevojat e shoqërisë shqiptare. Madje me rritjen e ndërgjegjësimit të individëve për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë, individët konsiderojnë se numri i tyre i telefonit është personal dhe nuk janë të gatshëm ta zbulojnë atë. Albtelecom ka të përfshirë në formën e regjistrimit të pajtimtarëve me kontratë opsionin për të dhënë pëlqimin të përfshihen në numërorin telefonik, por thuajse asnjë pajtimtar nuk e ka zgjedhur këtë opsion. Ndërsa për pajtimtarët me kartë të parapaguar, forma e regjistrimit është ajo e miratuar nga AKEP dhe që nuk ka një opsion të tillë të përfshirë. Për sa i përket numrave të kontaktit të bizneseve, kjo nevojë është plotësuar nga tregu më së miri, sa kohë që ka disa portale online që ofrojnë numërorë në internet duke përfshirë informacionin për biznese, restorante, administratën, shërbime shëndetësore etj., siç është faqja fletëteverdha.com., etj. Pikërisht, për shkak të informacionit të gjerë që mund të gjendet në internet nuk ka qenë e nevojshme të paturit e numërorëve telefonikë.

Sa më sipër, Albtelecom sugjeron që AKEP të ndjekë nga afër situatën dhe mundësitë që aktualisht ofron tregu lidhur me këtë element të shërbimit universal, të rivlerësojë elementin e mbajtjes së të dhënave të numërorëve, dhe të mos ndërmarrë iniciativa për krijimin e rregullave të cilat përveçse kosto administrative e njerëzore për kompanitë e telekomunikacionit, nuk do të sillnin absolutisht përfitim për përdoruesit e këtyre shërbimeve dhe për më tepër të asaj pjese të tyre që mund të kategorizohen si përfitues të shërbimit universal.

Gjithashtu, ashtu siç kemi thënë edhe më lart, vetë BE konsideron si element të vjetëruar çështjet e numërorit telefonik dhe ka propozuar heqjen e këtij elementi nga fusha e SHU. Kështu që, është shumë e rëndësishme që, ashtu siç AKEP është orientuar nga propozimet e KE për përfshirjen e aksesit broadband si element të SHU, ashtu duhej ruajtur i njëjti qëndrim nga ana e AKEP për konsiderimin e propozimeve të KE për heqjen nga fusha e SHU si detyrime për numërorët dhe shërbimet DES pasi këto konsiderohen elementë të vjetëruar. Propozimi i KE sugjeron se vëndet që i kanë këto detyrime mund ti mbajnë ato, duke patur parasysh këtu vëndet të cilat i kanë funksionale këto detyrime. Por, në rastin e Shqipërisë ku, jo vetëm që nuk është funksional por është edhe evidente mungesa e plotë e interesit të pajtimtarëve për publikimin e të dhënave të tyre, mendojmë se vazhdimi i propozimit të AKEP për numërorin është i pavend.

Për shërbimet e telefonave publikë me pagesë:

Ulja e përdorimit të telefonave publikë me pagesë në BE, por edhe në Shqipëri tregon se aktualisht telefonat publikë me pagesë nuk janë më të përshtatshme duke patur parasysh se kostoja e tyre e mirëmbajtjes i tejkalon përfitimet që ato sjellin për përdoruesit. Në zona ku penetrimi celular është tashmë shumë i lartë dhe në zona ku telefonat publikë me pagesë mund të ofrohen me një interes ekonomik, pa patur nevojë për rregullim, një kërkesë për të ndërtuar dhe mirëmbajtur një sasi të madhe të telefonave publike me pagesë nuk është më e nevojshme për arsye të përfshirjes sociale. Pra, kostot për të investuar në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi të telefonave publikë me pagesë nuk justifikohen nga përfitimet që ky shërbim mund t'i sjellë shoqërisë. Ky element i shërbimit universal, me zhvillimin e teknologjive të reja, uljen e rëndësishme të tarifave të shërbimit celular, dhe penetrimin e lartë të telefonisë celulare tashmë është i vjetëruar. Për këtë arsye, Albtelecom shpreh

dakortësinë me qasjen e AKEP se ky element i telefonave publikë me pagesë nuk është më i nevojshëm/i aplikueshëm duke marrë parasysh rënien e përdorimit dhe rëndësisë së tyre dhe mbulimin e penetrimin celular.

Në përfundim Albtelecom mendon se nuk duhet ndërmarrë asnjë masë rregullatore apo përcaktim për të promovuar telefonat publike me pagesë në Shqipëri, duke marrë parasysh të gjithë sa analizuam më sipër.

Telekom Albania **Shërbimet e numeratorit**

Praktikat për përfshirjen ose jo të shërbimit të numeratorit janë të ndryshme në vendet e BE-së, dhe të rajonit. Disa vende të rajonit si Maqedonia, Mali i Zi, dhe Turqia e kanë të përfshirë në objektin e Shërbimit Universal këtë element duke përzgjedhur një operator për ofrimin e këtij shërbimi në kuadër të SHU-së nëpërmjet procesit të tenderit publik me një afat 5-vjeçar, referuar raportit të 4-t të Cullen International të Shkurt 2014 "Monitoring regulatory and market development for electronic communications and information society services in Enlargement Countries". Ndërsa disa nga vendet e BE-së nuk e kanë përfshirë këtë element si detyrim në shërbimin universal pasi ky element në këto vende ofrohet në kushtet e tregut janë: Austria, Republika Çeke, Finlanda, Irlanda, Holanda, Zvicra (BoR 10 35 BEREK Report) dhe nga raporti i BE-së "Commission Staff Working Document "Implementation of the EU regulatory framework for electronic communication -2015". Pra, siç shihet dhe më sipër, praktikat janë të ndryshme në vende të ndryshme duke mos pasur një situatë të ngjashme dhe konforme në të gjitha vendet e BE-së dhe rajonit, pasi çdo vend ka specifikat e veta të zhvillimit.

Përdoruesit në Shqipëri nuk kanë preferencë në favor të shërbimeve të numeratorit, duke pasur parasysh që shumica e përdoruesve në vendin tonë përdorin telefonin celular dhe mbi 80% e tyre janë me parapagim, ndërsa një përqindje më e vogël e tyre përdorin shërbimet e telefonit fikse.

Operatori kryesor i fikse Albtelekom e ofron shërbimin e numeratorit për përdoruesit e tij, por jo të imponuar si pjesë e detyrimit të Shërbimit Universal.

Një nga objektivat kryesore për përcaktimin e detyrimit për shërbimin universal është dhe përmbushja e nevojave të përdoruesve të shërbimit universal, dhe një nga këto nevoja është e lidhur me preferencat që kanë përdoruesit në lidhje me publikimin e të dhënave të tyre në numeratorin e përgjithshëm telefonik. Mungesa e një preference të tillë karakterizon akoma tregun e telefonit fikse dhe asaj mobile në vendin tonë, preference këto që nuk kanë ndryshuar që nga konsultimi i fundit që është bërë mbi Shërbimin Universal në vitin 2012, elementë ky që duhet pasur parasysh gjatë rishikimit të statusit të Shërbimit Universal, në përputhje me kushtet specifike të Shqipërisë.

Në këto rast duhen marrë parasysh se pari tendencat dhe preferencat e përdoruesve në Shqipëri, pasi është i nevojshëm konsensusi i tyre për përfshirjen e numrave që ata posedojnë në shërbimin e një numeratori të përgjithshëm ose jo.

Një element tjetër që duhet marrë në konsideratë për këtë çështje është fakti që shërbimi i numeratorit si element i shërbimit universal është i lidhur me të drejtat e përdoruesit dhe duhet trajtuar si i tillë si dhe të mbrojtjes dhe privatësisë së të dhënave personale, aspekte të nevojshme të nevojave të përdoruesve fundorë në lidhje me përdorimin e shërbimeve të

komunikimeve publike. Komplexiteti në rritje i numeracionit (ndryshimet e planit të numeracionit me implementimin dhe investimet në rrjetet NGN), i emërtimeve dhe adresave për shërbimet e Shoqërisë së Informacionit sugjeron që shërbimi i Numeratorit ka nevojë për një ri-konceptim. Adresat IP, e-mail-et, emrat e domain-eve, apo mjete të tjera (p.sh, Facebook.etj), numrat celularë kanë marrë tashmë të njëjtën rëndësi sa numrat e telefonise fikse, dhe të gjitha këto koncepte është e rëndësishme për t'u marrë në konsideratë për mënyrën-e konceptimit se si do të futet në treg ky element, përpara se të përcaktohet nëse ky shërbim duhet të jetë në objektin e SHU. Kjo ka të bëjë dhe me mënyrën e bërjes publike të këtij elementi në formë elektronike apo të printuar dhe kush operator mund të caktohet për ofrimin e këtij shërbimi, i imponuar nga AKEP, apo në kushtet e ofrimit të tregut të këtij shërbimi.

Një tjetër faktor janë dhe kostot e tepërta që u krijohen operatorëve me implementimin e këtij shërbimi në kuadrin e Shërbimit Universal si pjesë detyruese për operatorët, duke qënë se nuk është një element bazik për nevojat e përdoruesve fundore dhe si e tillë nuk plotëson kriteret për të qënë pjesë e Shërbimit Universal.

Qasja që duhet mbajtur në konsideratë duhet të jetë në këtë rast orientimi i plotësimit të nevojave nëpërmjet tregut. Ndaj, Telekom Albania gjykon që AKEP të mos e përfshijë kështu këtë element në fushën e Shërbimit Universal. Në vijim të gjykimit, TAL sugjeron si opsion që mund të merret në konsideratë nga AKEP krijimi i një alternative si mundësi zgjedhje për pajtimtarët me kontratë ose me para-pagesë celular për të përfshirë ose jo numrin e tyre në një numerator, duke e lënë këtë element në diskrecion të tyre, duke respektuar kështu preferencat që ata kanë për këtë çështje.

Telefonat publikë me pagesë

Duke qënë se pjesa më e madhe e përdoruesve kanë akses në shërbimet e komunikimeve publike, nëpërmjet linjave fikse, dhe në veçanti nëpërmjet telefonisë celulare që mbulon gati të gjithë territorin, futja e shërbimit të telefonave publike me pagesë si element i shërbimit universal për të garantuar nevojat bazë të tyre është i panevojshëm dhe jo-proporcional me zhvillimet që ofron tregu, duke përbërë një barrë të pa justifikueshme për cilindo sipërmarrës që do të caktohej si ofrues i këtij shërbimi.

Mbi 98% e popullsisë në Shqipëri është mbuluar me sinjal të telefonisë mobile dhe pothuajse të gjithë përdoruesit kanë tashmë akses në përdorimin e shërbimeve të kësaj telefonle, e cila bën që shërbimi i telefonave publikë me pagesë të mos jetë me i nevojshëm si më parë aq sa të justifikojë një ndërhyrje për ta përfshirë në kuadrin e SHU, meqenëse objektivi social i plotësimit të nevojave të përdoruesve fundor përmbushen sot në mënyrë të plotë.

Ndaj, Telekom Albania shprehet për mos përfshirjen e shërbimit të telefonave publikë me pagesë si një element në objektin e Shërbimit Universal.

Plus Communication

Lidhur me Telefonat Publike me Pagesë, AKEP duhet të krijojë rregulla dhe detyrime për operatorët me fuqi të ndjeshme në rrjetet fikse .

Për sa i përket Numeratorit Telefonik Gjithëpërfshirës, duhet konsideruar se data-bazat e operatorëve celularë janë konfidenciale dhe rnbajnë të dhëna sensitive të pajtimtarëve (të mbrojtura nga ligji). Vetëm nëse pajtimtarët shprehin dëshirën e tyre, mund të jenë pjesë e

këtij numeratori gjithëpërfshirës fix dhe mobile, përfshirë këtu edhe bizneset të cilët mund të kenë interes më të lartë.

Ne gjykojmë se kjo nuk duhet të jetë pjesë e rregullave të paravendosura nga AKEP, por në vullnetin e pajtimtarëve përmes kompanive private të interesuara për botimin dhe publikimin e numeratorit telefonik dhe reklamimeve në të.

Vodafone Albania

Vodafone Albania vlerëson se elementi i shërbimit universal në lidhje me numeratorin dhe shërbimin e kërkimit në numerator nuk kërkohet nga nevojat e shoqërisë shqiptare, e për rrjedhojë nuk e shohim të justifikuar dhe proporcional propozimin për ofrimin e tij. Për informacionin tonë nuk ka asnjë palë të interesuar në ofrimin e këtij shërbimi në tregun shqiptar. Madje, me rritjen e ndërgjegjësimit të individëve për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë, individët konsiderojnë se numri i tyre i telefonit është personal dhe nuk janë të gatshëm ta zbulojnë atë.

Përsa i përket numrave të kontaktit të administratës, shërbimeve qeveritare, bizneseve, etj. kjo nevojë është plotësuar tashmë nga tregu, meqenëse ka disa numeratorë në internet duke përfshirë informacionin në e-government, informacion për biznese, restorante, për administratën publike, shërbime shëndetësore etj., siç janë faqja fletëtëverdha.com, etj. Nevoja për këto numeratorë telefonikë nuk është manifestuar, pasi një informacion i gjerë mund të gjendet në internet. Në BE gjithashtu vihet re një rënie në përdorimin e shërbimeve të numeratorit publik, kërkimit në numerator dhe telefonave publikë me pagesë.

Në përgjithësi shërbimet e numeratorit sigurohen në mënyrë kompetitive në treg e nuk ka nevojë për ndërhyrjen e autoritetit rregullator e nga ana tjetër disponueshmëria e informacionit në internet pa pagesë (psh. aplikacione si TrueCaller) janë një alternativë konkurruese ndaj ofruesve tradicionalë të shërbimeve të numeratorit. Shumë vende anëtare të BE e kanë nxjerrë shërbimin e numeratorit telefonik jashtë objektit të SHU. Në 18 vende anëtare të BE nuk ka një detyrim për ofrimin e shërbimeve të kërkimit në numerator (DES), ndërsa në 14 vende anëtare të BE nuk ka detyrim për ofrimin e një numeratori telefonik. Madje dhe në disa prej atyre vendeve që e kanë, ky shërbim ofrohet vetëm "upon request" (me kërkesë): psh shërbimi i numeratorit në UK është me kërkesë, shërbimi i numeratorit të printuar në Spanjë vetëm me kërkesë, etj.

Nga ana tjetër, ulja e përdorimit të telefonave publikë me pagesë në BE, por edhe në Shqipëri dëshmon se aktualisht telefonat publikë me pagesë nuk janë më të përshtatshëm duke patur parasysh se kostot e tyre të mirëmbajtjes i tejkalojnë përfitimet që ato sjellin për përdoruesit. Në zona ku penetrimi celular është tashmë i lartë dhe në zona ku telefonat publikë me pagesë mund të ofrohen me një interes ekonomik pa patur nevojë për rregullim, një kërkesë për të ndërtuar dhe mirëmbajtur një sasi të madhe të telefonave publikë me pagesë nuk është e nevojshme për arsye të përfshirjes sociale dhe mund të rrezikojë zhvendosjen e shërbimeve tregtare. Pra, kostot për të investuar në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi të telefonave publikë me pagesë nuk justifikohen nga përfitimet që ky shërbim mund t'i sjellë shoqërisë. Ky element i shërbimit universal, me zhvillimin e teknologjive të reja dhe uljen e rëndësishme të tarifave të shërbimit celular, është i vjetëruar.

Sa më sipër, Vodafone Albania mbështet qëndrimin se elementet e SHU • shërbimet e numeratorit dhe telefonat publikë me pagesë nuk janë më të nevojshëm/të aplikueshëm duke marrë parasysh mungesën e kërkesës, mbulimin dhe penetrimin e gjerë celular, si dhe plotësimin e nevojës për shërbimet e numeratorit nga mjetet alternative psh, media sociale, aplikacione Truecaller, fletët e verdha. et).

Nëse gjithësesi AKEP vendos të rishikojë kuadrin rregullator lidhur me shërbimin e numeratorit të cilin gjykojmë se nuk është e nevojshme, Vodafone sugjeron se së pari çdo ndryshim i kuadrit ligjor duhet të garantojë sigurinë ligjore për operatorët në treg, duke reflektuar rregulla të mirëpërcaktuara, të përshtatura me analizen e sektorit kombëtar dhe zhvillimet afat mesme. Së dyti, në rast të ofrimit ky shërbim duhet dhënë në terma tregtare, ashtu siç edhe ka qënë përfundimi që ka arritur AKEP gjatë analizës së SHU në vitin 2013.

Gjithësesi kuadri ekzistues nuk e favorizon ofrimin e shërbimit, sië janë psh:

- rasti i nevojës për "opt-in" që parashikon legjislacioni shqiptar për marrjen e pëlqimit të pajtimtarëve për përfshirjen në numerator
- nevojitet të parashikohet në formularët e regjistrimit të miratuar nga AKEP për pajtimtarët me kartë të parapaguar dhe me kontratë opsioni për të pranuar përfshirjen në numeratorin telefonik dhe në shërbimet e kërkimit në numerator.
- duhen marrë masa që të inkurajohet bashkëpunimi midis operatorëve për të ndarë informacionin e pajtimtarëve të tyre që kanë dhënë pëlqimin për këtë shërbim, në mënyrë që të jepen në mënyrë efektive shërbimet e kërkimit në numerator, për pajtimtarët e të gjithë operatorëve.
- përdorimi i këtyre të dhënave mund të keqpërdoret, ndaj dhe duhet të kufizohet në shërbimin e kërkimit në numerator dhe të mos përdoret për asnjë qëllim tjetër.

Nëse ky do të ishte rasti, për të gjithë arsyet më sipër cituar Vodafone Albania është e mendimit se mundësia e parë për ofrimin e shërbimit të kërkimit në numerator i duhet dhënë operatorëve dhe të mos i caktohet një pale të tretë. Procesi i tenderimit duhet të jetë transparent dhe i drejtuar nga konkurrueshmeria ndërmjet palëve të interesuara.

Qëndrimi i AKEP

AKEP bazuar në propozimet e fundit të KE për rishikimin e fushës së SHU, ka shërbimet e numeratorit dhe telefonat publikë me pagesë janë elemnët të vjetëraur (outdated) të SHU, do të ndjekë nga afër zhvillimet në vendet e BE dhe do të gjykojë më vonë nëse ka nevojë të ndërmerren masa të mëtejshme për fillimin e ofrimit të numeratorit gjithpërfshirës dhe përmirësime në telefonat publikë me pagesë. Vlen të vihet në dukje se për numeratorin gjithpërfshirës propozimi i AKEP në vitin 2015 pati shumë kundërshtime nga disa operatorë dhe se historiku në këtë drejtim është shumë i ulët apo inekzistent në Shqipëri. Ndërkohë në etretg ka inisiativa private me publikime të librave të verdhe për direktoritë e biznesit, që janë kombëtare dhe/ose locale.

6. Çfarë masash mund të merren nga ana e kërkesës për adresimin e fuqisë blerëse të ulët për aparate fundore për përdorimin e aksesit në Internet?

Albtelecom

Lidhur me këtë çështje, me politikat e tij dhe ofertat e bëra më së fundmi në tregun e telefonisë së lëvizshme, Albtelecom bashkëlidhur planeve tarifore të caktuara të tilla si, planet individuale me kontratë LIFE, apo planit standart me parapagesë, ka filluar ofrimin në

treg edhe të aparateve celularë smartphone që sigurojnë aksesin broadband nga rrjeti celular. Për më tepër, Albtelecom ka ofruar mundësinë të pagesës së aparatit kundrejt një pagese të vetme ose edhe të kryerjes së pagesës me këste. Gjithashtu, për të nxitur interesin e abonentit për blerjen e celularit në dyqanet e tij, Albtelecom ka sjellë opsione dhe celularë me tarifa të arsyeshme dhe ndërkohë brenda çmimit apo tarifës për aparat ka përfshirë edhe benefite ekstra për abonentin, të tilla si internet 3G për 12 muaj të njëpasnjëshëm, 10 minuta ndërkombëtare (apo më shumë varësisht planit individuale me kontratë që zgjedh abonenti).

Sa më sipër, duke u nisur dhe nga ekzistenca në treg e ofertave të aparatëve celularë edhe të konkurrentëve, Albtelecom mendon se rritja e kërkesës së popullatës (abonentëve potencial) për aparate fundorë për përdorimin e aksesit në internet është e lidhur vecanërisht me të ardhurat mesatare të individit apo të familjes shqiptare dhe se sa është mundësia e shpenzimit të një pjese të tyre në blerjen e aparateve fundorë.

Në përfundim, pavarësisht politikave inovative të ndjekura nga operatorët celularë, rritja e fuqisë blerëse për aparate fundorë nga konsumatori shqiptar është direkt e lidhur me pagën mujore të tij, me të ardhurat mesatare të familjes, dhe gjithashtu me remitancat apo dërgesat nga jashtë në rastin e Shqipërisë. Në kushtet kur, paga dhe të ardhurat mesatare janë thuajse në të njëjtat nivele në këto 2-3 vite të fundit¹⁵, ndërsa remitancat apo dërgesat e shqiptarëve që jetojnë jashtë janë ulur ndjeshëm (si pasojë dhe e krizës ekonomike që ka përfshirë një pjesë të shteteve ku ata punojnë), nuk mund të pritët rritje e fuqisë blerëse për aparate fundorë, më shumë se sa fokusim në shpenzimet e konsumit dhe rritje për sa është e mundur të kursimeve.

Telekom Albania

Një mënyrë për adresimin e kësaj çështje do të ishte reduktimi i barrës fiskale specifike për sektorin e komunikimeve elektronike si psh: taksën që afekton koston e pajisjeve për ofrimin e shërbimeve të Internetit (routers), taksat mbi aparatet e përdoruesve fundorë si psh smartphones, taksat në lidhje me shërbimet e aksesit në internet. Në këtë drejtim Qeveria duhet të ketë një këndvështrim më të gjërë dhe gjithpërfshirës në të gjithë zinxhirin e shërbimeve të internetit në tërësi në mënyrë që të kuptojë më mirë barrën e plotë fiskale.

Një agjenci e vetme me funksionin (sesa një sërë instituconesh të ndryshme publike për vendosjen dhe aplikimin e taksave specifike) për të ekzaminuar dhe mbikëqyrur të tërë zinxhirin e shërbimeve të aksesit në internet, për të harmonizuar politikën, thjeshtësuar lejet dhe reduktuar nivelin e taksimit do të ishte një mënyrë për të adresuar dhe fuqinë e ulët blerëse për aparatet fundorë nga ana e kërkesës.

Në kushte të njohura të informalitetit të tregut të shitjes së aparateve celularë, TAL sikurse çdo kompani tjetër celulare e shikon sfiduesë përballimin e çmimeve më të ulëta për këtë kategori në terma të shkurtër kohore.

Megjithatë për të nxitur dhe për tu ardhur në ndihmë konsumatorëve tanë të të gjitha shtresave ekonomike TAL ka nxjerrë dhe vazhdon të pasurojë gamën e telefonave (3G/4G) të

branduar Telekom të cilët ofrojnë një cilësi të lartë me çmime shumë të përballueshme për klientët.

Duke mos pasur një rol të rëndësishëm në tregun e shitjes së aparateve celulare, kryesisht si rezultat i impaktit negativ të tregut informal, TAL do të vazhdojë strategjinë e rritjes së penetrimit të telefonave që ofrojnë akses në shërbimin e internetit, por nuk mund të detyrohet apo të aplikohet rregullimi në këtë fushë.

Gjithsesi, TAL sygjeron formalizimin e tregut të shitjes së aparateve në tërësi me qëllimin për ta formalizuar atë, për të patur kushte të njëjta të konkurrencës në këtë fushë.

Plus Communication

Rregullat dhe marrja e masave për gjetjen e alternativave për aparate fundore broadband, smart phone apo tablet, është e pamundur të vendosen nga AKEP, pasi vetë tregu i lirë dhe rritja e standartit të të ardhurave të popullsisë do balancojnë nivelin kërkesë – ofertë në lidhje me këto aparate.

Në të njëjtën kohë, sugjerohet një takim për diskutim me operatorët e telekomunikacioneve dhe insitucionet respektive për mundësitë lehtësuese në këtë fushë si psh. heqjen e akcizës *dhe/ose* TVSH-së në një periudhë të caktuar për aparatet fundore broadband e kryesisht telefonat SMART dhe tabletat.

Vodafone Albania

Vodafone gjykon se konkurrueshmëria e lartë mes katër operatorëve celulare ka dhënë rezultat edhe në këtë aspekt, pa qenë nevoja për ndërhyrjen e AKEP nëpërmjet implementimit të SHU. Këtu i referohemi rrjetit ekzistues, pajisjeve si dhe iniciativave të operatorëve për të mbështetur target-grupe të caktuara në nevojë.

Ashtu siç kemi parashtruar më lart në dokument Vodafone vëren se shërbimet bazë të internetit të përcaktuara nga AKEP në dokumentin për këshillim publik mund të aksesohen normalisht edhe përmes një celulari smartphone i cili mundëson aksesin data nëpërmjet rrjetit 2G. Për këtë arsye në përgjigje të pyetjes 4 më sipër kemi sugjeruar që shpejtësia e internetit për planet tarifore të propozuara nga AKEP (nëse AKEP do të vendosë që ato të jenë element i SHU) të jetë ajo e nevojshme për aksesin data nëpërmjet rrjetit 2G (minimale), pasi aparatet që mundësojnë këtë akses përmes rrjetit 2G janë përgjithësisht shumë të lirë e të përballueshëm. Këtë e provojnë edhe të dhënat tona sipas të cilave rreth 881.000 pajtimtarë përdorin telefona që mundësojnë aksesin në rrjetin 2G i cili ofron një shërbim bazë të internetit sipas përcaktimit nga AKEP në dokumentin për këshillim publik (nga këta 661,000 e kanë shërbimin data të aktivizuar) dhe të cilët me shumë gjasë janë personat që duhen profilizuar për akses në SHU, nëse AKEP do vendoste ta bentë këtë.

Konkretisht në dyqanet Vodafone tregtohet telefoni Alcatel 1052 me çmimin 2200 lekë (me TVSH) ose përafërsisht 16 Euro, i cili ofron internet me shpejtësi 2G. Vodafone Albania ofron edhe një sërë aparatesh smartphones me çmime të arsyeshme, për të përmbushur kështu nevojat e përdoruesve të internetit që janë pjesë e grupeve të popullsisë me të ardhura të ulëta. Më shumë detaje mund të gjenden në faqen tonë të Internetit www.vodafone.al Gjithashtu, Vodafone Albania ka ndërmarrë iniciativa për të adresuar edhe nevojat e personave me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit nëpërmjet ofrimit të shërbimeve/aplikacioneve si dhe aparateve të posacme të përshtatura për ta, psh:

- Aplikacioni "Safebeep" përmban disa multi-funksionalitete automatike dhe një sistem monitorimi në funksion kundër aksidenteve dhe rreziqeve të ndryshme në jetën e përditshme.
- Celulari Vodafone 155 i cili tregtohet me një çmim të arsyeshëm prej 4400 lekë (me TVSH) ose përafërsisht 32 Euro, i dizenuar posaçërisht për të moshuarit. Celulari ka një tastierë të madhe me butona të mëdhenj dhe numra të dukshëm e një ekran me ngjyra e kontrast të lartë. Celulari ka një vecçori – një baton në formë zemre në pjesën e pasme të telefonit, e cila mundëson kryerjen e telefonave të emergjencës dhe dërgimin e SMS-ve drejt 5 numrave njëkohësisht.

Në përfundim, sugjerojmë që me qëllim shtimin e përdorimit të aparateve smartphone nga shtetasit me të ardhura të ulta, AKEP në bashkëpunim me qeverinë mund të marrë masa për edukimin e përdoruesve fundorë për përdorimin e teknologjive të reja, për subvencionimin e aparateve që mundësojnë aksesin në internet (PC, laptop, Smartphones) për personat me aftësi të kufizuara apo personat me të ardhura të ulta, si dhe për ofrimin e financimit për analizimin e nevojave dhe zhvillimin e softëare-ve dhe aplikimeve me qëllim ofrimin e zgjidhjeve inovative për përdoruesit fundorë.

Të tjera

Së fundi, nisur nga propozimet e KE për rishikimin e kuadrit aktual rregullator të SHU, Vodafone kërkon ndryshimin e kuadrit ligjor ekzistues me qëllim financimin e SHU vetëm nëpërmjet fondeve të shtetit siç ndodh aktualisht në disa vende të BE, dhe jo nga operatorët e komunikimeve elektronike. Psh në Çeki SHU mbulohet nga buxheti i shtetit që prej vitit 2010, ndërkohë që në Hungari nuk ka kontribut financiar nga operatorët e industrisë dhe ai është hequr që prej 5 vitesh: në fakt nëse ofruesi i SHU ka kosto, ato mbulohen në parim nga buxheti i shtetit.

Në dokumentin për këshillim publik kërkojmë që AKEP në rast se vendos masa rregullatore mbi sipërmarrësit duhet të ketë të qartë dhe të bëjë transparente metodologjinë e kostove dhe mënyrën e rikuperimit të tyre.

Qëndrimi i AKEP

Në lidhje me propozimet e operatorëve për pyetjen e shtruar, AKEP i vlerëson ato dhe mund të jenë objekt i diskutimeve dhe me institucione të tjera. Ndërkohë AKEP bazuar në krahasimet e tarifave celulare me vendet e rajonit për programe tarifore që përfshijnë aparate smart në pagesën mujore, vëren se ofertat në Shqipëri janë më të kufizuara apo me pagesa mujore më të larta se në vendet e rajonit, dhe ka vend për përmirësim nga operatorët celularë Shqiptarë.

Në lidhje me propozimin e Vodafone për ndryshimin e kuadrit ligjor ekzistues me qëllim financimin e SHU vetëm nëpërmjet fondeve të shtetit siç ndodh aktualisht në disa vende të BE, MIAP është në process propozimi të ndryshimeve të tilla ligjore.